Dr. Silvana Nini

LIBËR PËR MËSUESIN

ART FIGURATIV 10



Silvana Nini

LIBËR PËR MËSUESIN

ART FIGURATIV 10



BOTIME

pegi

Dr. Silvana Nini

LIBËR PËR MËSUESIN
ARTI FIGURATIV 10

Për arsimin e mesëm të përgjithshëm

BOTIME

pegi

Prishtinë, 2019

BOTIME

Drejtoi botimin: Valmira MUSHI
Recensentë të MASHT-së: Majlinda KELMENDI, Verona AHMETI,
Mimoza SHAMOLLI, Arrita GJIKOLLI
Redaktor letrar: Arlon LIKA
Paraqitja grafike: Suela NINI
Kopertina: Enkeleda REXHA
Shtypi: Shtypshkronja Pegi, Lundër, Tiranë
ISBN: 978-9951-786-02-7

© Botime Pegi sh.p.k., dega në Kosovë, korrik 2019
Të gjitha të drejtat për këtë botim në gjuhën shqipe janë tërësisht
të zotëruara nga Botime Pegi sh.p.k. Ndalohet çdo riprodhim, fotokopjim,
përshtatje, shfrytëzim ose çdo formë tjetër qarkullimi tregtar, pjesërisht
ose tërësisht, pa miratimin paraprak nga botuesi.

Botime Pegi: tel: +355/ 042 468 833; cel: +355/ 069 40 075 02;
e-mail: botimepegi@botimepegi.al; web: www.botimepegi.al
Sektori i shpërndarjes: cel: +355/ 069 20 267 73; 069 60 778 14;
e-mail: marketing@botimepegi.al
Shtypshkronja Pegi: cel: +355/ 069 40 075 01;
e-mail: shtypshkronjapegi@yahoo.com

Hyrje

Arti figurativ ka për qëllim të ndihmojë nxënësit të zhvillojnë aftësitë krijuese, komunikuese, vlerësuese dhe të kuptojnë mjedisin që i rrethon.

Krijimtaria në art, kontribuon në formimin e një identiteti personal e të vetëbesimit dhe ndihmon në krijimin e vetëdijes kulturore dhe ndjeshmërisë artistike. Nxënësit kanë mundësi të krijojnë imazhet e tyre, duke u përfshirë në procesin krijues, duke zbuluar mundësi të shumta të kombinimit të materialeve me gjuhën vizuale, për të komunikuar mendimin e tyre për një audiencë të caktuar. Në këtë nivel, ata mësojnë të analizojnë dhe të zhvillojnë ndjesitë e tyre estetike nëpërmjet vlerësimit jo vetëm të punëve të tyre dhe të shokëve/shoqeve, por edhe të veprave të artit, të fakteve dhe imazheve të marra nga historia dhe trashëgimia kulturore e së tashmes dhe e së shkuarës. Nëpërmjet lëndës së artit figurativ, nxënësit inkurajohen të bëjnë lidhjen e artit pamor me lëndët e tjera në kurrikul dhe ta shohin artin si një mundësi karriere.

Arti figurativ komunikon nëpërmjet gjuhës së simboleve, përmes të cilave nxënësit mësojnë të identifikojnë vlera estetike dhe njerëzore në vepra të ndryshme arti dhe të kuptojnë ndikimin e artit në shoqërinë njerëzore. Përmes kësaj lënde, ata do të komunikojnë dhe do të zhvillojnë aftësitë e tyre artistike, jo vetëm përmes gjykimit estetik, arsyetimit, mendimit kritik, por edhe përmes krijimit konkret në punë 2 -3 dimensionale.

Krijimet e ndryshme që do të realizohen përmes punës në klasë do t'i motivojnë ata të përfshihen në mënyrë aktive në jetën artistike të shkollës, komunitetit dhe në rang vendi.

Kjo lëndë kërkon që përmes studimit të përmbajtjes, që ajo ofron, të arrihen qëllimet kryesore të lëndës duke dhënë kontributin e saj në zhvillimin personal të nxënësve, si dhe duke u dhënë mundësinë atyre të shohin vetveten si pjesë e shoqërisë dhe kontribuues aktivë në të. Lënda ndihmon dhe në përgatitjen e nxënësve si qytetarë aktivë të një shoqërie evropiane.

Pse shërben ky libër?

Ky libër do të udhëheqë mësuesit në zhvillimin e lëndës së artit pamor, në zhvillimin e aftësive të tyre profesionale, duke kuptuar më së miri qasjen me bazë kompetencat edhe në kurrikulën e artit figurativ.

Çfarë synon ky libër?

Qëllimi i këtij libri është orientimi i mësuesit/es që jep lëndën e artit figurativ në klasën e 10-të, për të përmbushur synimet e kësaj lënde, zbatimi me sukses i së cilës kalon nëpër tri element mjaft të rëndësishëm të mësimdhënies:

a) planifikimin e të nxënit sipas **formateve të reja**;
b) zbatimin e metodologjisë së mësimdhënies, bazuar në **situata të nxëni**;
c) realizimin e **vlerësimit** për të nxënë dhe i të nxënit.

Çfarë përmban ky libër?

Ky libër është konceptuar në përputhje me programin e klasës së dhjetë, përkatësisht shkalla e pestë e lëndës Art figurativ.
Ky libër merr përsipër:

- **të sqarojë** çdo mësues/e të artit figurativ për të gjitha çështjet e planifikimit, metodologjisë dhe vlerësimit, që duhet të zbatojë çdo mësues në lëndën e tij.
- **të udhëheqë** çdo mësues me formatet e planifikimit e kërkuara dhe mënyrën sesi ato duhet të përdoren nga vetë mësuesi në lëndën e artit pamor, duke i udhëzuar **ata** mbi: planifikimin vjetor, me periudha dhe atë ditor, me të cilat duhet të punojë mësuesi gjatë një viti shkollor.

Ky libër në parim ofron modele ose i sugjeron ato por nuk i dikton ato. Çdo model që ka të bëjë me planifikimin, situatat e të nxënit, metodologjinë apo vlerësimin, krijohet mbi një bazë të caktuar të realitetit dhe nivelit të klasës ku mësuesi/ja jep mësim.
Realiteti në çdo klasë, mund të sugjerojë modele të ndryshme, për tema të caktuara.

2. Metodologjia për zhvillimin e lëndës së artit figurativ

Përdorimi i metodologjive efikase në mësimdhënien e artit pamor është kusht në rritjen e cilësisë së arritjeve nga ana e nxënësve, duke i dhënë secilit mundësinë të shfaqë dhe të zhvillojë potencialin pamor/artistik, që zotëron brenda vetes. Organizimi i mirë i procesit të mësimit të artit pamor do të thotë që nxënësit të vendosen në situata konkrete dhe praktike, ku ata zbulojnë mjedisin vizual dhe krijojnë nëpërmjet përdorimit të mjeteve të larmishme artistike. Kjo arrihet vetëm nëpërmjet një motivimi të drejtë dhe përkundrejt zhvillimit të një kompetence të caktuar nëpërmjet rezultateve të të nxënit dhe tematikave përkatëse mësimore.
Mësimdhënia e artit pamor, për nga vetë natyra, nënkupton një veprimtari emocionale dhe fizike. Çdo përmbajtje dhe veprimtari mësimore në artin pamor, është e pëlqyeshme dhe krijon emocione, kur nxënësit drejtohen drejt një veprimtarie në mënyrë të vetëdijshme, ç`ka u mundëson atyre shprehjen e potencialit të tyre intelektual/artistik në shumë aspekte.
Mësimdhënia në artin pamor, synon gjithë përfshirjen, motivimin, barazinë në të gjitha aspektet dhe bazohet **në mësimdhënien dhe nxënien bazuar në kompetenca; mësimdhënien me në qendër nxënësin dhe mësimdhënien dhe nxënien e integruar**.
Nxënësit e një klase janë të ndryshëm, për sa i përket mënyrës se si ata nxënë: individualisht, në grup, nën udhëheqjen e mësuesit, të pavarur, me anë të mjeteve konkrete etj.
Planifikimi dhe përzgjedhja e strategjive dhe metodave të mësimdhënies në mësimin e artit pamor mban parasysh:

- **kompetencat kyçe**;
- **ndërtimi i çdo njohurie** dhe i **çdo aftësie** mbështetur në ato të mëparshmet;
- **veprimtari praktike krijuese** në artin pamor, brenda dhe jashtë klasës, të cilat lidhin konceptet pamore me situata të jetës reale;
- **mjete dhe materiale** konkrete didaktike dhe ato të teknologjisë;
- **krijimi i qëndrimit pozitiv** ndaj lëndës së artit pamor dhe përdorimi i saj përgjatë gjithë jetës;
- **bashkëveprimi mësues-nxënës** gjatë procesit mësimor, duke qenë plotësues të njëri-tjetrit.

Mësimdhënës të caktuar përdorin më shumë demonstrimin, të tjerë ligjërimin, reflektimin, diskutimet, por ka të atillë që përqendrohen më shumë në të menduarit, te kujtesa, në të kuptuarit. Për të arritur suksese në procesin mësimor duhet patjetër që mësimdhënësi t'i zbatojë stilet e të nxënit, duke njohur më parë mënyrat se si mësojnë nxënësit, pikëmbështetje për planifikimin e punës mësimore, përputhshmërisë së stileve të të nxënit dhe përdorimit të metodave apo teknikave të mësimdhënies në varësi të stileve të përdorura. Stilet e të nxënit,

nëpërmjet metodave dhe teknikave të mësimdhënies përmbush detyra të rëndësishme të mësimdhënies dhe:

- Ruajnë përfshirjen aktive;
- Nxisin diskutimin e hapur;
- Nxisin nxënësit të krijojnë dhe të bëjnë pyetjet e tyre;
- Ndihmojnë në shprehjen e mendimeve të nxënësve;
- Ruajnë motivimin e nxënësve për të mësuar;
- Siguron një mjedis ku respektohen mendimet;
- Krijon një shtresë për reflektim në atë që nxënësit vlerësojnë;
- Shërben si nxitje për ndryshim;
- Vendos shpresë për përfshirjen kritike të nxënësve;
- Ndihmon mendimin kritik në nivele të larta e të ndërlikuara.

a) Stili i të nxënit pamor

është kur nxënësi e përvetëson përmbajtjen mësimore me anën e shqisës së të parit. Në këtë rast mësimi konkretizohet, duke përdorur mjete mësimore si: foto, harta, fotografi, grafikë, piktura, ngjyra, makete, ilustrime, vizatime, Dvd (ku kemi dy lloj stilesh: pamore dhe dëgjimore) etj. Të nxënit përmes të parit zhvillohet nga veprimtari të organizuara nga mësuesi ku kërkohet përqendrimi i nxënësve në:

- Vëzhgimin e materialeve të vendosura për të memorizuar apo për të kujtuar një objekt, ngjarje, personazh, një situatë të caktuar në kontekstin e temës mësimore,
- Vëzhgimin e materialeve të vendosura për të nxitur diskutimin apo për të verifikuar njohuritë e marra më parë.

Në stilin e të nxënit pamor do të gruponim: Kujtesën pamore; Organizuesit grafikë (teknikat: Diagramin e Venit, Kllasterin, Hartën e të pyeturit, etj.

b) Stili i të nxënit dëgjimor

Është kur nxënësi e përvetëson përmbajtjen mësimore me anën e shqisës së dëgjimit. Këta nxënës përvetësojnë më mirë dhe më lehtë njohuritë nëpërmjet bisedave, diskutimeve ku bëhen vlerësime, jepen mendime, përfundime, bëhen analiza etj. Të nxënit përmes dëgjimit zhvillohet nga veprimtari të organizuara nga mësuesi/ja ku kërkohet përfshirja e nxënësve në:

- dëgjimin e shpjegimit të njohurive apo një situate në kontekstin e temës mësimore;
- biseda dhe diskutime në grup për prezantimin e punëve të ndryshme;
- veprimtari që kërkon të folur të rrjedhshëm dhe të qartë.

Në stilin e të nxënit dëgjimor do të gruponim: Brainstorming; Diskutimi; Hulumtimi i orientuar.

c) Stili i të nxënit kinestetik

Është kur nxënësi përvetëson përmbajtjet mësimore në mënyrë aktive, duke vepruar, luajtur, eksperimentuar, vizatuar etj. Këta nxënës janë më të suksesshëm nëse:

- e prekin dhe e ndjejnë përmbajtjen mësimore,
- ndërveprojnë me shokët/et dhe mësuesin,
- ndërveprojnë me mjetet e punës,
- përdorin gjuhën e ndjenjave.

Në stilin e të nxënit kinestetik do të gruponim: Eksperimenti; Puna në grup; Hulumtimi i lirë dhe i orientuar; vlerësimi i veprave të artit dhe kritika e artit.

Të tria këto stile harmonizohen dhe ndihmojnë çdo mësimdhënës të planifikojë veprimtari të larmishme mësimore, duke përdorur mjaft teknika dhe metoda të mësimdhënies.

- Brainstorming (stuhi mendimesh)

Mësuesit mund të përdorin brainstorming si një strategji (metodë) e të menduarit, për të ndihmuar nxënësit të gjenerojnë pyetje, ide dhe shembuj dhe të zbulojnë një ide apo një temë qendrore (kryesore). Gjatë aplikimit të brainstorming, nxënësit ndajnë idetë që u vinë në mëndje dhe i regjistrojnë këto ide pa bërë gjykime rreth tyre.

Mësuesi/ja mund të përdorë këtë metodë gjatë prezantimit të temës (gjatë situatës së të nxënit), për të përcaktuar atë që nxënësit dinë dhe duan (ose duhet) të mësojnë dhe për të orientuar zhvillimin e mësimit dhe reflektimin. Brainstorming stimulon të menduarit rrjedhshëm dhe fleksibël dhe gjithashtu mund të përdoret për të aftësuar nxënësit në zgjidhjen e problemeve artistike.



• Diskutimi

Diskutimi është një strategji bashkëpunimi përmes së cilës nxënësit shqyrtojnë mendimin e tyre, reagojnë ndaj ideve, përpunojnë informacionin dhe artikulojnë mendimet e tyre duke i shkëmbyer me njëri-tjetrin dhe me mësuesit. Diskutimi mund të përdoret për të qartësuar konceptet, idetë dhe informacionin. Theksi vihet në bisedën dhe dëgjimin e njëri-tjetrit. Nëpërmjet diskutimit, nxënësit mund të krijojnë lidhje midis ideve dhe përvojës dhe të reflektojnë mbi interpretime të ndryshme.

• Eksperimenti

Eksperimentimi është një metodë thelbësore për artin pamor dhe përdoret shpesh për të bërë lidhjen midis konkretes dhe abstraktes. Eksperimentimi kërkon që nxënësit të hetojnë, testojnë, eksplorojnë, manipulojnë, zgjidhin problemet, marrin vendime dhe organizojnë informacione në mënyrë praktike. Eksperimentimi inkurajon gjithashtu nxënësit që të përdorin aftësitë bashkëpunuese në mënyrë efektive në interpretimin dhe komunikimin e gjetjeve. Eksperimentimi rrit motivimin, mirëkuptimin dhe përfshirjen aktive të nxënësve dhe mund të iniciohet nga mësuesi ose vetë nxënësi.

• Puna në grup

Teknikat e punës në grup u mundësojnë nxënësve të punojnë si ekip për të arritur një qëllim të përbashkët mësimi. Për shembull, një grup nxënësish mund të punojnë së bashku për të krijuar një vepër arti ose për të realizuar një projekt artistik. Përveç produktit përfundimtar të prodhuar nga grupi, një aspekt i rëndësishëm i procesit të të mësuarit bashkëpunues është që çdo anëtar i grupit të shqyrtojë se si grupi funksiononte dhe të vlerësojë kontributin e tij ose të saj në procesin e punës në grup. Diskutimet, shënimet dhe vetëvlerësimi janë disa mënyra në të cilat nxënësit mund të reflektojnë mbi procesin e punës në grup dhe pjesën e tyre në të.

• Kujtesa pamore

Kujtesa pamore është një proces që shërben për ta bërë një objekt, një ngjarje ose një situatë të dukshme në imagjinatën e nxënësve duke e ndërtuar nëpërmjet përshkrimit me fjalë ose duke përdorur një imazh. Mësuesit mund të përdorin imazhet, gjatë mësimdhënies dhe mësimnxënies, si një ushtrim për kujtesën dhe si një nxitës i rëndësishëm përpara krijimit të punimit. Mësuesit gjithashtu mund të përdorin një sërë stimulimesh pamore (p.sh., ilustrime, fotografi, riprodhime veprash arti, video, objekte reale, grafika) për të ndihmuar nxënësit në krijimin dhe realizimin e punimeve të tyre artistike nëpërmjet teknikave të ndryshme.

• Hulumtimi i orientuar

Kjo është një metodë mësimore në të cilën nxënësit përdorin mjetet dhe materialet sipas zgjedhjes së tyre. Mësuesi/ja vëzhgon dhe dëgjon ndërsa nxënësit po eksplorojnë dhe japin udhëzime sipas nevojës, duke përdorur informacionin e mbledhur nga vlerësimi. Për shembull, mësuesi/ja mund të parashtrojë një pyetje, që nxit një mendim më të thelluar ose të prezantojë një fjalor të ri.

• Hulumtimi i lirë

Ky është një aktivitet kyç i mësimdhënies që iniciohet nga nxënësit, duke përdorur materialet artistike në klasë në mënyrat e zgjedhjes së tyre. Mësuesi/ja vëzhgon dhe dëgjon si pjesë të vlerësimit të vazhdueshëm ndërsa nxënësit po eksplorojnë (hulumtojnë) lirisht, dhe nuk e drejton eksplorimin ashtu siç bën gjatë eksplorimit të orientuar.

• Organizuesit grafikë

Përdorimi i grafikëve si mbështetje është një strategji veçanërisht e fuqishme e mësimdhënies. Grafikët, të konsideruar si një çelës pamor, u mundësojnë nxënësve të kuptojnë marrëdhëniet midis elementeve dhe organizimit të tyre në mënyrë pamore dhe jo vetëm nëpërmjet gjuhës, duke e bërë më të shpejtë përthithjen e njohurive. Grafikët mund të përdoren për të regjistruar, organizuar, krahasuar, analizuar dhe sintetizuar informacionet dhe idetë. Ato mund t'i ndihmojnë nxënësit të lidhin njohuritë paraprake me konceptet e reja si dhe konsolidimin e kuptimit të tyre.
Shembuj të përdorimit të grafikëve janë: Harta e pyetjeve (realizimi), harta e mendimeve (kllasteri) (reflektimi), tabela e koncepteve (reflektimi), diagrami i Venit (përdoret gjatë reflektimit), afatet kohore (kryesisht në historinë e artit).
Përdorimi i tabelave grafike është jashtëzakonisht i dobishëm kur kryhet fillimisht si një aktivitet brainstorming i klasës apo grupit. Organizatori grafik ofron një mënyrë për të mbledhur dhe paraqitur në mënyrë vizuale informacion mbi një temë që do ta bëjë atë më të kuptueshëm për studentët.

• Teknika: Diagrami i Venit

është një teknikë, më anë të së cilës evidentohen të përbashkëtat dhe dallimet ndërmjet dy koncepteve (elementeve të artit, teknikave artistike, periudhave të historisë së artit, veprave të artit të një periudhe, veprave të artit të periudhave të ndryshme, veprave të artit me të njëjtën tematikë, etj. Diagrami i Venit ndërtohet me prerjen e dy a më shumë rrathëve. Përdoret kryesisht gjatë fazës së reflektimit. Nëpërmjet tij, nxënësit zbulojnë tipare të përbashkëta dhe veçori dalluese në varësi të specifikave të temës së mësimit, si dhe mbajnë qëndrime personale lidhur me to. Veprimtaria zgjat 10'-20', por është në varësi të temës, moshës dhe kohës së përgjithshme në dispozicion.



• Teknika: Kllasteri

ose grupimi i mendimeve ose "harta e mendimeve", është një teknikë që i nxit nxënësit të mendojnë për të krijuar lidhje midis fakteve. Shërben si një mjet i fuqishëm për fillimin e procesit të të mësuarit, sidomos për ata nxënës që u mungon një dëshirë e tillë.

Hapat për realizmin e kllasterit janë të thjeshta dhe të lehta për t'u mbajtur mend:

- Shkruhet një fjalë në qendër të fletës, (dërrasës së zezë, apo sipërfaqes ku mund të shkruhet).
- Shkruhen fjalë apo fraza që vijnë në mend rreth kësaj fjale apo teme të zgjedhur, pa gjykuar rreth tyre.
- Kur idetë vijnë në mend të kësaj fjale apo teme të zgjedhur, pa gjykuar rreth tyre.
- Shkrimi i ideve ndërpritet vetëm kur mbaron koha e caktuar. Ndërkohë nxënësit nuk duhet të shqetësohen për gabimet në shkrim apo në shqiptim.

Kjo teknikë mund të përdoret në fazën e evokimit dhe të reflektimit, në të gjitha lëndët dhe me çdo moshë nxënësish. Ai mund të përdoret për të stimuluar të menduarit, përpara se të studiohet pjesa ose për të bërë përmbledhjen e asaj që është studiuar.

Shembulli 1.



Shembulli 2



Shembulli 3



• Teknika: Harta e të pyeturit

Është një skicë që shfaq idetë e rëndësishme të mësimit, të vendosura në një renditje logjike në trajtën e një skeme racionale pyetjesh, që lexohen dhe kuptohen me lehtësi nga nxënësit. Harta e të pyeturit mund të përdoret me sukses në fazën e realizmit, të kuptimit dhe të reflektimit. Një hartë e të pyeturit mund të përdoret për të menduar rreth çdo lloj çështjeje ose teme, ose gjatë një mësimi për të gjallëruar diskutimin e nxënësve, për t'i mbajtur ata të interesuar rreth problemit dhe për të përmbledhur informacionin e trajtuar.



• Vlerësimi i veprave të artit dhe Kritika e artit

Janë të përshtatshme për të mësuarit në grup. E gjithë klasa mund të bashkëpunojë si një e vetme, pa përplasje dhe rrëmujë. Për shkak të mënyrës se si komentet e nxënësve lidhen dhe ndërtohen mbi njëri-tjetrin, veprimtaritë mbi vlerësimin dhe kritikën e veprave të artit janë veçanërisht të përshtatshme për mësimdhënien si një grup i tërë klasës. Hapat e kritikës së artit janë: përshkrimi, analiza, interpretimi dhe gjykimi. Kjo është një metodë mësimore e bazuar në hulumtime që përmirëson të menduarit kritik dhe aftësitë gjuhësore nëpërmjet diskutimeve të imazheve vizuale.



3. Model i planifikimit vjetor dhe me periudha

PLANI VJETOR

Fusha e kurrikulës: Arte

Klasa: E dhjetë

Lëndët e fushës	**TEMAT MËSIMORE TË SHPËRNDARA GJATË MUAJVE**				**Kontributi në rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallë**
Lënda: Arti figurativ	**PERIUDHA (I)**		**PERIUDHA (II)**	**PERIUDHA (III)**	Komunikues efektiv I. 1, 3, 5, 8 Mendimi kreativ II.1,2, 4, 7, 8, 10 Nxënës i suksesshëm III. 1, 2, 3, 4, 6, 8 Kontribuues produktiv IV. 3, 4, 6, 8 Individ i shëndoshë V. 2, 4 Qytetar i përgjegjshëm VI. 1, 6, 7
	Shtator-Tetor **9 orë**	**Nëntor-Dhjetor** **8 orë**	**Janar-Shkurt-Mars** **11 orë**	**Prill-Maj-Qershor** **7 orë**	
	Vlerësimi i veprave artistike (1 orë)	Parimet e artit (2 orë)	Krijimi i punimeve (5 orë)	Histori arti (4 orë)	
	analiza e punimeve (1 orë)	Krijimi i punimeve artistike në teknika dhe mediume të ndryshme artistike (6 orë)	Ekspozita dhe aktivitete kulturore (1 orë)	Vizita dhe ngjarje artistike (1 orë)	
	vlerësimi i drejtimeve të artit (1orë)		Histori arti (5 orë)	Ekspozita dhe aktivitete kulturore (1 orë)	
	Elementet figurative (5 orë)			**Planifikime (1 orë)**	
	Parimet e artit (1 orë)				

PERIUDHA (I)

MUAJT: SHTATOR-TETOR/NËNTOR-DHJETOR

FUSHA E KURRIKULËS: ARTE

LËNDA MËSIMORE: ARTI FIGURATIV

KLASA: X

TEMA MËSIMORE: VLERËSIMI I VEPRAVE ARTISTIKE

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temave:

Komunikues efektiv

I.1. Shpreh mendimin e vet me gojë ose me shkrim, apo në ndonjë formë tjetër të të shprehurit (simbole, kode, shenja dhe shprehje të tjera artistike), për një temë të caktuar që reflekton aspekte të përgatitjes akademike në arsimin e mesëm të lartë.

Mendimi kreativ

II.2. Krahason të paktën tri burime të ndryshme të informimit për trajtimin e temës së njëjtë, argumenton saktësinë, rrethanat, gjen ngjashmëritë dhe dallimet, duke u bazuar në kriteret e përcaktuara më parë, i prezanton gjetjet kryesore para të tjerëve në forma të ndryshme shprehëse, duke përdorur teknologjinë informative.

Individi i suksesshëm

III.2. Shfrytëzon në mënyrë efektive përvojat paraprake gjatë zgjidhjes së situatave të ndryshme në jetën e përditshme apo gjatë kryerjes së ndonjë detyre, aktiviteti në ndonjë fushë të caktuar mësimore, diskuton dhe ndan përvojat me të tjerët për mënyrat më praktike të shfrytëzimit të përvojave paraprake në arritjen e dijeve të reja.

Kontribuues produktiv

IV.3. Hulumton dhe shfrytëzon mundësitë relevante në dispozicion për zgjedhje të suksesshme të shkollimit të mëtejshëm apo për përgatitje profesionale dhe për këshillim në karrierë, duke përdorur me sukses njohuritë dhe shkathtësitë që i zotëron.

Individ i shëndoshë

V.4. Ilustron me shembuj para të tjerëve modelet/praktikat e sjelljeve që reflektojnë mënyrat e mbrojtjes dhe të kultivimit të kulturës së vet, vlerave, besimeve dhe kulturave të të tjerëve në mjedisin ku jeton dhe me gjerë.

Qytetar i përgjegjshëm

VI.6. Demonstron veprime të ndryshme që shprehin tolerancë, respekt dhe qëndrim të hapur ndaj dallimeve në komunitetin ku jeton (në klasë, në shkollë, në lagje dhe me gjerë) dhe i shpjegon ato në një debat me të tjerët.

Rezultate e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temave:

1.1. Demonstron të kuptuarit se si artet komunikojnë ide përmes vlerave personale dhe shoqërore të inspiruar nga imagjinata individuale dhe konteksti historik, kulturor dhe social i krijuesit.
1.3. Zhvillon aftësinë e shijimit dhe përjetimit të veprave artistike duke kultivuar dhe rafinuar shijen e tij/saj estetike në art.

TEMA MËSIMORE: ANALIZA E PUNIMEVE

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temave:

Komunikues efektiv:

I.1. Shpreh mendimin e vet me gojë ose me shkrim, apo në ndonjë formë tjetër të të shprehurit (simbole, kode, shenja dhe shprehje të tjera artistike), për një temë të caktuar që reflekton aspekte të përgatitjes akademike në arsimin e mesëm të lartë.
I.3. Diskuton në mënyrë konstruktive (në gjuhë amtare dhe/ose në një gjuhë të huaj) me moshatarët dhe të rriturit për tema me interes mësimor, shoqëror ose nga jeta e përditshme, duke bërë pyetje, përgjigje dhe duke veçuar informacionin kryesor.

Mendimtar kreativ:

II.1. Prezanton mënyrën e grumbullimit, të zgjedhjes dhe të klasifikimit të informatave për fusha të ndryshme mësimore apo për një temë të caktuar, ofron argumente për zhvillimet aktuale lidhur me temën përkatëse (p.sh., temë nga shkenca, kultura, arti, sporti, shëndetësia, shoqëria, mjedisi etj.).

Nxënës i suksesshëm

III.2. Shfrytëzon në mënyrë efektive përvojat paraprake gjatë zgjidhjes së situatave të ndryshme në jetën e përditshme apo gjatë kryerjes së ndonjë detyre, aktiviteti në ndonjë fushë të caktuar mësimore, diskuton dhe ndan përvojat me të tjerët për mënyrat më praktike të shfrytëzimit të përvojave paraprake në arritjen e dijeve të reja.

Kontribuues produktiv

IV.3. Hulumton dhe shfrytëzon mundësitë relevante në dispozicion për zgjedhje të suksesshme të shkollimit të mëtejshëm apo për përgatitje profesionale dhe për këshillim në karrierë, duke përdorur me sukses njohuritë dhe shkathtësitë që i zotëron.

Individ i shëndoshë

V.4. Ilustron me shembuj para të tjerëve modelet/praktikat e sjelljeve që reflektojnë mënyrat e mbrojtjes dhe të kultivimit të kulturës së vet, vlerave, besimeve dhe kulturave të të tjerëve në mjedisin ku jeton dhe me gjerë.

Qytetar i përgjegjshëm

VI.6. Demonstron veprime të ndryshme që shprehin tolerancë, respekt dhe qëndrim të hapur ndaj dallimeve në komunitetin ku jeton (në klasë, në shkollë, në lagje dhe me gjerë) dhe i shpjegon ato në një debat me të tjerët.

Rezultate e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temave:

4.1. Demonstron të kuptuarit se si artet komunikojnë ide përmes vlerave personale dhe shoqërore të inspiruar nga imagjinata individuale dhe konteksti historik, kulturor dhe social i krijuesit.
4.2. Zhvillon mendimin e tij/saj kritik dhe analitik për të vlerësuar veprat e ndryshme të artit në aspektin estetik.
4.3. Zhvillon aftësinë e shijimit dhe përjetimit të veprave artistike duke kultivuar dhe rafinuar shijen e tij/saj estetike në art.

TEMA MËSIMORE: VLERËSIMI I DREJTIMEVE TË ARTIT

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temave:

Komunikues efektiv

I.1. Shpreh mendimin e vet me gojë ose me shkrim, apo në ndonjë formë tjetër të të shprehurit (simbole, kode, shenja dhe shprehje të tjera artistike), për një temë të caktuar që reflekton aspekte të përgatitjes akademike në arsimin e mesëm të lartë.
I.3. Diskuton në mënyrë konstruktive (në gjuhë amtare dhe/ose në një gjuhë të huaj) me moshatarët dhe të rriturit për tema me interes mësimor, shoqëror ose nga jeta e përditshme, duke bërë pyetje, përgjigje dhe duke veçuar informacionin kryesor.

Mendimtar kreativ

II.1. Prezanton mënyrën e grumbullimit, të zgjedhjes dhe të klasifikimit të informatave për fusha të ndryshme mësimore apo për një temë të caktuar, ofron argumente për zhvillimet aktuale lidhur me temën përkatëse (p.sh., temë nga shkenca, kultura, arti, sporti, shëndetësia, shoqëria, mjedisi etj.).

Nxënës i suksesshëm

III.2. Shfrytëzon në mënyrë efektive përvojat paraprake gjatë zgjidhjes së situatave të ndryshme në jetën e përditshme apo gjatë kryerjes së ndonjë detyre, aktiviteti në ndonjë fushë të caktuar mësimore, diskuton dhe ndan përvojat me të tjerët për mënyrat më praktike të shfrytëzimit të përvojave paraprake në arritjen e dijeve të reja.

Kontribuues produktiv

IV.3. Hulumton dhe shfrytëzon mundësitë relevante në dispozicion për zgjedhje të suksesshme të shkollimit të mëtejshëm apo për përgatitje profesionale dhe për këshillim në karrierë, duke përdorur me sukses njohuritë dhe shkathtësitë që i zotëron.

Individ i shëndoshë

V.4. Ilustron me shembuj para të tjerëve modelet/praktikat e sjelljeve që reflektojnë mënyrat e mbrojtjes dhe të kultivimit të kulturës së vet, vlerave, besimeve dhe kulturave të të tjerëve në mjedisin ku jeton dhe me gjerë.

Qytetar i përgjegjshëm

VI.6. Demonstron veprime të ndryshme që shprehin tolerancë, respekt dhe qëndrim të hapur ndaj dallimeve në komunitetin ku jeton (në klasë, në shkollë, në lagje dhe me gjerë) dhe i shpjegon ato në një debat me të tjerët.

Rezultate e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temave:

4.1. Demonstron të kuptuarit se si artet komunikojnë ide përmes vlerave personale dhe shoqërore të inspiruar nga imagjinata individuale dhe konteksti historik, kulturor dhe social i krijuesit.
4.2. Zhvillon mendimin e tij/saj kritik dhe analitik për të vlerësuar veprat e ndryshme të artit në aspektin estetik.
4.3. Zhvillon aftësinë e shijimit dhe përjetimit të veprave artistike duke kultivuar dhe rafinuar shijen e tij/saj estetike në art.

TEMA MËSIMORE: ELEMENTET FIGURATIVE

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temave:

Komunikues efektiv

I.1. Shpreh mendimin e vet me gojë ose me shkrim, apo në ndonjë formë tjetër të të shprehurit (simbole, kode, shenja dhe shprehje të tjera artistike), për një temë të caktuar që reflekton aspekte të përgatitjes akademike në arsimin e mesëm të lartë.

Mendimtar kreativ

II.1. Prezanton mënyrën e grumbullimit, të zgjedhjes dhe të klasifikimit të informatave për fusha të ndryshme mësimore apo për një temë të caktuar, ofron argumente për zhvillimet aktuale lidhur me temën përkatëse (p.sh., temë nga shkenca, kultura, arti, sporti, shëndetësia, shoqëria, mjedisi etj.).
II.8. Krijon një vepër artistike me pamje dy dhe tredimensionale me mesazhe nga një fushë mësimore dhe shpjegon para moshatarëve hapat e ndjekur për krijimin e veprës.

Nxënës i suksesshëm

III.3. Parashtron pyetje dhe shfaq mendime të strukturuara për zgjidhjen e një problemi apo detyre të një teme të caktuar, bën përmbledhjen e së paku dy veprimeve të përdorura të cilat përcaktojnë drejtimin e mëtejmë të të nxënit të vet për temën apo problemin e caktuar.

Kontribuues produktiv

IV.3. Hulumton dhe shfrytëzon mundësitë relevante në dispozicion për zgjedhje të suksesshme të shkollimit të mëtejshëm apo për përgatitje profesionale dhe për këshillim në karrierë, duke përdorur me sukses njohuritë dhe shkathtësitë që i zotëron.

Individ i shëndoshë

V.4. Ilustron me shembuj para të tjerëve modelet/praktikat e sjelljeve që reflektojnë mënyrat e mbrojtjes dhe të kultivimit të kulturës së vet, vlerave, besimeve dhe kulturave të të tjerëve në mjedisin ku jeton dhe me gjerë.

Qytetar i përgjegjshëm

VI.7. Diskuton me të tjerët apo në një formë tjetër të të shprehurit paraqet interesin personal për çështje publike, shoqërore, historike, natyrore etj., dhe jep propozime për zgjidhjen e ndonjë problemi në komunitet e më gjerë në një fushë të caktuar.

Rezultate e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temave:

2.1 Përdor elementet e gjuhës së artit për të komunikuar idetë e veta përmes veprave artistike në nivel më të avancuar.
2.2 Eksperimenton dhe përzgjedh mundësitë shprehëse të teknikave të ndryshme artistike, në realizimin e punimeve artistike të nivelit më të avancuar.
2.3 Komunikon me mjetet shprehëse artistike përkatëse (muzikë, dramë, vallëzim dhe arte vizuale) në mënyrë të përshtatshme për audienca të ndryshme (kolegë, prindër, fëmijë te tjerë, publik më i gjerë etj.).

TEMA MËSIMORE: PARIMET E ARTIT

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temave:

Komunikues efektiv

I.1. Shpreh mendimin e vet me gojë ose me shkrim, apo në ndonjë formë tjetër të të shprehurit (simbole, kode, shenja dhe shprehje të tjera artistike), për një temë të caktuar që reflekton aspekte të përgatitjes akademike në arsimin e mesëm të lartë.

Mendimtar kreativ

II.1. Prezanton mënyrën e grumbullimit, të zgjedhjes dhe të klasifikimit të informatave për fusha të ndryshme mësimore apo për një temë të caktuar, ofron argumente për zhvillimet aktuale lidhur me temën përkatëse (p.sh., temë nga shkenca, kultura, arti, sporti, shëndetësia, shoqëria, mjedisi etj.).
II.8. Krijon një vepër artistike me pamje dy dhe tredimensionale me mesazhe nga një fushë mësimore dhe shpjegon para moshatarëve hapat e ndjekur për krijimin e veprës.

Nxënës i suksesshëm

III.3. Parashtron pyetje dhe shfaq mendime të strukturuara për zgjidhjen e një problemi apo detyre të një teme të caktuar, bën përmbledhjen e së paku dy veprimeve të përdorura të cilat përcaktojnë drejtimin e mëtejmë të të nxënit të vet për temën apo problemin e caktuar.
III.8. Paraqet idetë personale para të tjerëve për mënyrën e zhvillimit të një aktiviteti të caktuar duke dhënë mendime të argumentuara për rezultatet e pritura (në formë skice, grafiku, vizatimi, shkrimi, vepre artistike etj.).

Kontribuues produktiv

IV.3. Hulumton dhe shfrytëzon mundësitë relevante në dispozicion për zgjedhje të suksesshme të shkollimit të mëtejshëm apo për përgatitje profesionale dhe për kështillim në karrierë, duke përdorur me sukses njohuritë dhe shkathtësitë që zotëron.

Individ i shëndoshë

V.4. Ilustron me shembuj para të tjerëve modelet/praktikat e sjelljeve që reflektojnë mënyrat e mbrojtjes dhe të kultivimit të kulturës së vet, vlerave, besimeve dhe kulturave të të tjerëve në mjedisin ku jeton dhe me gjerë.

Qytetar i përgjegjshëm

VI.7. Diskuton me të tjerët apo në një formë tjetër të të shprehurit paraqet interesin personal për çështje publike, shoqërore, historike, natyrore etj., dhe jep propozime për zgjidhjen e ndonjë problemi në komunitet e më gjerë në një fushë të caktuar.

Rezultate e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temave:

2.1 Përdor elementet e gjuhës së artit për të komunikuar idetë e veta përmes veprave artistike në nivel më të avancuar.
2.2 Eksperimenton dhe përzgjedh mundësitë shprehëse të teknikave të ndryshme artistike, në realizimin e punimeve artistike të nivelit më të avancuar.
2.3 Komunikon me mjetet shprehëse artistike përkatëse (muzikë, dramë, vallëzim dhe arte vizuale) në mënyrë të përshtatshme për audienca të ndryshme (kolegë, prindër, fëmijë te tjerë, publik më i gjerë etj.).
Krijimi i punimeve artistike në teknika dhe mediume të ndryshme artistike.

TEMA MËSIMORE: KRIJIMI I PUNIMEVE ARTISTIKE NË TEKNIKA DHE MEDIUME TË NDRYSHME ARTISTIKE

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temave:

Komunikues efektiv

I.5. Jep dhe merr informacione në mënyrë konstruktive dhe krijuese për të dhënat e mbledhura për një temë të caktuar në formë tekstuale, numerike, verbale, elektronike apo në ndonjë formë tjetër të të shprehurit.

Mendimtar kreativ

II.4. Modelon zgjidhjen e një problemi të dhënë (në klasë, apo jashtë saj) për një temë të caktuar nga një fushë mësimore, duke e zbërthyer në hapa të vegjël dhe jep sqarime të nevojshme për hapat e ndjekur në zgjidhjen e problemit, duke përdorur forma të ndryshme të të shprehurit.
II.8. Krijon një vepër artistike me pamje dy dhe tredimensionale me mesazhe nga një fushë mësimore dhe shpjegon para moshatarëve hapat e ndjekur për krijimin e veprës.

Nxënës i suksesshëm

III.3. Parashtron pyetje dhe shfaq mendime të strukturuara për zgjidhjen e një problemi apo detyre të një teme të caktuar, bën përmbledhjen e së paku dy veprimeve të përdorura të cilat përcaktojnë drejtimin e mëtejmë të të nxënit të vet për temën apo problemin e caktuar.
III.6. Shfrytëzon në mënyrë të pavarur dhe efektive teknologjinë informative dhe burime të tjera të informimit për të mbledhur materiale për zgjidhjen e një problemi apo detyre të caktuar, të cilat më pas i analizon, i klasifikon dhe i paraqet para të tjerëve përmes TIK-ut dhe ndonjë forme tjetër të shprehjes.

Kontribuues produktiv

IV.3. Hulumton dhe shfrytëzon mundësitë relevante në dispozicion për zgjedhje të suksesshme të shkollimit të mëtejshëm apo për përgatitje profesionale dhe për kështillim në karrierë, duke përdorur me sukses njohuritë dhe shkathtësitë që i zotëron.

Individ i shëndoshë

V.4. Ilustron me shembuj para të tjerëve modelet/praktikat e sjelljeve që reflektojnë mënyrat e mbrojtjes dhe të kultivimit të kulturës së vet, vlerave, besimeve dhe kulturave të të tjerëve në mjedisin ku jeton dhe me gjerë.

Qytetar i përgjegjshëm

VI.6. Demonstron veprime të ndryshme që shprehin tolerancë, respekt dhe qëndrim të hapur ndaj dallimeve në komunitetin ku jeton (në klasë, në shkollë, në lagje dhe me gjerë) dhe i shpjegon ato në një debat me të tjerët.

Rezultate e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temave:

1.1. Krijon vepra artistike duke përdorur mjete të ndryshme shprehëse për të komunikuar dhe shprehur përjetimet, ndjenjat dhe idetë personale.
1.2. Prezanton aftësitë e tij/saj krijuese dhe interpretuese në klasë dhe para një audience të caktuar me vetëbesim dhe siguri.

PERIUDHA (I) MUAJT: SHTATOR – TETOR/NËNTOR - DHJETOR							
Temat mësimore	**Rezultatet e të nxënit për tema mësimore**	**Njësitë mësimore**	**Koha mësimore (orë mësimore)**	**Metodologjia e mësimdhënies**	**Metodologjia e vlerësimit**	**Ndërlidhja me lëndë** **të tjera mësimore dhe me** çështjet **ndërkurrikulare**	**Burimet**
Vlerësimi i veprave artistike Analiza e punimeve Vlerësimi i drejtimeve të artit	Kultivon aftësinë e shijimit dhe përjetimit të veprave artistike dhe rafinon shijen e tij estetike në art. Krijon kulturën debatuese për diskutimin dhe trajtimin e çështjeve dhe problemeve të artit Zhvillon aftësinë se Si të lexojmë një vepër arti? Njihet me metodat dhe hapat që ndjekin kritikët për të vlerësuar veprat e artit. Reflekton mendimin dhe gjykimin e tij mbi një vepër arti, përmes formave të ndryshme të të shprehurit si përmes shkrimit (esesë), poezisë etj.	Arti dhe studimi i tij Kritika e artit: Të mësojmë nga veprat e artit	17	Bisedë Diskutim hulumtimi Brainstorming Diagrami i Venit Punë në grupe Punë individuale Harta e të pyeturit Kllasteri Hapat e kritikës së artit	Buletini i pjesëmarrjes Portofoli e nxënësit Vlerësim i ndërsjellë	Njeriu dhe natyra Gjuhë shqipe Edukatë figurative Edukatë muzikore Edukata fizike, sporte dhe shëndeti Shoqëria dhe mjedisi Gjuhë angleze Matematikë Çështjet **ndërkurrikulare** Mbrojtja e mjedisit dhe zhvillimi i qëndrimeve ekologjike	Teksti shkollor Softuerë arsimorë Imazhe ilustruese Cd

PERIUDHA (I) MUAJT: SHTATOR – TETOR/NËNTOR - DHJETOR							
Temat mësimore	**Rezultatet e të nxënit për tema mësimore**	**Njësitë mësimore**	**Koha mësimore (orë mësimore)**	**Metodologjia e mësimdhënies**	**Metodologjia e vlerësimit**	**Ndërlidhja me lëndë** **të tjera mësimore dhe me** çështjet **ndërkurrikulare**	**Burimet**
Elementet figurative Parimet e artit	Të menduarit kritik dhe analitik për të vlerësuar veprat e ndryshme të artit në aspektin estetik. Dallon objektin e studimit të estetikës dhe cilësitë estetike në një vepër arti. Reflekton mendimin dhe gjykimin e tij mbi një vepër arti, përmes formave të ndryshme të të shprehurit si përmes shkrimit (esesë), poezisë etj. Njeh dhe përshkruan rëndësinë e vijës si element figurative. Dallon dhe përdor lloje të ndryshme të vijave për të realizuar punime artistike.	Estetika: Cilësitë estetike dhe teoritë e artit Vija Forma dy - dhe tredimensionale				Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm Zhvillimi personal dhe shkathtësitë për jetë Globalizimi dhe ndërvarësia Edukimi për media	

PERIUDHA (I) MUAJT: SHTATOR – TETOR/NËNTOR - DHJETOR							
Temat mësimore	**Rezultatet e të nxënit për tema mësimore**	**Njësitë mësimore**	**Koha mësimore (orë mësimore)**	**Metodologjia e mësimdhënies**	**Metodologjia e vlerësimit**	**Ndërlidhja me lëndë** **të tjera mësimore dhe me** çështjet **ndërkurrikulare**	**Burimet**
Krijimi i punimeve	Dallon formën dydimensionale nga forma tridimensionale. Realizon punimi duke përdorur elementin e formës. Përshkruan dhe shpjegon rolin dhe rëndësinë e ngjyrave në art pamor. Dallon llojet e ngjyrave dhe aplikon ato në punimet artistike. Përshkruan procesin e realizimit të toneve të ndryshme në vepra artistike. Identifikon llojet e ndryshme të toneve dhe përdor ato në punimet e tij.	Ngjyrat Tekstura					

PERIUDHA (I) MUAJT: SHTATOR – TETOR/NËNTOR - DHJETOR							
Temat mësimore	**Rezultatet e të nxënit për tema mësimore**	**Njësitë mësimore**	**Koha mësimore (orë mësimore)**	**Metodologjia e mësimdhënies**	**Metodologjia e vlerësimit**	**Ndërlidhja me lëndë** **të tjera mësimore dhe me** çështjet **ndërkurrikulare**	**Burimet**
	Dallon lloje të ndryshme teksturash për të krijuar një punim me teksturë. Shpjegon procesin e realizimit të teksturave të ndryshme. Dallon dhe përshkruan llojet e ndryshme të hapësirës (dallimin midis hapësirës reale dhe artistike). Përdor perspektivën me një pikë dhe dy pika për të krijuar iluzionin e hapësirës në punimet dydimensionale. Analizon dhe vlerëson krijimet artistike vetjake dhe të tjerëve duke analizuar, elementet, parimet dhe teknikat e gjuhës artistike.	Hapësira Parimet e artit: Harmonia dhe ritmi, theksi dhe kontrasti, lëvizja, proporcionet.					

PERIUDHA (I) MUAJT: SHTATOR – TETOR/NËNTOR - DHJETOR							
Temat mësimore	**Rezultatet e të nxënit për tema mësimore**	**Njësitë mësimore**	**Koha mësimore (orë mësimore)**	**Metodologjia e mësimdhënies**	**Metodologjia e vlerësimit**	**Ndërlidhja me lëndë** **të tjera mësimore dhe me** çështjet **ndërkurrikulare**	**Burimet**
	Përshkruan dhe identifikon harmoninë në vepra të ndryshme artistike. Analizojnë ritmin në punime të ndryshme artistike të artistëve të njohur dhe në punimet e tyre apo të shokëve. Shpjegon dhe përshkruan rolin dhe rëndësinë e proporcioneve për realizimin e saktë të raportit në mes të formave të ndryshme. Identifikojnë rëndësinë dhe karakteristikat e kontrastit për të bërë dallimin midis elementeve të ndryshme figurative në një vepër arti.	Teknika e vizatimit në ilustrimet komike					

PERIUDHA (I) MUAJT: SHTATOR – TETOR/NËNTOR - DHJETOR							
Temat mësimore	**Rezultatet e të nxënit për tema mësimore**	**Njësitë mësimore**	**Koha mësimore (orë mësimore)**	**Metodologjia e mësimdhënies**	**Metodologjia e vlerësimit**	**Ndërlidhja me lëndë** **të tjera mësimore dhe me** çështjet **ndërkurrikulare**	**Burimet**
	Dallon llojet e vizatimit, të cilat i praktikon në realizimin e veprave artistike vizatimore. Përzgjedh dhe përdor teknika të ndryshme të vizatimit. Dallon dhe përdor teknika të ndryshme të pikturës për të realizuar punime artistike. Krijon duke përdorur njohuritë e teorisë së ngjyrave (ngjyrën, vlerën, intensitetin etj.). Dallon artin aplikativ nga arti figurative. Dallon karakteristika të veçanta të pikturës aplikative.	Piktura mbi pëlhurë Kolazhi					

PERIUDHA (I) MUAJT: SHTATOR – TETOR/NËNTOR - DHJETOR							
Temat mësimore	**Rezultatet e të nxënit për tema mësimore**	**Njësitë mësimore**	**Koha mësimore (orë mësimore)**	**Metodologjia e mësimdhënies**	**Metodologjia e vlerësimit**	**Ndërlidhja me lëndë** **të tjera mësimore dhe me** çështjet **ndërkurrikulare**	**Burimet**
	Dallon artin aplikativ nga arti figurative. Realizon piktura aplikative në teknikën e mozaikut. Njeh karakteristikat dhe veçoritë shprehëse të grafikës. Aplikon dhe përvetëson teknikat e grafikës gjatë punës së të shprehurit artistik. Realizon fotografi artistike duke përdorur mjetet dhe teknikat manuale apo digjitale. Përpunon imazhe fotografike duke përdorur programe të ndryshme kompjuterike.	Mozaiku Teknikat grafike të shtypit					

PERIUDHA (I) MUAJT: SHTATOR – TETOR/NËNTOR - DHJETOR							
Temat mësimore	**Rezultatet e të nxënit për tema mësimore**	**Njësitë mësimore**	**Koha mësimore (orë mësimore)**	**Metodologjia e mësimdhënies**	**Metodologjia e vlerësimit**	**Ndërlidhja me lëndë** të **tjera mësimore dhe me** çështjet **ndërkurrikulare**	**Burimet**
	Analizon dhe vlerëson krijimet artistike vetjake dhe të tjerëve, duke analizuar, elementet, parimet dhe teknikat e gjuhës artistike.	Fotografia					

PERIUDHA (II)

MUAJT: JANAR, SHKURT, MARS

FUSHA E KURRIKULËS: ARTE

LËNDA MËSIMORE: ARTI FIGURATIV

KLASA: X

TEMA MËSIMORE: KRIJIMI I PUNIMEVE ARTISTIKE NË TEKNIKA DHE MEDIUME TË NDRYSHME ARTISTIKE

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temave:

Komunikues efektiv

I.3. Diskuton në mënyrë konstruktive (në gjuhë amtare dhe/ose në një gjuhë të huaj) me moshatarët dhe të rriturit për tema me interes mësimor, shoqëror ose nga jeta e përditshme, duke bërë pyetje, përgjigje dhe duke veçuar informacionin kryesor.
I.5. Jep dhe merr informacione në mënyrë konstruktive dhe krijuese për të dhënat e mbledhura për një temë të caktuar në formë tekstuale, numerike, verbale, elektronike apo në ndonjë formë tjetër të të shprehurit.

Mendimtar kreativ

II.1. Prezanton mënyrën e grumbullimit, të zgjedhjes dhe të klasifikimit të informatave për fusha të ndryshme mësimore apo për një temë të caktuar, ofron argumente për zhvillimet aktuale lidhur me temën përkatëse (p.sh., temë nga shkenca, kultura, arti, sporti, shëndetësia, shoqëria, mjedisi etj.).
II.4. Modelon zgjidhjen e një problemi të dhënë (në klasë, apo jashtë saj) për një temë të caktuar nga një fushë mësimore, duke e zbërthyer në hapa të vegjël dhe jep sqarime të nevojshme për hapat e ndjekur në zgjidhjen e problemit, duke përdorur forma të ndryshme të të shprehurit.
II.8. Krijon një vepër artistike me pamje dy dhe tredimensionale me mesazhe nga një fushë mësimore dhe shpjegon para moshatarëve hapat e ndjekur për krijimin e veprës.

Nxënës i suksesshëm

III.3. Parashtron pyetje dhe shfaq mendime të strukturuara për zgjidhjen e një problemi apo detyre të një teme të caktuar, bën përmbledhjen e së paku dy veprimeve të përdorura të cilat përcaktojnë drejtimin e mëtejmë të të nxënit të vet për temën apo problemin e caktuar.
III.4. Zgjidh një problem të caktuar mësimor ose një situatë nga jeta e përditshme në bazë të një planifikimi të dhënë dhe në bazë të rezultatit të ftuar vërteton saktësinë e planifikimit dhe tregon me shembuj se si do të zbatojë strategjinë e ndjekur edhe në situata dhe kontekste të tjera gjatë të nxënit.
III.6. Shfrytëzon në mënyrë të pavarur dhe efektive teknologjinë informative dhe burime të tjera të informimit për të mbledhur materiale për zgjidhjen e një problemi apo detyre të caktuar, të cilat më pas i analizon, i klasifikon dhe i paraqet para të tjerëve përmes TIK-ut dhe ndonjë forme tjetër të shprehjes.

Kontribuues produktiv

IV.3. Hulumton dhe shfrytëzon mundësitë relevante në dispozicion për zgjedhje të suksesshme të shkollimit të mëtejshëm apo për përgatitje profesionale dhe për këshillim në karrierë, duke përdorur me sukses njohuritë dhe shkathtësitë që i zotëron.
IV.8. Analizon gjendjen e mjedisit (në klasë, në shkollë, në komunitet apo më gjerë), pasojat e ndotjes, propozon alternativa për mbikëqyrje dhe menaxhim të drejtë të gjendjes së vlerësuar më të ndjeshme dhe inicion zgjidhje konkrete.

Individ i shëndoshë

V.2. Merr pjesë aktivisht në lojëra, në gara sportive apo në aktivitete të tjera kulturore dhe në mënyrë konstruktive menaxhon emocionet e veta.
V.4. Ilustron me shembuj para të tjerëve modelet/praktikat e sjelljeve që reflektojnë mënyrat e mbrojtjes dhe të kultivimit të kulturës së vet, vlerave, besimeve dhe kulturave të të tjerëve në mjedisin ku jeton dhe më gjerë.

Qytetar i përgjegjshëm

VI.6. Demonstron veprime të ndryshme që shprehin tolerancë, respekt dhe qëndrim të hapur ndaj dallimeve në komunitetin ku jeton (në klasë, në shkollë, në lagje dhe më gjerë) dhe i shpjegon ato në një debat me të tjerët.
VI.7. Diskuton me të tjerët apo në një formë tjetër të të shprehurit paraqet interesin personal për çështje publike, shoqërore, historike, natyrore etj., dhe jep propozime për zgjidhjen e ndonjë problemi në komunitet e më gjerë në një fushë të caktuar.

Rezultate e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temave:
1.1. Krijon vepra artistike duke përdorur mjete të ndryshme shprehëse për të komunikuar dhe shprehur përjetimet, ndjenjat dhe idetë personale.
1.2. Prezanton aftësitë e tij/saj krijuese dhe interpretuese në klasë dhe para një audience të caktuar me vetëbesim dhe siguri.

TEMA MËSIMORE: EKSPOZITA DHE AKTIVITETE KULTURORE

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temave:

Komunikues efektiv

I.3. Diskuton në mënyrë konstruktive (në gjuhë amtare dhe/ose në një gjuhë të huaj) me moshatarët dhe të rriturit për tema me interes mësimor, shoqëror ose nga jeta e përditshme, duke bërë pyetje, përgjigje dhe duke veçuar informacionin kryesor.
I.8. Prezanton një projekt artistik, humanitar, eksperimentues etj.) nga fusha të ndryshme mësimore, të hartuar individualisht dhe në grup për një temë të caktuar, duke përdorur në mënyrë efektive teknologjinë informative dhe teknologji të tjera.

Mendimtar kreativ

II.1. Prezanton mënyrën e grumbullimit, të zgjedhjes dhe të klasifkimit të informatave për fusha të ndryshme mësimore apo për një temë të caktuar, ofron argumente për zhvillimet aktuale lidhur me temën përkatëse (p.sh., temë nga shkenca, kultura, arti, sporti, shëndetësia, shoqëria, mjedisi etj.).
II.10. Simulon një situatë për marrjen e një vendimi për jetën e vet ose zgjidhjen e një problemi me interes shoqëror, lidh vendimin me pasojat në mënyrë të përgjegjshme, e prezanton gjatë një debati me moshatarë në një kohëzgjatje të caktuar, duke u bazuar në këtë përvojë merr vendime dhe iniciativa të dobishme për vete, për shkollën dhe më gjerë.

Nxënës i suksesshëm

III.4. Zgjidh një problem të caktuar mësimor ose një situatë nga jeta e përditshme. Në bazë të një planifikimi të dhënë dhe në bazë të rezultatit të ftuar vërteton saktësinë e planifikimit dhe tregon me shembuj se si do të zbatojë strategjinë e ndjekur edhe në situata dhe kontekste të tjera gjatë të nxënit.

Kontribuues produktiv

IV.6. Harton një projekt (individualisht ose në grup) për organizimin e një aktiviteti me karakter edukativ brenda ose jashtë shkollës, në të cilin identifikon dhe vlerëson resurset e nevojshme njerëzore dhe materiale që mundësojnë arritjen e objektivave të caktuara.
IV.8. Analizon gjendjen e mjedisit (në klasë, në shkollë, në komunitet apo më gjerë), pasojat e ndotjes, propozon alternativa për mbikëqyrje dhe menaxhim të drejtë të gjendjes së vlerësuar më të ndjeshme dhe inicion zgjidhje konkrete.

Individ i shëndoshë

V.2. Merr pjesë aktivisht në lojëra, në gara sportive apo në aktivitete të tjera kulturore dhe në mënyrë konstruktive menaxhon emocionet e veta.

Qytetar i përgjegjshëm

- në analizën vlerësuese që nxënësit i bëjnë punës së tyre dhe të shokëve/shoqeve.

Detyrat dhe puna e pavarur

Punë individuale (detyrë shtëpie)

Eksperimenton me mundësitë e shumta shprehëse të formës dy dhe tredimensionale duke përdorur materiale sipas dëshirës (mund të krijojë objekte dizajni duke përdorur shiritin mobius).

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 6

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Arte	**Lënda:** Arti figurativ	**Shkalla e kurrikulës:** V	**Klasa:** X
Gjuha dhe komunikimi artistik **Tema**: Elementet figurative		**Rezultati i të nxënit të temës** (nga plani dymujor): Përshkruan dhe shpjegon rolin dhe rëndësinë e ngjyrave në art pamor. Dallon llojet e ngjyrave dhe aplikon ato në punimet artistike. Përshkruan procesin e realizimit të toneve të ndryshme në vepra artistike. Identifikon llojet e ndryshme të toneve dhe përdor ato në punimet e tij.	

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.1. Shpreh mendimin e vet me gojë ose me shkrim, apo në ndonjë formë tjetër të të shprehurit (simbole, kode, shenja dhe shprehje të tjera artistike), për një temë të caktuar që reflekton aspekte të përgatitjes akademike në arsimin e mesëm të lartë. II.1. Prezanton mënyrën e grumbullimit, të zgjedhjes dhe të klasifikimit të informatave për fusha të ndryshme mësimore apo për një temë të caktuar, ofron argumente për zhvillimet aktuale lidhur me temën përkatëse (p.sh., temë nga shkenca, kultura, arti, sporti, shëndetësia, shoqëria, mjedisi etj.). II.8. Krijon një vepër artistike me pamje dy dhe tredimensionale me mesazhe nga një fushë mësimore dhe shpjegon para moshatarëve hapat e ndjekur për krijimin e veprës. III.3. Parashtron pyetje dhe shfaq mendime të strukturuara për zgjidhjen e një problemi apo detyre të një teme të caktuar, bën përmbledhjen e së paku dy veprimeve të përdorura të cilat përcaktojnë drejtimin e mëtejmë të të nxënit të vet për temën apo problemin e caktuar. IV.3. Hulumton dhe shfrytëzon mundësitë relevante në dispozicion për zgjedhje të suksesshme të shkollimit të mëtejshëm apo për përgatitje profesionale dhe për këshillim në karrierë, duke përdorur me sukses njohuritë dhe shkathtësitë që i zotëron. V.4. Ilustron me shembuj para të tjerëve modelet/praktikat e sjelljeve që reflektojnë mënyrat e mbrojtjes dhe të kultivimit të kulturës së vet, vlerave, besimeve dhe kulturave të të tjerëve në mjedisin ku jeton dhe më gjerë. VI.7. Diskuton me të tjerët apo në një formë tjetër të të shprehurit paraqet interesin personal për çështje publike, shoqërore, historike, natyrore etj., dhe jep propozime për zgjidhjen e ndonjë problemi në komunitet e më gjerë në një fushë të caktuar.
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 2.1 Përdor elementet e gjuhës së artit për të komunikuar idetë e veta përmes veprave artistike në nivel më të avancuar. 2.2 Eksperimenton dhe përzgjedh mundësitë shprehëse të teknikave të ndryshme artistike, në realizimin e punimeve artistike të nivelit më të avancuar. 2.3 Komunikon me mjetet shprehëse artistike përkatëse (muzikë, dramë, vallëzim dhe arte vizuale) në mënyrë të përshtatshme për audienca të ndryshme (kolegë, prindër, fëmijë te tjerë, publik më i gjerë etj.).
Aspektet specifike të planit të orës mësimore
Njësia mësimore: Ngjyrat
Fjalët kyçe: Kontrasti midis ngjyrave të pastra, kontrasti midis toneve bardhezi të ngjyrave, kontrasti i ngjyrave të ngrohta dhe të ftohta, kontrasti i ngjyrave plotësuese, ngjyra mbizotëruese, ngjyra në skulpturë dhe arkitekturë.
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore **Nxënësi/ja:** **- vëzhgon** me vetëdije përdorimin e ngjyrës në vepra të ndryshme të artit nga vende dhe periudha të ndryshme të historisë së artit; **- reflekton** mbi mënyrat e ndryshme të përdorimit të ngjyrës në vepra të ndryshme të artit dhe në arkitekturë; **- zbulon** mundësitë shprehëse të ngjyrës të përdorur nga artistët gjatë zhvillimit të historisë së artit; **- përdor** në mënyrë shprehëse ngjyrën, duke u mbështetur në vepra të ndryshme të historisë së artit për të komunikuar ide personale.
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Arti figurativ kl. X, Ilustrime të veprave të artit që ilustrojnë përdorimin e ngjyrës; mjete pune si: letër, fotografi dhe ngjyra sipas dëshirës etj.
Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Fusha: Shoqëria dhe mjedisi, Shkencat e natyrës, Gjuha dhe komunikimi
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: teknika e klasterit, bashkëbisedim
Mësuesi/ja i fton nxënësit të diskutojnë mbi njohuritë dhe eksperiencat e tyre mbi elementin e ngjyrës, dhe të rendisin në dërrasë konceptet mbi këtë njohuri. Ngjyrat e para dhe të dyta, rrethi i ngjyrave, ngjyrat e ngrohta dhe të ftohta, kontrasti i ngjyrave dhe mënyra se si shfaqen ato në veprat e artit, janë argumentet e diskutimit të tyre.

Ndërtimi i njohurive të reja: Kujtesa pamore, bisedë, punë individuale
Nëpërmjet imazheve të veprave të ndryshme të artit, nxënësit identifikojnë mundësitë shprehëse të ngjyrës. Ata/ato identifikojnë kontrastin midis ngjyrave të pastra, kontrastin e toneve bardhezi të ngjyrave, kontrastin e ngjyrave të ngrohta dhe të ftohta, kontrastin e ngjyrave plotësuese, mbizotërimin e një ngjyre, në vepra të ndryshme arti. Nxënësit zbulojnë dhe reflektojnë mbi përdorimin e ngjyrës në skulpturë dhe arkitekturë nëpërmjet shembujve të ndryshëm.

Veprimtari
Duke u mbështetur në veprat e artistit Klod Monet, i cili ishte i interesuar kryesisht për efektin e dritës mbi subjektet që ai pikturonte, nxënësit nxiten të **përzgjedhin** një imazh fotografik si në shembullin e dhënë në libër. Të rikrijojnë këtë imazh nëpërmjet siluetave si në formë ashtu edhe të dritëhijeve e më pas të përdorin raporte të ndryshme ngjyrash për secilin imazh duke zgjedhur teknikën sipas dëshirës.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: diskutimi
Në fund të orës së mësimit, nxënësit diskutojnë për krijimin e tyre dhe të shokëve, dhe mënyrën e realizimit të punimit nëpërmjet teknikës që zgjodhën. Ata diskutojnë mbi mundësitë e shumta shprehëse të ngjyrave në krijim.

Vlerësimi i nxënësve

Vlerësimi i nxënësit do të fokusohet:
- në diskutimet që ata/ato bëjnë, duke lidhur njohuritë e tyre me njësinë e re;
- në identifikimin e mundësive shprehëse të ngjyrës në vepra të ndryshme arti;
- në mënyrën e realizimit të detyrës;
- në analizën vlerësuese që nxënësit i bëjnë punës së tyre dhe të shokëve/shoqeve.

Detyrat dhe puna e pavarur

Punë individuale (detyrë shtëpie)
Eksperimenton me mundësitë e shumta shprehëse të ngjyrës duke përdorur imazhe fotografike ose krijime të vetat.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 7

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Arte	**Lënda:** Arti figurativ	**Shkalla e kurrikulës:** V	**Klasa:** X
Gjuha dhe komunikimi artistik **Tema**: Elementet figurative		**Rezultati i të nxënit të temës** (nga plani dymujor): Dallon lloje të ndryshme teksturash për të krijuar një punim me teksture. Shpjegon procesin e realizimit të teksturave të ndryshme.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.1. Shpreh mendimin e vet me gojë ose me shkrim, apo në ndonjë formë tjetër të të shprehurit (simbole, kode, shenja dhe shprehje të tjera artistike), për një temë të caktuar që reflekton aspekte të përgatitjes akademike në arsimin e mesëm të lartë.			

II.1. Prezanton mënyrën e grumbullimit, të zgjedhjes dhe të klasifikimit të informatave për fusha të ndryshme mësimore apo për një temë të caktuar, ofron argumente për zhvillimet aktuale lidhur me temën përkatëse (p.sh., temë nga shkenca, kultura, arti, sporti, shëndetësia, shoqëria, mjedisi etj.). II.8. Krijon një vepër artistike me pamje dy dhe tredimensionale me mesazhe nga një fushë mësimore dhe shpjegon para moshatarëve hapat e ndjekur për krijimin e veprës. III.3. Parashtron pyetje dhe shfaq mendime të strukturuara për zgjidhjen e një problemi apo detyre të një teme të caktuar, bën përmbledhjen e së paku dy veprimeve të përdorura të cilat përcaktojnë drejtimin e mëtejmë të të nxënit të vet për temën apo problemin e caktuar. IV.3. Hulumton dhe shfrytëzon mundësitë relevante në dispozicion për zgjedhje të suksesshme të shkollimit të mëtejshëm apo për përgatitje profesionale dhe për këshillim në karrierë, duke përdorur me sukses njohuritë dhe shkathtësitë që i zotëron. V.4. Ilustron me shembuj para të tjerëve modelet/praktikat e sjelljeve që reflektojnë mënyrat e mbrojtjes dhe të kultivimit të kulturës së vet, vlerave, besimeve dhe kulturave të të tjerëve në mjedisin ku jeton dhe më gjerë. VI.7. Diskuton me të tjerët apo në një formë tjetër të të shprehurit paraqet interesin personal për çështje publike, shoqërore, historike, natyrore etj., dhe jep propozime për zgjidhjen e ndonjë problemi në komunitet e më gjerë në një fushë të caktuar.
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 2.1 Përdor elementet e gjuhës së artit për të komunikuar idetë e veta përmes veprave artistike në nivel më të avancuar. 2.2 Eksperimenton dhe përzgjedh mundësitë shprehëse të teknikave të ndryshme artistike, në realizimin e punimeve artistike të nivelit më të avancuar. 2.3 Komunikon me mjetet shprehëse artistike përkatëse (muzikë, dramë, vallëzim dhe arte vizuale) në mënyrë të përshtatshme për audienca të ndryshme (kolegë, prindër, fëmijë të tjerë, publik më i gjerë etj.).
Aspektet specifike të planit të orës mësimore
Njësia mësimore: Tekstura
Fjalët kyçe: Tekstura, tekstura optike në pikturë, tekstura fizike ne pikturë, tekstura në skulpturë, tekstura në arkitekturë, tekstura si udhërrëfyes.
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore **Nxënësi/ja:** **- vëzhgon** me vetëdije përdorimin e teksturës në vepra të ndryshme të artit nga vende dhe periudha të ndryshme të historisë së artit; **- reflekton** mbi mënyrat e ndryshme të përdorimit të teksturës në vepra të ndryshme të artit dhe në arkitekturë; **- zbulon** mundësitë shprehëse të teksturës të përdorur nga artistët gjatë zhvillimit të historisë së artit; **- përdor** në mënyrë shprehëse teksturën, duke u mbështetur në vepra të ndryshme të historisë së artit për të komunikuar ide personale.
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Arti figurativ kl. X, Ilustrime të veprave të artit që ilustrojnë përdorimin e teksturës; mjete pune si: letër, laps dhe objekte me tekstura të shumëllojshme
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Fusha: Shoqëria dhe mjedisi, Shkencat e natyrës, Gjuha dhe komunikimi, Jeta dhe puna
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: teknika e kllasterit, bashkëbisedim Nxënësit diskutojnë mbi elementin e teksturës duke u mbështetur në njohuritë e tyre të mëparshme. Tekstura natyrale dhe gjeometrike, teksturave pikturë, skulpturë etj., janë argumentet e diskutimit të tyre.

Ndërtimi i njohurive të reja: Kujtesa pamore, bisedë, punë individuale
Nëpërmjet imazheve të veprave të ndryshme të artit ata identifikojnë teksturën në lidhje me stilin e artistit. Mësuesi/ja thekson që tekstura në një vepër arti realizohet në dy mënyra të ndryshme: nëpërmjet përzgjedhjes së materialit dhe mënyrës së përpunimit të tij.
Nëpërmjet rubrikës vëzhgojmë trajtohen këto çështje:

- Çështja e parë trajton Teksturën optike në pikturë. Nëpërmjet shembujve të veprave të artit nxënësit identifikojnë karakteristikat e kësaj teksture dhe mënyrën e realizimit të saj.
- Në çështjen e dytë trajtohet tekstura fizike në pikturë, shembull për të cilën është marrë vepra e artistit Alberto Burri.

Më pas trajtohet tekstura në skulpturë. Nëpërmjet shembujve të veprave të artit nxënësit identifikojnë mundësitë e realizimit të teksturës dhe rëndësinë që ka materiali i përdorur.
Në dy çështjet e tjera trajtohet tekstura në arkitekturë dhe si komunikim e udhërrëfyes. Nëpërmjet shembujve nxënësit identifikojnë karakteristikat e teksturës në arkitekturë në periudha të ndryshme kohore dhe rolin e materialit në krijimin e saj.
Veprimtari
Duke u mbështetur në një seri punimesh në teknikën e frotazhit të realizuara nga artisti Maks Ernst, nxënësit nxiten të krijojnë një punim në këtë teknikë duke përdorur objekte me tekstura interesante.
Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: diskutimi
Në fund të orës së mësimit, nxënësit diskutojnë për krijimin e tyre dhe të shokëve, dhe mënyrën e realizimit të punimit nëpërmjet teksturave të ndryshme. Ata diskutojnë mbi mundësitë e shumta shprehëse të teksturës në krijim duke iu referuar veprave të artit që analizuan.

Vlerësimi i nxënësve

Vlerësimi i nxënësit do të fokusohet:

- në diskutimet që ata/ato bëjnë, duke lidhur njohuritë e tyre me njësinë e re;
- në identifikimin e teksturës në vepra të ndryshme arti;
- në mënyrën e realizimit të detyrës;
- në analizën vlerësuese që nxënësit/et i bëjnë punës së tyre dhe të shokëve/shoqeve.

Detyrat dhe puna e pavarur

Punë individuale (detyrë shtëpie)
Eksperimenton me mundësitë e shumta shprehëse të teksturës duke krijuar punime origjinale (ose përfundon atë që ka nisur në klasë).

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 8

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Arte	**Lënda:** Arti figurativ	**Shkalla e kurrikulës:** V	**Klasa:** X
Gjuha dhe komunikimi artistik **Tema**: Elementet figurative		**Rezultati i të nxënit të temës** (nga plani dymujor): Dallon dhe përshkruan llojet e ndryshme të hapësirës (dallimin midis hapësirës reale dhe artistike). Përdor perspektivën me një pikë dhe dy pika për të krijuar iluzionin e hapësirës në punimet dydimensionale. Analizon dhe vlerëson krijimet artistike vetjake dhe të tjerëve duke analizuar, elementet, parimet dhe teknikat e gjuhës artistike.	

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.1. Shpreh mendimin e vet me gojë ose me shkrim, apo në ndonjë formë tjetër të të shprehurit (simbole, kode, shenja dhe shprehje të tjera artistike), për një temë të caktuar që reflekton aspekte të përgatitjes akademike në arsimin e mesëm të lartë. II.1. Prezanton mënyrën e grumbullimit, të zgjedhjes dhe të klasifikimit të informatave për fusha të ndryshme mësimore apo për një temë të caktuar, ofron argumente për zhvillimet aktuale lidhur me temën përkatëse (p.sh., temë nga shkenca, kultura, arti, sporti, shëndetësia, shoqëria, mjedisi etj.). II.8. Krijon një vepër artistike me pamje dy dhe tredimensionale me mesazhe nga një fushë mësimore dhe shpjegon para moshatarëve hapat e ndjekur për krijimin e veprës. III.3. Parashtron pyetje dhe shfaq mendime të strukturuara për zgjidhjen e një problemi apo detyre të një teme të caktuar, bën përmbledhjen e së paku dy veprimeve të përdorura të cilat përcaktojnë drejtimin e mëtejmë të të nxënit të vet për temën apo problemin e caktuar. IV.3. Hulumton dhe shfrytëzon mundësitë relevante në dispozicion për zgjedhje të suksesshme të shkollimit të mëtejshëm apo për përgatitje profesionale dhe për këshillim në karrierë, duke përdorur me sukses njohuritë dhe shkathtësitë që i zotëron. V.4. Ilustron me shembuj para të tjerëve modelet/praktikat e sjelljeve që reflektojnë mënyrat e mbrojtjes dhe të kultivimit të kulturës së vet, vlerave, besimeve dhe kulturave të të tjerëve në mjedisin ku jeton dhe më gjerë. VI.7. Diskuton me të tjerët apo në një formë tjetër të të shprehurit paraqet interesin personal për çështje publike, shoqërore, historike, natyrore etj., dhe jep propozime për zgjidhjen e ndonjë problemi në komunitet e më gjerë në një fushë të caktuar.
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 2.1 Përdor elementet e gjuhës së artit për të komunikuar idetë e veta përmes veprave artistike në nivel më të avancuar. 2.2 Eksperimenton dhe përzgjedh mundësitë shprehëse të teknikave të ndryshme artistike, në realizimin e punimeve artistike të nivelit më të avancuar. 2.3 Komunikon me mjetet shprehëse artistike përkatëse (muzikë, dramë, vallëzim dhe arte vizuale) në mënyrë të përshtatshme për audienca të ndryshme (kolegë, prindër, fëmijë te tjerë, publik më i gjerë etj.).
Aspektet specifike të planit të orës mësimore
Njësia mësimore: Hapësira
Fjalët kyçe: Hapësira, mbivendosja, perspektiva kurrizi i peshkut, paraqitja e hapësirës si "sytë e zogut", perspektiva lineare, paraqitje e perspektivës me shumë pika shikimi, projeksioni metrik.
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore **Nxënësi/ja:** - **vëzhgon** me vetëdije paraqitjen e hapësirës në vepra të ndryshme të artit nga vende dhe periudha të ndryshme të historisë së artit; - **reflekton** mbi mënyrat e ndryshme të paraqitjes së hapësirës në vepra të ndryshme të artit dhe në arkitekturë; - **zbulon** mënyrat e ndryshme të paraqitjes së hapësirës nga artistët gjatë zhvillimit të historisë së artit, në veprat e tyre; - **përdor** projeksionin metrik për të realizuar një krijim (natyrë të qetë me objekte).
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Arti figurativ kl. X, Ilustrime të veprave të artit që ilustrojnë paraqitjen e hapësirës; mjete pune si: letër, laps, lapsa me ngjyra, flamastera (tempera).
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Fusha: Shoqëria dhe mjedisi, Shkencat e natyrës, Gjuha dhe komunikimi, Jeta dhe puna
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: kujtesa pamore, bashkëbisedim
Nxënësit/et vëzhgojnë veprën "Ura" të artistit Gustav Kailebot dhe identifikojnë mënyrën e paraqitjes së hapësirës. Ata/ato diskutojnë për mënyrat e ndryshme të paraqitjes së hapësirës në veprat dydimensionale duke u mbështetur në njohuritë e tyre të mëparshme.
Ndërtimi i njohurive të reja: Kujtesa pamore, bisedë, punë individuale
Mësuesi/ja shpjegon se artistët kanë kërkuar zgjidhje dhe metoda të ndryshme për të paraqitur hapësirën dhe thellësinë mbi një sipërfaqe të sheshtë dhe për t'i dhënë shikuesit të njëjtën përshtypje që do të merrte po të shihte skenën reale. Shembujt e veprave të artit tregojnë këto përpjekje që në periudhat antike të historisë së artit. Në periudhën e Rilindjes u ideuan një bashkësi rregullash, të cilat mundësojnë paraqitjen e realitetit ashtu si ne e shohim.
Nëpërmjet rubrikës vëzhgojmë trajtohen këto çështje:

- Çështja e parë trajton paraqitjen e hapësirës në pikturat e shpellave në prehistori, ku nxënësit identifikojnë përdorimin e mbivendosjes.
- Në çështjen e dytë trajtohet pesha e shpërndarë. Të dy shembujt e marrë nga periudha të ndryshme të historisë së artit e arrijnë ekuilibrin nëpërmjet shpërndarjes së njëtrajtshme të figuracionit.
- Në dy çështjen e tretë trajtohen karakteristikat e paraqitjes së hapësirës në pikturën egjiptiane. Çështje të tjera janë paraqitja e hapësirës në pikturën romake dhe atë bizantine.
- Në çështjen e katërt trajtohet perspektiva lineare dhe ajrore dy paraqitje të hapësirës të përdorura në periudhën e Rilindjes.
- Në çështjen e pestë trajtohet këndvështrimi i kubizmit mbi paraqitjen e hapësirës dhe më pas mënyra iluzionare e paraqitjes së hapësirës në teatër.

Veprimtari
Mësuesi/ja shpjegon karakteristikat, rregullat dhe përdorimin e projeksionit metrik.
Duke u mbështetur në shembuj të ndryshëm të përdorimit të projeksionit metrik, nxënësit nxiten të krijojnë një kompozim ose një natyrë të qetë me objekte ku të përdorin rregullat e paraqitjes së projeksionit metrik.
Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: diskutimi
Në fund të orës së mësimit nxënësit diskutojnë për krijimin e tyre dhe mënyrën e paraqitjes së projeksionit metrik. Ata rendisin mënyrat e ndryshme të paraqitjes së hapësirës në veprat e artit të periudhave të ndryshme duke bërë dhe krahasimin mes tyre.

Vlerësimi i nxënësve

Vlerësimi i nxënësit do të fokusohet:

- në diskutimet që ata/ato bëjnë, duke lidhur njohuritë e tyre me njësinë e re;
- në identifikimin e paraqitjes së hapësirës në vepra të ndryshme arti;
- në mënyrën e realizimit të detyrës;
- në analizën vlerësuese që nxënësit/et i bëjnë punës së tyre dhe të shokëve/shoqeve.

Detyrat dhe puna e pavarur

Punë individuale (detyrë shtëpie)
Realizon një objekt ose kompozim me objekte duke përdorur perspektivën lineare dhe e krahason me punimin që ka realizuar me projeksionin metrik.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 9

<table>
<tr><th colspan="4">Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore</th></tr>
<tr><td>Fusha kurrikulare: Arte</td><td>Lënda: Arti figurativ</td><td>Shkalla e kurrikulës: V</td><td>Klasa: X</td></tr>
<tr><td colspan="2">Gjuha dhe komunikimi artistik
Tema: Parimet e artit</td><td colspan="2">Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor):
Përshkruan dhe identifikon harmoninë te vepra të ndryshme artistike.
Analizon ritmin në punime të ndryshme artistike të artistëve të njohur dhe në punimet e tyre apo të shokëve.
Shpjegon dhe përshkruan rolin dhe rëndësinë e proporcioneve për realizimin e saktë të raportit në mes të formave të ndryshme.
Identifikojnë rëndësinë dhe karakteristikat e kontrastit për të bërë dallimin midis elementeve të ndryshme figurative në një vepër arti.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):
I.1. Shpreh mendimin e vet me gojë ose me shkrim, apo në ndonjë formë tjetër të të shprehurit (simbole, kode, shenja dhe shprehje të tjera artistike), për një temë të caktuar që reflekton aspekte të përgatitjes akademike në arsimin e mesëm të lartë.
II.1. Prezanton mënyrën e grumbullimit, të zgjedhjes dhe të klasifikimit të informatave për fusha të ndryshme mësimore apo për një temë të caktuar, ofron argumente për zhvillimet aktuale lidhur me temën përkatëse (p.sh., temë nga shkenca, kultura, arti, sporti, shëndetësia, shoqëria, mjedisi etj.).
II.8. Krijon një vepër artistike me pamje dy dhe tredimensionale me mesazhe nga një fushë mësimore dhe shpjegon para moshatarëve hapat e ndjekur për krijimin e veprës.
III.3. Parashtron pyetje dhe shfaq mendime të strukturuara për zgjidhjen e një problemi apo detyre të një teme të caktuar, bën përmbledhjen e së paku dy veprimeve të përdorura të cilat përcaktojnë drejtimin e mëtejmë të të nxënit të vet për temën apo problemin e caktuar.
IV.3. Hulumton dhe shfrytëzon mundësitë relevante në dispozicion për zgjedhje të suksesshme të shkollimit të mëtejshëm apo për përgatitje profesionale dhe për këshillim në karrierë, duke përdorur me sukses njohuritë dhe shkathtësitë që i zotëron.
V.4. Ilustron me shembuj para të tjerëve modelet/praktikat e sjelljeve që reflektojnë mënyrat e mbrojtjes dhe të kultivimit të kulturës së vet, vlerave, besimeve dhe kulturave të të tjerëve në mjedisin ku jeton dhe më gjerë.
VI.7. Diskuton me të tjerët apo në një formë tjetër të të shprehurit paraqet interesin personal për çështje publike, shoqërore, historike, natyrore etj., dhe jep propozime për zgjidhjen e ndonjë problemi në komunitet e më gjerë në një fushë të caktuar.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):
2.1 Përdor elementet e gjuhës së artit për të komunikuar idetë e veta përmes veprave artistike në nivel më të avancuar
2.2 Eksperimenton dhe përzgjedh mundësitë shprehëse të teknikave të ndryshme artistike, në realizimin e punimeve artistike të nivelit më të avancuar.
2.3 Komunikon me mjetet shprehëse artistike përkatëse (muzikë, dramë, vallëzim dhe arte vizuale) në mënyrë të përshtatshme për audienca të ndryshme (kolegë, prindër, fëmijë te tjerë, publik më i gjerë etj.).</td></tr>
<tr><th colspan="4">Aspektet specifike të planit të orës mësimore</th></tr>
<tr><td colspan="4">Njësia mësimore: Parimet e artit: Harmonia dhe ritmi, theksi dhe kontrasti, lëvizja, proporcionet.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Fjalët kyçe: Parimet e artit, harmonia, ritmi, theksi, kontrasti, lëvizja, proporcionet.</td></tr>
</table>

Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore
Nxënësi/ja:
- **vëzhgon** me vetëdije organizimin e elementeve të gjuhës pamore në vepra të ndryshme të artit nga vende dhe periudha të ndryshme të historisë së artit;
- **reflekton** mbi mënyrat e ndryshme të organizimit të elementeve të gjuhës pamore në vepra të ndryshme të artit dhe në arkitekturë;
- **zbulon** mënyrat e larmishme të organizimit të elementeve të përdorur nga artistët gjatë zhvillimit të historisë së artit, në veprat e tyre;
- **organizon** elemente të artit në një kompozim nga jeta e përditshme duke respektuar parimet e artit.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Arti figurativ kl. X, Ilustrime të veprave të artit që ilustrojnë organizimin e parimeve të artit; mjete pune si: letër vizatimi, imazhe nga revistat dhe fotografitë, gërshërë dhe ngjitës.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:
Fusha: Shoqëria dhe mjedisi, Shkencat e natyrës, Gjuha dhe komunikimi, Jeta dhe puna

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: kujtesa pamore, bashkëbisedim
Mësuesi/ja orienton vëzhgimin e nxënësve në veprën "Ritmi i një kërkimi rus" të artistit Teo Van Desburg dhe fton nxënësit të përshkruajnë se çfarë shohin në të. Mësuesi/ja i orienton të shohin:
përhapjen e figuracionit (shiritat me ngjyra) në pikturë dhe ritmin që krijohet aty; përhapjen e ngjyrave; lëvizjen që bën syri për të përshkuar të gjithë veprën; marrëdhënien që krijojnë përmasat e figuracionit.
Ndërtimi i njohurive të reja: Kujtesa pamore, bisedë, punë individuale
Mësuesi/ja shpjegon se: artistët i krijojnë veprat e tyre, duke organizuar elementet e artit në mënyra të ndryshme. Kur përpiqen t'i ndërthurin ato në një tërësi, ata përdorin parimet e artit ose ndryshe, rregullat e kompozimit. Për të kuptuar veprën e artit, duhet të njohim se si janë përdorur parimet e artit në të.
Nëpërmjet rubrikës "vëzhgojmë" mësuesi/ja i fton nxënësit të zbulojnë nëpërmjet ilustrimeve të veprave të artit mënyrën se si artistët krijojnë **harmoninë dhe ritmin** në veprat e tyre.
Në veprat e tjera, nxënësit kuptojnë që **theksi** krijohet nëpërmjet **kontrastit** të ngjyrave dhe formave.
Parimi **i lëvizjes** është një parim i rëndësishëm për të krijuar ndjenjën dhe aksionit dhe për të udhëhequr vështrimin e shikuesit. Nxënësit nëpërmjet veprave të artit zbulojnë edhe mënyrën e përdorimit të **proporcioneve** për qëllime të ndryshme.
Veprimtari
Mësuesi/ja i fton nxënësit të krijojnë një kompozim nga jeta e përditshme duke pasur parasysh parimet e artit.
Mësuesi/ja i udhëzon të përdorin figuracione të ndryshme nga revistat, gazetat etj. dhe t'i organizojnë nëpërmjet teknikës së kolazhit.
Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: diskutimi
Në fund të orës së mësimit nxënësit diskutojnë për krijimin e tyre dhe mënyrën e organizimit të elementeve të artit dhe cilës prej tyre i dhanë më shumë rëndësi. Ata shpjegojnë edhe temën që zgjodhën dhe mënyrën e realizimit.

Vlerësimi i nxënësve

Vlerësimi i nxënësit do të fokusohet:
- në diskutimet që ata/ato bëjnë, duke lidhur njohuritë e tyre me njësinë e re;
- në identifikimin e parimeve në vepra të ndryshme arti;
- në mënyrën e realizimit të detyrës;
- në analizën vlerësuese që nxënësit i bëjnë punës së tyre dhe të shokëve/shoqeve.

Detyrat dhe puna e pavarur

Punë individuale (detyrë shtëpie)
Realizon një kompozim duke aplikuar parimet e artit **në** varësi **të** temës **së** zgjedhur.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 10

<table>
<tr><th colspan="4">Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore</th></tr>
<tr><td>Fusha kurrikulare: Arte</td><td>Lënda: Arti figurativ</td><td>Shkalla e kurrikulës: V</td><td>Klasa: X</td></tr>
<tr><td colspan="2">Gjuha dhe komunikimi artistik
Tema: Parimet e artit</td><td colspan="2">Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor):
Dallon rregullat e kompozimit dhe i përdor ato për të kompozuar vepra artistike.
Identifikon dhe aplikon llojet e ndryshme të kompozicionit në punimet e tyre artistike.
Identifikon llojet e ndryshme të baraspeshave dhe rëndësinë e tyre në vepra artistike.
Realizon një punim duke përdorur parimin e baraspeshës.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):
I.1. Shpreh mendimin e vet me gojë ose me shkrim, apo në ndonjë formë tjetër të të shprehurit (simbole, kode, shenja dhe shprehje të tjera artistike), për një temë të caktuar që reflekton aspekte të përgatitjes akademike në arsimin e mesëm të lartë.
II.8. Krijon një vepër artistike me pamje dy dhe tredimensionale me mesazhe nga një fushë mësimore dhe shpjegon para moshatarëve hapat e ndjekur për krijimin e veprës.
III.3. Parashtron pyetje dhe shfaq mendime të strukturuara për zgjidhjen e një problemi apo detyre të një teme të caktuar, bën përmbledhjen e së paku dy veprimeve të përdorura të cilat përcaktojnë drejtimin e mëtejmë të të nxënit të vet për temën apo problemin e caktuar.
III.8. Paraqet idetë personale para të tjerëve për mënyrën e zhvillimit të një aktiviteti të caktuar duke dhënë mendime të argumentuara për rezultatet e pritura (në formë skice, grafiku, vizatimi, shkrimi, vepre artistike etj.).
IV.3. Hulumton dhe shfrytëzon mundësitë relevante në dispozicion për zgjedhje të suksesshme të shkollimit të mëtejshëm apo për përgatitje profesionale dhe për këshillim në karrierë, duke përdorur me sukses njohuritë dhe shkathtësitë që i zotëron.
V.4. Ilustron me shembuj para të tjerëve modelet/praktikat e sjelljeve që reflektojnë mënyrat e mbrojtjes dhe të kultivimit të kulturës së vet, vlerave, besimeve dhe kulturave të të tjerëve në mjedisin ku jeton dhe më gjerë.
VI.7. Diskuton me të tjerët apo në një formë tjetër të të shprehurit paraqet interesin personal për çështje publike, shoqërore, historike, natyrore etj., dhe jep propozime për zgjidhjen e ndonjë problemi në komunitet e më gjerë në një fushë të caktuar.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):
2.1 Përdor elementet e gjuhës së artit për të komunikuar idetë e veta përmes veprave artistike në nivel më të avancuar.
2.2 Eksperimenton dhe përzgjedh mundësitë shprehëse të teknikave të ndryshme artistike, në realizimin e punimeve artistike të nivelit më të avancuar.
2.3 Komunikon me mjetet shprehëse artistike përkatëse (muzikë, dramë, vallëzim dhe arte vizuale), në mënyrë të përshtatshme për audienca të ndryshme (kolegë, prindër, fëmijë te tjerë, publik më i gjerë etj.).</td></tr>
<tr><th colspan="4">Aspektet specifike të planit të orës mësimore</th></tr>
<tr><td colspan="4">Njësia mësimore: Kompozimi</td></tr>
<tr><td colspan="4">Fjalët kyçe: Kompozimi, pesha dhe ekuilibri, baraspesha, pesha e shpërndarë, simetria dhe asimetria</td></tr>
</table>

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore
Nxënësi/ja:
- **vëzhgon** me vetëdije organizimin e elementeve të gjuhës pamore në vepra të ndryshme të artit nga vende dhe periudha të ndryshme të historisë së artit;
- **reflekton** mbi mënyrat e ndryshme të organizimit të elementeve të gjuhës pamore në vepra të ndryshme të artit dhe në arkitekturë;
- **zbulon** mënyrat e larmishme të organizimit të elementeve të përdorur nga artistët gjatë zhvillimit të historisë së artit, në veprat e tyre;
- **organizon** elemente të artit në një kompozim abstrakt duke arritur ekuilibrin.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Arti figurativ kl. X, Ilustrime të veprave të artit që ilustrojnë organizimin e parimeve të artit; mjete pune si: letër vizatimi, imazhe nga revistat dhe fotografitë, gërshërë dhe ngjitës.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:
Fusha: Shoqëria dhe mjedisi, Shkencat e natyrës, Gjuha dhe komunikimi

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: kujtesa pamore, bashkëbisedim
Nxënësit përqendrohen te piktura e Shardin "Gota e ujit dhe ena e kafesë" dhe përpiqen të zbërthejnë elementet e ekuilibrit në këtë natyrë të qetë. Ata diskutojnë për baraspeshën, llojet e saj duke u mbështetur te njohuritë e tyre të mëparshme dhe mënyrën sesi shfaqet në vepra të ndryshme të artit.

Ndërtimi i njohurive të reja: Kujtesa pamore, bisedë, punë individuale
Mësuesi/ja shpjegon se artistët gjatë procesit krijues, organizojnë strukturën kompozicionale të veprës së artit, duke studiuar shpërndarjen e shenjave, figurave, formave dhe ngjyrave për të krijuar imazhe që karakterizohen nga baraspesha ose ekuilibri.
Nëpërmjet rubrikës vëzhgojmë trajtohen këto çështje:
- Çështja e parë trajton peshën dhe ekuilibrin në pikturë. Shembujt janë dy vepra arti të marra në periudha të ndryshme të historisë së artit, ku subjekti është i vendosur në qendër të kompozimit.
- Në çështjen e dytë trajtohet pesha e shpërndarë. Të dy shembujt e marrë nga periudha të ndryshme të historisë së artit e arrijnë ekuilibrin nëpërmjet shpërndarjes së njëtrajtshme të figuracionit.
- Në çështjen e tretë trajtohet simetria dhe asimetria. Nxënësit zbulojnë se si arrihet ekuilibri në pikturë si nëpërmjet përdorimit të simetrisë ashtu edhe nëpërmjet përdorimit të asimetrisë.
- Simetria dhe asimetria në arkitekturë dhe skulpturë trajtohet në çështjen e katërt dhe të pestë. Nëpërmjet shembujve nga periudha të ndryshme historike, nxënësit identifikojnë ekuilibrin dhe mënyrën e arritjes së saj në këto vepra.

Veprimtari
Duke u mbështetur në një seri kompozimesh gjeometrike të Pit mondrian, i cili e krijon ekuilibrin nëpërmjet shpërndarjes së ngjyrave në mënyrë të njëtrajtshme, të karakterizuara nga format gjeometrike, nxënësit nxiten të krijojnë një kompozim duke iu referuar njërit prej shembujve kompozicionalë që ka përdorur artisti.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: diskutimi
Në fund të orës së mësimit, nxënësit diskutojnë për krijimin e tyre dhe mënyrën e shpërndarjes së elementeve në krijim për të krijuar ekuilibrin. Ata shpjegojnë edhe llojin e baraspeshës që zgjodhën për krijimin e tyre.

Vlerësimi i nxënësve

Vlerësimi i nxënësit do të fokusohet:
- në diskutimet që ata/ato bëjnë, duke lidhur njohuritë e tyre me njësinë e re;
- në identifikimin e realizimit të ekuilibrit në vepra të ndryshme arti;
- në mënyrën e realizimit të detyrës;
- në analizën vlerësuese që nxënësit i bëjnë punës së tyre dhe të shokëve/shoqeve.

Detyrat dhe puna e pavarur
Punë individuale (detyrë shtëpie) Eksperimenton me forma të ndryshme të kombinimit të elementeve për të krijuar një kompozim origjinal (ose përfundon atë që ka nisur në klasë).
Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 11

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Arte	**Lënda:** Arti figurativ	**Shkalla e kurrikulës:** V	**Klasa:** X
Gjuha dhe komunikimi artistik **Tema**: Parimet e artit		**Rezultati i të nxënit të temës** (nga plani dymujor): Përdor me efektivitet masën si matës të saktë në proporcionet e trupit të njeriut dhe portretit.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.1. Shpreh mendimin e vet me gojë ose me shkrim, apo në ndonjë formë tjetër të të shprehurit (simbole, kode, shenja dhe shprehje të tjera artistike), për një temë të caktuar që reflekton aspekte të përgatitjes akademike në arsimin e mesëm të lartë II.1. Prezanton mënyrën e grumbullimit, të zgjedhjes dhe të klasifikimit të informatave për fusha të ndryshme mësimore apo për një temë të caktuar, ofron argumente për zhvillimet aktuale lidhur me temën përkatëse (p.sh., temë nga shkenca, kultura, arti, sporti, shëndetësia, shoqëria, mjedisi etj.). II.8. Krijon një vepër artistike me pamje dy dhe tredimensionale me mesazhe nga një fushë mësimore dhe shpjegon para moshatarëve hapat e ndjekur për krijimin e veprës. III.3. Parashtron pyetje dhe shfaq mendime të strukturuara për zgjidhjen e një problemi apo detyre të një teme të caktuar, bën përmbledhjen e së paku dy veprimeve të përdorura të cilat përcaktojnë drejtimin e mëtejmë të të nxënit të vet për temën apo problemin e caktuar. III.8. Paraqet idetë personale para të tjerëve për mënyrën e zhvillimit të një aktiviteti të caktuar duke dhënë mendime të argumentuara për rezultatet e pritura (në formë skice, grafiku, vizatimi, shkrimi, vepre artistike etj.). V.4. Ilustron me shembuj para të tjerëve modelet/praktikat e sjelljeve që reflektojnë mënyrat e mbrojtjes dhe të kultivimit të kulturës së vet, vlerave, besimeve dhe kulturave të të tjerëve në mjedisin ku jeton dhe me gjerë.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 2.1 Përdor elementet e gjuhës së artit për të komunikuar idetë e veta përmes veprave artistike në nivel më të avancuar. 2.2 Eksperimenton dhe përzgjedh mundësitë shprehëse të teknikave të ndryshme artistike, në realizimin e punimeve artistike të nivelit më të avancuar; 2.3 Komunikon me mjetet shprehëse artistike përkatëse (muzikë, dramë, vallëzim dhe arte vizuale) në mënyrë të përshtatshme për audienca të ndryshme (kolegë, prindër, fëmijë të tjerë, publik më i gjerë etj.).			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore: Trupi i njeriut dhe proporcionet			
Fjalët kyçe: Proporcionet, kanuni egjiptian, kanuni grek, proporcionet e trupit të njeriut në rilindje			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore **Nxënësi/ja:** - **vëzhgon** me vetëdije paraqitjen e trupit të njeriut në vepra të ndryshme të artit nga vende dhe periudha të ndryshme të historisë së artit; - **reflekton** mbi proporcionet e trupit të njeriut të përdorura në përudha **të ndryshme të historisë së artit;** - **paraqet** trupin e njeriut në lëvizje duke përdorur si referencë veprën e Marsel Dushamp.			

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Arti figurativ kl. X, Ilustrime të veprave të artit që tregojnë paraqitjen e trupit të njeriut në vepra arti të periudhave të ndryshme historike; mjete pune si: letër, laps, akuarele.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:
Fusha: Shoqëria dhe mjedisi, Shkencat e natyrës, Gjuha dhe komunikimi

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: kujtesa pamore, bashkëbisedim
Nxënësit/et vëzhgojnë veprën e Dyrerit "Adami dhe Eva" dhe diskutojnë mbi vendin që zë trupi i njeriut në veprat e artit pamor. Ata/ato diskutojnë mbi proporcionet e trupit të njeriut në periudha të ndryshme të historisë së artit duke u mbështetur në njohuritë e tyre të mëparshme dhe në imazhe të ndryshme.

Ndërtimi i njohurive të reja: Kujtesa pamore, bisedë, punë individuale
Mësuesi/ja shpjegon se në punën e tij, Dyreri tërhiqet gjithnjë e më shumë nga ideja se forma e përsosur njerëzore përkon me një sistem matjesh proporcionale. Nga fundi i jetës ai shkroi disa libra në lidhje me kërkimet e tij mbi proporcionet e njeriut.
Nëpërmjet çështjes proporcionet nxënësit njihen me ndërtimin anatomik të trupit të njeriut. Ata/ato vëzhgojnë skemën proporcionale të paraqitjes së trupit të njeriut ku zbulojnë se çdo ndarje i përgjigjet pikave kryesore të kyçeve si: qafa, sqetullat, beli, vithet, gjunjët. Koka zë një kuadrat, busti dhe krahët gati 3 kuadrate dhe këmbët 4 kuadrate.
Më pas, ata diskutojnë mbi kanunin egjiptian dhe karakteristikat e tij të paraqitjes së trupit të njeriut. Çështje tjetër është kanuni grek dhe mënyra e paraqitjes së trupit të njeriut në Rilindje.
Në çështjen e fundit trajtohet paraqitja e trupit të njeriut në lëvizje. Fotografia ishte një mjet i rëndësishëm i cili fiksonte momente që i rrëshqasin syrit të njeriut. Shembujt e veprave të artit e ilustrojnë këtë çështje.

Veprimtari
Duke u mbështetur në veprën e artistit Marsel Dushamp dhe mënyrën sesi ai e krijon lëvizjen nëpërmjet mbivendosjes, nxënësit nxiten të realizojnë figurën e një sportisti në lëvizje duke ndjekur disa hapa të nevojshme.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: diskutimi
Në fund të orës së mësimit, nxënësit diskutojnë për krijimin e tyre me trupin e njeriut në lëvizje dhe diskutojnë mbi rëndësinë e figurës njerëzore në veprat e artit. Ata shpjegojnë edhe mënyrën e realizimit të punimit.

Vlerësimi i nxënësve

Vlerësimi i nxënësit do të fokusohet:
- në diskutimet që ata/ato bëjnë, duke lidhur njohuritë e tyre me njësinë e re;
- në identifikimin e proporcioneve të trupit të njeriut në vepra të ndryshme arti;
- në mënyrën e realizimit të detyrës;
- në analizën vlerësuese që nxënësit i bëjnë punës së tyre dhe të shokëve/shoqeve.

Detyrat dhe puna e pavarur

Punë individuale (detyrë shtëpie)
Realizon një figurë në lëvizje ose përfundon detyrën e nisur në klasë.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 1

<table>
<tr><th colspan="4">Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore</th></tr>
<tr><td>Fusha kurrikulare: Arte</td><td>Lënda: Arti figurativ</td><td>Shkalla e kurrikulës: V</td><td>Klasa: X</td></tr>
<tr><td colspan="2">Krijimtaria dhe performanca artistike
Tema: Krijimi i punimeve artistike në teknika dhe mediume të ndryshme artistike</td><td colspan="2">Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor):
Dallon llojet e vizatimit, të cilat i praktikon në realizimin e veprave artistike vizatimore.
Përzgjedh dhe përdor teknika të ndryshme të vizatimit.
Analizon dhe vlerëson krijimet artistike vetjake dhe të tjerëve, duke analizuar, elementet, parimet dhe teknikat e gjuhës artistike.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):
I.5. Jep dhe merr informacione në mënyrë konstruktive dhe krijuese për të dhënat e mbledhura për një temë të caktuar në formë tekstuale, numerike, verbale, elektronike apo në ndonjë formë tjetër të të shprehurit.
II.4. Modelon zgjidhjen e një problemi të dhënë (në klasë, apo jashtë saj) për një temë të caktuar nga një fushë mësimore, duke e zbërthyer në hapa të vegjël dhe jep sqarime të nevojshme për hapat e ndjekur në zgjidhjen e problemit, duke përdorur forma të ndryshme të të shprehurit.
II.8. Krijon një vepër artistike me pamje dy dhe tredimensionale me mesazhe nga një fushë mësimore dhe shpjegon para moshatarëve hapat e ndjekur për krijimin e veprës.
III.3. Parashtron pyetje dhe shfaq mendime të strukturuara për zgjidhjen e një problemi apo detyre të një teme të caktuar, bën përmbledhjen e së paku dy veprimeve të përdorura të cilat përcaktojnë drejtimin e mëtejmë të të nxënit të vet për temën apo problemin e caktuar.
IV.3. Hulumton dhe shfrytëzon mundësitë relevante në dispozicion për zgjedhje të suksesshme të shkollimit të mëtejshëm apo për përgatitje profesionale dhe për këshillim në karrierë, duke përdorur me sukses njohuritë dhe shkathtësitë që i zotëron.
V.4. Ilustron me shembuj para të tjerëve modelet/praktikat e sjelljeve që reflektojnë mënyrat e mbrojtjes dhe të kultivimit të kulturës së vet, vlerave, besimeve dhe kulturave të të tjerëve në mjedisin ku jeton dhe më gjerë.
VI.6. Demonstron veprime të ndryshme që shprehin tolerancë, respekt dhe qëndrim të hapur ndaj dallimeve në komunitetin ku jeton (në klasë, në shkollë, në lagje dhe me gjerë) dhe i shpjegon ato në një debat më të tjerët.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):
1.1. Krijon vepra artistike duke përdorur mjete të ndryshme shprehëse për të komunikuar dhe shprehur përjetimet, ndjenjat dhe idetë personale.
1.2. Prezanton aftësitë e tij/saj krijuese dhe interpretuese në klasë dhe para një audience të caktuar me vetëbesim dhe siguri.</td></tr>
<tr><th colspan="4">Aspektet specifike të planit të orës mësimore</th></tr>
<tr><td colspan="4">Njësia mësimore: Teknika e vizatimit në ilustrimet komike</td></tr>
<tr><td colspan="4">Fjalët kyçe: Ilustrimet komike, laps, rapidograf, lapsa me ngjyra, flamastera, bojëra uji.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore
Nxënësi/ja:
- zbulon teknikën e vizatimit në ilustrimet komike me qëllim përdorimin në mënyrë krijuese;
- përdor mjetet dhe materialet e duhura në realizimin e ilustrimit komik;
- organizon informacionin, përcakton fazat dhe kohën që i duhet për të realizuar një ilustrim komik;
- shpreh idetë në mënyrë origjinale nëpërmjet përdorimit me kompetencë të teknikës së vizatimit.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Arti figurativ kl. X, Imazhe të ilustrimeve komike; imazhe me vepra nga historia e artit që zhvillohen në formën e një historie me figura; Mjete të tilla si: laps, letër, gomë, lapsa me ngjyra.</td></tr>
</table>

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Fusha: Shoqëria dhe mjedisi, Shkencat e natyrës, Gjuha dhe komunikimi, Jeta dhe puna
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: kujtesa pamore, bashkëbisedim Nëpërmjet imazheve të ndryshme të ilustrimeve komike, nxënësit/et diskutojnë mbi gjuhën specifike të ndërtimit të tyre. Ata/ato diskutojnë mbi teknikat e vizatimit që mund të përdoren për realizimin e tyre (vizatimin me laps, me lapsa me ngjyra, me lapustila dhe me rapidograf). Ata përmendin ilustrime komike të njohura për ta. **Ndërtimi i njohurive të reja: Kujtesa pamore, bisedë, hulumtim i lirë** Mësuesi/ja shpjegon se Ilustrimet komike janë histori të ndërtuara në një seri vizatimesh që propozojnë një seri skenash që përqendrohen në bëmat e një ose më shumë personazheve. Për ilustrimet komike përdoret një gjuhë specifike ku thelbësore janë: lëvizja që karakterizon figurat; ekzagjerimi i disa gjesteve dhe sjelljeve të personazheve. Ilustrimet komike mund të realizohen në fillim nëpërmjet skicave me laps, më pas përdoret rapidografi dhe materialet e tjera sipas dëshirës ose konceptit të artistit. Mësuesi/ja thekson që realizimi i personazhit me karakteristikat e tij të veçanta fizike është shumë i rëndësishëm dhe duhet ruajtur i njëjtë gjatë zhvillimit të historisë. Gjithashtu, problemet teknike shpjegohen nga mësuesi/ja. Për t'i nxitur, nxënësit drejt krijimit të një historie komike mësuesi/ja nëpërmjet shembujve (nga vepra të historisë së artit) tregon një lloj historiku të zhvillimit të imazhit si një ngjarje. Tregimi i historisë nëpërmjet imazhit ka ardhur deri në ditët e sotme në formën që e njohim sot. Duke ndjekur hapat e veprimtarisë, nxënësit realizojnë historinë e tyre komike. **Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: diskutimi** Në fund të orës së mësimit, nxënësit diskutojnë për krijimin e tyre, për personazhin që zgjodhën dhe për historinë që ndërtuan. Njohuritë në këtë teknikë ata i shohin si një mundësi karriere në dizajn.
Vlerësimi i nxënësve
Vlerësimi i nxënësit do të fokusohet: • në diskutimet që ata/ato bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me njësinë e re; • në vlerësimin e punës; • në mënyrën e realizimit të detyrës; • në analizën vlerësuese që nxënësit i bëjnë punës së tyre dhe të shokëve/shoqeve.
Detyrat dhe puna e pavarur
Punë individuale (detyrë shtëpie) Nxënësit përfundojnë detyrën e filluar në klasë për të plotësuar historinë e tyre komike.
Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 2

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Arte	**Lënda:** Arti figurativ	**Shkalla e kurrikulës:** V	**Klasa:** X
Krijimtaria dhe performanca artistike **Tema:** Krijimi i punimeve artistike në teknika dhe mediume të ndryshme artistike		**Rezultati i të nxënit të temës** (nga plani dymujor): Dallon dhe përdor teknika të ndryshme të pikturës për të realizuar punime artistike. Krijon duke përdorur njohuritë e teorisë së ngjyrave (ngjyrën, vlerën, intensitetin etj.); Analizon dhe vlerëson krijimet artistike vetjake dhe të tjerëve, duke analizuar, elementet, parimet dhe teknikat e gjuhës artistike.	

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.5. Jep dhe merr informacione në mënyrë konstruktive dhe krijuese për të dhënat e mbledhura për një temë të caktuar në formë tekstuale, numerike, verbale, elektronike apo në ndonjë formë tjetër të të shprehurit. II.4. Modelon zgjidhjen e një problemi të dhënë (në klasë, apo jashtë saj) për një temë të caktuar nga një fushë mësimore, duke e zbërthyer në hapa të vegjël dhe jep sqarime të nevojshme për hapat e ndjekur në zgjidhjen e problemit, duke përdorur forma të ndryshme të të shprehurit. II.8. Krijon një vepër artistike me pamje dy dhe tredimensionale me mesazhe nga një fushë mësimore dhe shpjegon para moshatarëve hapat e ndjekur për krijimin e veprës. III.3. Parashtron pyetje dhe shfaq mendime të strukturuara për zgjidhjen e një problemi apo detyre të një teme të caktuar, bën përmbledhjen e së paku dy veprimeve të përdorura të cilat përcaktojnë drejtimin e mëtejmë të të nxënit të vet për temën apo problemin e caktuar. IV.3. Hulumton dhe shfrytëzon mundësitë relevante në dispozicion për zgjedhje të suksesshme të shkollimit të mëtejshëm apo për përgatitje profesionale dhe për këshillim në karrierë, duke përdorur me sukses njohuritë dhe shkathtësitë që i zotëron. V.4. Ilustron me shembuj para të tjerëve modelet/praktikat e sjelljeve që reflektojnë mënyrat e mbrojtjes dhe të kultivimit të kulturës së vet, vlerave, besimeve dhe kulturave të të tjerëve në mjedisin ku jeton dhe me gjerë. VI.6. Demonstron veprime të ndryshme që shprehin tolerancë, respekt dhe qëndrim të hapur ndaj dallimeve në komunitetin ku jeton (në klasë, në shkollë, në lagje dhe me gjerë) dhe i shpjegon ato në një debat me të tjerët.
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.1. Krijon vepra artistike duke përdorur mjete të ndryshme shprehëse për të komunikuar dhe shprehur përjetimet, ndjenjat dhe idetë personale. 1.2. Prezanton aftësitë e tij/saj krijuese dhe interpretuese në klasë dhe para një audience të caktuar me vetëbesim dhe siguri.
Aspektet specifike të planit të orës mësimore
Njësia mësimore: Piktura mbi pëlhurë
Fjalët kyçe: Piktura mbi pëlhurë, ngjyrat e pëlhurës, fenikasit dhe ngjyra e purpurt, pëlhurat arabe, laps, bojëra për pëlhurë ose akriliku.
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore **Nxënësit:** - **zbulon** teknikën e pikturës mbi pëlhurë me qëllim përdorimin në mënyrë krijuese; - **përdor** mjetet dhe materialet e duhura në realizimin e pikturës mbi pëlhurë; - **organizon** informacionin, përcakton fazat dhe kohën që i duhet për të realizuar një pëlhurë të pikturuar; - **shpreh** idetë në mënyrë origjinale nëpërmjet përdorimit me kompetencë të teknikës së pikturës mbi pëlhurë.
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Arti figurativ kl. X, Imazhe të vizatimeve pikturës në pëlhurë ose stampime mbi pëlhurë; Mjete të tilla si: laps, bojëra për pëlhurë (në pamundësi të bojërave për pëlhurë mund të përdoren bojëra uji si tempera apo akrilik. Bojërat e akrilikut ndryshe nga tempera janë rezistente nga uji).
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Fusha: Shoqëria dhe mjedisi, Shkencat e natyrës, Gjuha dhe komunikimi, Jeta dhe puna
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: kujtesa pamore, bashkëbisedim
Nëpërmjet imazheve të ndryshme, nxënësit diskutojnë mbi gjuhën specifike të realizimit të pëlhurave të pikturuara dhe përdorimet e tyre të shumta. Ata/ato diskutojnë mbi bojën specifike që përdoret në zbukurimin e pëlhurave dhe ngjashmërinë apo specifikat që kjo teknikë ka në krahasim me pikturën mbi letër apo mbi telajo. **Ndërtimi i njohurive të reja: Kujtesa pamore, bisedë, hulumtim i lirë**
Mësuesi/ja shpjegon se materialet më të mira për të realizuar këtë teknikë janë pëlhurat prej liri, prej mëndafshi dhe pambuku. Nëpërmjet imazheve, nxënësit identifikojnë hapat që ndiqen në procesin e pikturimit të pëlhurës. Mësuesi/ja shpjegon që përveç përdorimit të penelave mund të përdoret edhe teknika e stampimit, si ai me letër ashtu edhe ai me reliev.
Teknikat e pikturimit të pëlhurës janë shumë të hershme ato vijnë që nga antikiteti dhe vazhdojnë të jenë të rëndësishme edhe sot në industrinë tekstile.
Duke u mbështetur në krijimet e artistit Uilliam Morris, mësuesi/ja i nxit nxënësit të realizojnë një pikturë mbi një bluzë apo një pëlhurë. Nxënësit përzgjedhin motivin e tyre dhe e realizojnë pikturën mbi pëlhurë duke përdorur penelin.
Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: diskutimi
Në fund të orës së mësimit diskutojnë për pikturën e tyre mbi pëlhurë dhe mënyrën e realizimit të saj. Ata shpjegojnë se si i përdorën edhe njohuritë mbi ngjyrën në krijimin e tyre. Njohuritë në këtë teknikë, ata i shohin edhe si një mundësi karriere në dizajn.

Vlerësimi i nxënësve

Vlerësimi i nxënësit do të fokusohet:
- në diskutimet që ata/ato bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me njësinë e re;
- në vlerësimin e punës;
- në mënyrën e realizimit të detyrës;
- në analizën vlerësuese që nxënësit i bëjnë punës së tyre dhe të shokëve/shoqeve.

Detyrat dhe puna e pavarur

Punë individuale (detyrë shtëpie)
Nxënësit realizojnë dekoracionin **e një bluze** ndërmjet teknikës së stampimit për të bërë edhe dallimin midis kësaj teknike dhe asaj të pikturimit me penel.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 3

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Arte	**Lënda:** Arti figurativ	**Shkalla e kurrikulës:** V	**Klasa:** X
Krijimtaria dhe performanca artistike **Tema:** Krijimi i punimeve artistike në teknika dhe mediume të ndryshme artistike		**Rezultati i të nxënit të temës** (nga plani dymujor): Dallon artin aplikativ nga arti figurativ. Dallon karakteristikat e veçanta të pikturës aplikative. Analizon dhe vlerëson krijimet artistike vetjake dhe të tjerëve, duke analizuar, elementet, parimet dhe teknikat e gjuhës artistike.	

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):
I.5. Jep dhe merr informacione në mënyrë konstruktive dhe krijuese për të dhënat e mbledhura për një temë të caktuar në formë tekstuale, numerike, verbale, elektronike apo në ndonjë formë tjetër të të shprehurit.
II.1. Prezanton mënyrën e grumbullimit, të zgjedhjes dhe të klasifikimit të informatave për fusha të ndryshme mësimore apo për një temë të caktuar, ofron argumente për zhvillimet aktuale lidhur me temën përkatëse (p.sh., temë nga shkenca, kultura, arti, sporti, shëndetësia, shoqëria, mjedisi etj.).
II.8. Krijon një vepër artistike me pamje dy dhe tredimensionale me mesazhe nga një fushë mësimore dhe shpjegon para moshatarëve hapat e ndjekur për krijimin e veprës.
III.3. Parashtron pyetje dhe shfaq mendime të strukturuara për zgjidhjen e një problemi apo detyre të një teme të caktuar, bën përmbledhjen e së paku dy veprimeve të përdorura të cilat përcaktojnë drejtimin e mëtejmë të të nxënit të vet për temën apo problemin e caktuar.
IV.3. Hulumton dhe shfrytëzon mundësitë relevante në dispozicion për zgjedhje të suksesshme të shkollimit të mëtejshëm apo për përgatitje profesionale dhe për këshillim në karrierë, duke përdorur me sukses njohuritë dhe shkathtësitë që i zotëron.
V.4. Ilustron me shembuj para të tjerëve modelet/praktikat e sjelljeve që reflektojnë mënyrat e mbrojtjes dhe të kultivimit të kulturës së vet, vlerave, besimeve dhe kulturave të të tjerëve në mjedisin ku jeton dhe me gjerë.
VI.7. Diskuton me të tjerët apo në një formë tjetër të të shprehurit paraqet interesin personal për çështje publike, shoqërore, historike, natyrore etj., dhe jep propozime për zgjidhjen e ndonjë problemi në komunitet e më gjerë në një fushë të caktuar.

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):
1.1. Krijon vepra artistike duke përdorur mjete të ndryshme shprehëse për të komunikuar dhe shprehur përjetimet, ndjenjat dhe idetë personale.
1.2. Prezanton aftësitë e tij/saj krijuese dhe interpretuese në klasë dhe para një audience të caktuar me vetëbesim dhe siguri.

Aspektet specifike të planit të orës mësimore

Njësia mësimore: Kolazhi

Fjalët kyçe: Kolazhi, kolazhi në veprat tredimensionale, materiale të ricikluesshme

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore
Nxënësi/ja:
- **zbulon** teknikën e kolazhi me qëllim përdorimin në mënyrë krijuese;
- **përdor** mjetet dhe materialet e duhura në realizimin e kolazhit;
- **organizon** informacionin, përcakton fazat dhe kohën që i duhet për të realizuar një kolazh;
- **shpreh** idetë në mënyrë origjinale nëpërmjet përdorimit me kompetencë të teknikës së kolazhit.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Arti figurativ kl. X, Imazhe të veprave të artistëve të ndryshëm të realizuara në teknikën e kolazhit; Mjete të tilla si: letra, kartonë, letra me ngjyra etj.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:
Fusha: Shoqëria dhe mjedisi, Gjuha dhe komunikimi, Jeta dhe puna

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: kujtesa pamore, bashkëbisedim
Nxënësit/et diskutojnë për kolazhin si një teknikë që mundëson përdorimin e materialeve të ndryshme dhe për rrjedhojë ofron mundësi shprehëse të shumta si në realizimin e veprave dy dhe tredimensionale. Ata/ato identifikojnë materialet e ndryshme të përdorura nga artistët në veprat e tyre të kolazhit.
Ndërtimi i njohurive të reja: Kujtesa pamore, bisedë, hulumtim i lirë
Mësuesi/ja shpjegon karakteristikat e procesit të realizimit të kolazhit dhe materialet e shumta që përdoren. Kjo është një teknik relativisht e re dhe i ka fillimet e veta në lëvizjet moderniste. Kolazhi shfaqet si mbi një sipërfaqe dydimensionale ashtu edhe në formën tredimensionale.

Materialet e ricikluesshme janë shumë të përdorshme në teknikën e kolazhit e cila vazhdon të jetë një teknikë mjaft e pëlqyer nga artistët edhe sot. Duke u mbështetur në imazhet që ilustrojnë procesin e punës që ndiqte Pikaso në realizimin e kolazheve të tij, nxënësit nxiten të krijojnë një kolazh duke përdorur letra të llojeve të ndryshme dhe kartonë. **Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: diskutimi** Në fund të orës së mësimit nxënësit diskutojnë për kolazhin e tyre dhe mënyrën e realizimit. Ata shpjegojnë për mundësitë e shumta shprehëse të teknikës së kolazhit.
Vlerësimi i nxënësve
Vlerësimi i nxënësit do të fokusohet: - në diskutimet që ata/ato bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me njësinë e re; - në vlerësimin e punës së secilit/ës nxënës/e; - në mënyrën e realizimit të detyrës; - në analizën vlerësuese që nxënësit/et i bëjnë punës së tyre dhe të shokëve/shoqeve.
Detyrat dhe puna e pavarur
Punë individuale (detyrë shtëpie) Nxënësit plotësojnë detyrën e kolazhit të filluar në klasë ose krijojnë një kolazh të ri duke përdorur materiale të ricikluesshme.
Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 4

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Arte	**Lënda:** Arti figurativ	**Shkalla e kurrikulës:** V	**Klasa:** X
Krijimtaria dhe performanca artistike **Tema:** Krijimi i punimeve artistike në teknika dhe mediume të ndryshme artistike		**Rezultati i të nxënit të temës** (nga plani dymujor): Dallon artin aplikativ nga arti figurativ. Realizon piktura aplikative në teknikën e mozaikut. Analizon dhe vlerëson krijimet artistike vetjake dhe të tjerëve, duke analizuar, elementet, parimet dhe teknikat e gjuhës artistike.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.5. Jep dhe merr informacione në mënyrë konstruktive dhe krijuese për të dhënat e mbledhura për një temë të caktuar në formë tekstuale, numerike, verbale, elektronike apo në ndonjë formë tjetër të të shprehurit. II.4. Modelon zgjidhjen e një problemi të dhënë (në klasë, apo jashtë saj) për një temë të caktuar nga një fushë mësimore, duke e zbërthyer në hapa të vegjël dhe jep sqarime të nevojshme për hapat e ndjekur në zgjidhjen e problemit, duke përdorur forma të ndryshme të të shprehurit. II.8. Krijon një vepër artistike me pamje dy dhe tredimensionale me mesazhe nga një fushë mësimore dhe shpjegon para moshatarëve hapat e ndjekur për krijimin e veprës. III.3. Parashtron pyetje dhe shfaq mendime të strukturuara për zgjidhjen e një problemi apo detyre të një teme të caktuar, bën përmbledhjen e së paku dy veprimeve të përdorura të cilat përcaktojnë drejtimin e mëtejmë të të nxënit të vet për temën apo problemin e caktuar. IV.3. Hulumton dhe shfrytëzon mundësitë relevante në dispozicion për zgjedhje të suksesshme të shkollimit të mëtejshëm apo për përgatitje profesionale dhe për këshillim në karrierë, duke përdorur me sukses njohuritë dhe shkathtësitë që i zotëron.			

V.4. Ilustron me shembuj para të tjerëve modelet/praktikat e sjelljeve që reflektojnë mënyrat e mbrojtjes dhe të kultivimit të kulturës së vet, vlerave, besimeve dhe kulturave të të tjerëve në mjedisin ku jeton dhe më gjerë. VI.6. Demonstron veprime të ndryshme që shprehin tolerancë, respekt dhe qëndrim të hapur ndaj dallimeve në komunitetin ku jeton (në klasë, në shkollë, në lagje dhe me gjerë) dhe i shpjegon ato në një debat me të tjerët.
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.1. Krijon vepra artistike duke përdorur mjete të ndryshme shprehëse për të komunikuar dhe shprehur përjetimet, ndjenjat dhe idetë personale. 1.2. Prezanton aftësitë e tij/saj krijuese dhe interpretuese në klasë dhe para një audience të caktuar me vetëbesim dhe siguri.
Aspektet specifike të planit të orës mësimore
Njësia mësimore: Mozaiku
Fjalët kyçe: Mozaiku, gurë, copa xhami, mozaiku romak, mozaiku bizantin
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore: - **zbulon** teknikën e mozaikut me qëllim përdorimin në mënyrë krijuese; - **përdor** mjetet dhe materialet e duhura në realizimin e mozaikut; - **organizon** informacionin, përcakton fazat dhe kohën që i duhet për të realizuar një mozaik; - **shpreh** idetë në mënyrë origjinale nëpërmjet përdorimit me kompetencë të teknikës së mozaikut.
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Arti figurativ kl. X, Imazhe të mozaikëve dhe të teknikës së punimit; Mjete të tilla si: letra, kartonë, letra me ngjyra etj.
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Fusha: Shoqëria dhe mjedisi, Gjuha dhe komunikimi, Jeta dhe puna
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: kujtesa pamore, bashkëbisedim Nxënësit diskutojnë për mozaikun si një teknikë aplikative që realizohet nëpërmjet elementeve të vogla katrore prej guri dhe xhami. Ata diskutojnë për materialet që kanë përdorur, nga eksperienca e tyre në shkollë për realizimin e mozaikut dhe për karakteristikat e veçanta që kjo teknikë ofron. **Ndërtimi i njohurive të reja: Kujtesa pamore, demonstrim, punë individuale** Mësuesi/ja shpjegon karakteristikat e procesit të realizimit të mozaikut si në periudhën romake ashtu edhe në Bizant dhe përhapjen e madhe që mori kjo teknikë në këto periudha. Gjithashtu, ata diskutojnë për funksionet e kësaj teknike si në shtrimin e dyshemeve ashtu edhe për përdorimin e saj në mur. Duke u mbështetur në karakteristikat e mozaikut bizantin dhe në tonalitetet e ngjyrës që ata përdorin, mësuesi/ja i fton nxënësit të krijojnë një mozaik. Në fillim, ata duhet të përgatisin copëzat e mozaikut të tyre nëpërmjet letrës së përgatitur më parë me tonalitetet e ngjyrës. **Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: diskutimi** Në fund të orës së mësimit, nxënësit diskutojnë për mozaikun e tyre dhe mënyrën e realizimit. Ata shpjegojnë për mundësitë e shumta shprehëse të teknikës së mozaikut dhe mënyrën se si i përdorën tonalitetet e ngjyrës në mozaik për të krijuar vëllimin.
Vlerësimi i nxënësve
Vlerësimi i nxënësit do të fokusohet: - në diskutimet që ata/ato bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me njësinë e re; - në vlerësimin e punës; - në mënyrën e realizimit të detyrës; - në analizën vlerësuese që nxënësit i bëjnë punës së tyre dhe të shokëve/shoqeve.
Detyrat dhe puna e pavarur

Punë individuale (detyrë shtëpie) Nxënësit plotësojnë detyrën e mozaikut **të filluar në klasë ose krijojnë një** mozaik **të ri duke përdorur materiale** sipas dëshirës për copëzat.
Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 5

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Arte	**Lënda:** Arti figurativ	**Shkalla e kurrikulës:** V	**Klasa:** X
Krijimtaria dhe performanca artistike **Tema:** Krijimi i punimeve artistike në teknika dhe mediume të ndryshme artistike		**Rezultati i të nxënit të temës** (nga plani dymujor): Njeh karakteristikat dhe veçoritë shprehëse të grafikës. Aplikon dhe përvetëson teknikat e grafikës gjatë punës së të shprehurit artistik. Analizon dhe vlerëson krijimet artistike vetjake dhe të tjerëve, duke analizuar, elementet, parimet dhe teknikat e gjuhës artistike.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.5. Jep dhe merr informacione në mënyrë konstruktive dhe krijuese për të dhënat e mbledhura për një temë të caktuar në formë tekstuale, numerike, verbale, elektronike apo në ndonjë formë tjetër të të shprehurit. II.4. Modelon zgjidhjen e një problemi të dhënë (në klasë, apo jashtë saj) për një temë të caktuar nga një fushë mësimore, duke e zbërthyer në hapa të vegjël dhe jep sqarime të nevojshme për hapat e ndjekur në zgjidhjen e problemit, duke përdorur forma të ndryshme të të shprehurit. II.8. Krijon një vepër artistike me pamje dy dhe tredimensionale me mesazhe nga një fushë mësimore dhe shpjegon para moshatarëve hapat e ndjekur për krijimin e veprës. III.3. Parashtron pyetje dhe shfaq mendime të strukturuara për zgjidhjen e një problemi apo detyre të një teme të caktuar, bën përmbledhjen e së paku dy veprimeve të përdorura të cilat përcaktojnë drejtimin e mëtejmë të të nxënit të vet për temën apo problemin e caktuar. IV.3. Hulumton dhe shfrytëzon mundësitë relevante në dispozicion për zgjedhje të suksesshme të shkollimit të mëtejshëm apo për përgatitje profesionale dhe për këshillim në karrierë, duke përdorur me sukses njohuritë dhe shkathtësitë që i zotëron. V.4. Ilustron me shembuj para të tjerëve modelet/praktikat e sjelljeve që reflektojnë mënyrat e mbrojtjes dhe të kultivimit të kulturës së vet, vlerave, besimeve dhe kulturave të të tjerëve në mjedisin ku jeton dhe më gjerë. VI.6. Demonstron veprime të ndryshme që shprehin tolerancë, respekt dhe qëndrim të hapur ndaj dallimeve në komunitetin ku jeton (në klasë, në shkollë, në lagje dhe me gjerë) dhe i shpjegon ato në një debat me të tjerët.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.1. Krijon vepra artistike duke përdorur mjete të ndryshme shprehëse për të komunikuar dhe shprehur përjetimet, ndjenjat dhe idetë personale. 1.2. Prezanton aftësitë e tij/saj krijuese dhe interpretuese në klasë dhe para një audience të caktuar me vetëbesim dhe siguri.			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore: Teknikat grafike të shtypit			

Fjalët kyçe: Grafika, shtypi, shtypi me reliev, ksilografi, linoleografi, gipsografi; shtypi në sipërfaqe të sheshtë, litografi, serigrafi, monotipi.

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore

Nxënësi/ja:

- **zbulon** teknikat grafike t**ë** shtypit me qëllim përdorimin në mënyrë krijuese;
- **përdor** mjetet dhe materialet e duhura në realizimin e monotipit;
- **organizon** informacionin, përcakton fazat dhe kohën që i duhet për të realizuar një monotip;
- **shpreh** idetë në mënyrë origjinale nëpërmjet përdorimit me kompetencë të teknikës së monotipit.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Arti figurativ kl. X, Imazhe të veprave të artistëve të ndryshëm të realizuara në teknikat grafike të shtypit dhe të monotipit; Mjete të tilla si: letra, tempera, pllakë plastike.

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:
Fusha: Shoqëria dhe mjedisi, Gjuha dhe komunikimi, Jeta dhe puna

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: kujtesa pamore, bashkëbisedim

Nxënësit diskutojnë për teknikat grafike të shtypit duke u mbështetur në eksperiencat e mëparshme. Ata/ato vëzhgojnë punime të realizuara me teknikën e grafike të shtypi me reliev dhe në sipërfaqe të sheshtë. Nxënësit identifikojnë mjetet e dhe proceset e realizimit të tyre.

Ndërtimi i njohurive të reja: Kujtesa pamore, demonstrim, punë **individuale**

Mësuesi/ja shpjegon prejardhjen e teknikës së shtypit, ku lindi dhe kur u përhap në Evropë. Gjithashtu rikujton proceset e teknikave në reliev apo të monotipit me të cilat nxënësit janë njohur edhe më parë në shkallët më të ulëta.

Nëpërmjet imazheve mësuesi/ja shpjegon karakteristikat e procesit të shtypit ne sipërfaqe të sheshte siç janë litografia dhe serigrafia.

Duke u mbështetur në monotipat e realizuara nga impresionisti Edgar Dega, nxënësit nxiten të krijojnë në këtë teknikë. Nxënësit ndjekin hapat duke përdorur me kompetencë mjetet e duhura të realizimin e monotipit.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: diskutimi

Në fund të orës së mësimit, nxënësit diskutojnë për detyrën e realizuar në teknikën e monotipit dhe karakteristikat e kësaj teknike. Ata shpjegojnë për mundësitë e shumta shprehëse të teknikës së monotipit, të papriturat që kjo teknikë krijon dhe për përdorën e njohurive mbi ngjyrat.

Vlerësimi i nxënësve

Vlerësimi i nxënësit do të fokusohet:

- në diskutimet që ata/ato bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me njësinë e re;
- në vlerësimin e punës;
- në mënyrën e realizimit të detyrës;
- në analizën vlerësuese që nxënësit/et i bëjnë punës së tyre dhe të shokëve/shoqeve.

Detyrat dhe puna e pavarur

Punë individuale (detyrë shtëpie)

Nxënësit eksperimentojnë me teknikën e monotipit ose me teknika te tjera të stampimit si ato me reliev apo me letër dhe i krahasojnë me njëra tjetrën për të kuptuar dallimin.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 6

<table>
<tr><th colspan="4">Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore</th></tr>
<tr><td>Fusha kurrikulare: Arte</td><td>Lënda: Arti figurativ</td><td>Shkalla e kurrikulës: V</td><td>Klasa: X</td></tr>
<tr><td colspan="2">Krijimtaria dhe performanca artistike
Tema: Krijimi i punimeve artistike në teknika dhe mediume të ndryshme artistike</td><td colspan="2">Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor):
Realizon fotografi artistike duke përdorur mjetet dhe teknikat manuale apo digjitale.
Përpunon imazhe fotografike duke përdorur programe të ndryshme kompjuterike.
Analizon dhe vlerëson krijimet artistike vetjake dhe të tjerëve, duke analizuar, elementet, parimet dhe teknikat e gjuhës artistike.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):
I.5. Jep dhe merr informacione në mënyrë konstruktive dhe krijuese për të dhënat e mbledhura për një temë të caktuar në formë tekstuale, numerike, verbale, elektronike apo në ndonjë formë tjetër të të shprehurit.
II.8. Krijon një vepër artistike me pamje dy dhe tredimensionale me mesazhe nga një fushë mësimore dhe shpjegon para moshatarëve hapat e ndjekur për krijimin e veprës.
III.3. Parashtron pyetje dhe shfaq mendime të strukturuara për zgjidhjen e një problemi apo detyre të një teme të caktuar, bën përmbledhjen e së paku dy veprimeve të përdorura të cilat përcaktojnë drejtimin e mëtejmë të të nxënit të vet për temën apo problemin e caktuar.
III.6. Shfrytëzon në mënyrë të pavarur dhe efektive teknologjinë informative dhe burime të tjera të informimit për të mbledhur materiale për zgjidhjen e një problemi apo detyre të caktuar, të cilat më pas i analizon, i klasifikon dhe i paraqet para të tjerëve përmes TIK-ut dhe ndonjë forme tjetër të shprehjes.
IV.3. Hulumton dhe shfrytëzon mundësitë relevante në dispozicion për zgjedhje të suksesshme të shkollimit të mëtejshëm apo për përgatitje profesionale dhe për këshillim në karrierë, duke përdorur me sukses njohuritë dhe shkathtësitë që i zotëron.
V.4. Ilustron me shembuj para të tjerëve modelet/praktikat e sjelljeve që reflektojnë mënyrat e mbrojtjes dhe të kultivimit të kulturës së vet, vlerave, besimeve dhe kulturave të të tjerëve në mjedisin ku jeton dhe më gjerë.
VI.6. Demonstron veprime të ndryshme që shprehin tolerancë, respekt dhe qëndrim të hapur ndaj dallimeve në komunitetin ku jeton (në klasë, në shkollë, në lagje dhe me gjerë) dhe i shpjegon ato në një debat me të tjerët.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):
1.1. Krijon vepra artistike duke përdorur mjete të ndryshme shprehëse për të komunikuar dhe shprehur përjetimet, ndjenjat dhe idetë personale.
1.2.Prezanton aftësitë e tij/saj krijuese dhe interpretuese në klasë dhe para një audience të caktuar me vetëbesim dhe siguri.</td></tr>
<tr><th colspan="4">Aspektet specifike të planit të orës mësimore</th></tr>
<tr><td colspan="4">Njësia mësimore: Fotografia</td></tr>
<tr><td colspan="4">Fjalët kyçe: fotografia manuale, fotografia digjitale, fotomontazhi, fotokolazhi</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore
Nxënësi/ja:
- zbulon mënyrën sesi funksionon aparati fotografi (digjital, ose ai manual).
- përdor aparatin digjital për të realizuar kompozime fotografike;
- organizon informacionin, përcakton fazat dhe kohën që i duhet për të realizuar një fokolazh;
- shpreh idetë në mënyrë origjinale nëpërmjet realizimit të fotokolazhit.</td></tr>
</table>

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Arti figurativ kl. X, Imazhe që ilustrojnë aparatin fotografik; imazhe të fotokolazhit dhe fotomontazhit; Mjete të tilla si: fotografi nga revista ose të realizuara nga nxënësit, letër, ngjitës, gërshërë. Mjete të tilla si: letra, tempera, pllakë plastike.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:
Fusha: Shoqëria dhe mjedisi, Gjuha dhe komunikimi, Jeta dhe puna

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: kujtesa pamore, bashkëbisedim
Nxënësit/et diskutojnë mbi aparatin fotografik dhe rëndësinë e fotografisë si një mjet për të ruajtur kujtime dhe ngjarje të ndryshme. Ata/ato diskutojnë mbi opsionet që kanë aparatet e tyre fotografikë apo celularët për manipulimin e fotografive.

Ndërtimi i njohurive të reja: Kujtesa pamore, bisedë, punë individuale
Mësuesi/ja shpjegon ndryshimin midis aparatit fotgrafik digjital dhe atij tradicional, në lidhje me mënyrën e funksionimit dhe lehtësinë për të transferuar imazhin digjital. Gjithashtu, mësuesi/ja shpjegon pjesët përbërëse të aparatit fotografik digjital dhe rolin që luajnë në krahasim me ato të aparatit tradicional. gjithashtu nxënësit diskutojnë mbi përparësitë e fotografisë digjitale në krahasim me atë tradicional duke i përmendur ato me radhë.
Njohuritë mbi fotmontazhit dhe fotokolazhit janë të rëndësishme për t'i kuptuar ato si një formë e shprehjes në art. Fotokolazhet e Dadaistëve i nxisin nxënësit të krijojnë edhe ata në këtë teknikë, duke u përpjekur të përcjellin një frymë ironie, humori apo edhe një lloj proteste ndaj fenomeneve. Nxënësit mund të realizojnë një fotokolazh me mjete tradicionale ose nëpërmjet mjeteve digjitale (kompjuter, celular ose tabletë).

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: diagrami i Venit, diskutimi
Në fund të orës së mësimit nxënësit diskutojnë për fotokolazhin e tyre dhe mënyrën e realizimit që zgjodhën. Gjithashtu, ata rendisin karakteristikat e veçanta dhe të përbashkëta të fotografisë digjitale dhe asaj tradicionale. Ata shpjegojnë për mundësitë e shumta shprehëse të fotografisë në realizimin e shumë ideve krijuese.

Vlerësimi i nxënësve

Vlerësimi i nxënësit do të fokusohet:
- në diskutimet që ata/ato bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me njësinë e re;
- në vlerësimin e punës;
- në mënyrën e realizimit të detyrës;
- në analizën vlerësuese që nxënësit i bëjnë punës së tyre dhe të shokëve/shoqeve.

Detyrat dhe puna e pavarur

Punë individuale (detyrë shtëpie)
Nxënësit udhëzohen të realizojnë kompozime të ndryshme fotografike.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 7

<table>
<tr><th colspan="4">Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore</th></tr>
<tr><td>Fusha kurrikulare: Arte</td><td>Lënda: Arti figurativ</td><td>Shkalla e kurrikulës: V</td><td>Klasa: X</td></tr>
<tr><td colspan="2">Krijimtaria dhe performanca artistike
Tema: Krijimi i punimeve artistike në teknika dhe mediume të ndryshme artistike</td><td colspan="2">Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor):
Njeh karakteristikat dhe veçoritë shprehëse të grafikës.
Aplikon dhe përvetëson teknikat e grafikës gjatë punës së të shprehurit artistik.
Njeh rolin dhe rëndësinë e dizajnit në industri.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):
I.5. Jep dhe merr informacione në mënyrë konstruktive dhe krijuese për të dhënat e mbledhura për një temë të caktuar në formë tekstuale, numerike, verbale, elektronike apo në ndonjë formë tjetër të të shprehurit.
II.8. Krijon një vepër artistike me pamje dy dhe tredimensionale me mesazhe nga një fushë mësimore dhe shpjegon para moshatarëve hapat e ndjekur për krijimin e veprës.
III.3. Parashtron pyetje dhe shfaq mendime të strukturuara për zgjidhjen e një problemi apo detyre të një teme të caktuar, bën përmbledhjen e së paku dy veprimeve të përdorura të cilat përcaktojnë drejtimin e mëtejmë të të nxënit të vet për temën apo problemin e caktuar.
III.6. Shfrytëzon në mënyrë të pavarur dhe efektive teknologjinë informative dhe burime të tjera të informimit për të mbledhur materiale për zgjidhjen e një problemi apo detyre të caktuar, të cilat më pas i analizon, i klasifikon dhe i paraqet para të tjerëve përmes TIK-ut dhe ndonjë forme tjetër të shprehjes.
IV.3. Hulumton dhe shfrytëzon mundësitë relevante në dispozicion për zgjedhje të suksesshme të shkollimit të mëtejshëm apo për përgatitje profesionale dhe për këshillim në karrierë, duke përdorur me sukses njohuritë dhe shkathtësitë që i zotëron;
V.4. Ilustron me shembuj para të tjerëve modelet/praktikat e sjelljeve që reflektojnë mënyrat e mbrojtjes dhe të kultivimit të kulturës së vet, vlerave, besimeve dhe kulturave të të tjerëve në mjedisin ku jeton dhe më gjerë.
VI.6. Demonstron veprime të ndryshme që shprehin tolerancë, respekt dhe qëndrim të hapur ndaj dallimeve në komunitetin ku jeton (në klasë, në shkollë, në lagje dhe me gjerë) dhe i shpjegon ato në një debat me të tjerët.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):
1.1. Krijon vepra artistike duke përdorur mjete të ndryshme shprehëse për të komunikuar dhe shprehur përjetimet, ndjenjat dhe idetë personale.
1.2. Prezanton aftësitë e tij/saj krijuese dhe interpretuese në klasë dhe para një audience të caktuar me vetëbesim dhe siguri.</td></tr>
<tr><th colspan="4">Aspektet specifike të planit të orës mësimore</th></tr>
<tr><td colspan="4">Njësia mësimore: Dizajni grafik</td></tr>
<tr><td colspan="4">Fjalët kyçe: Grafik dizajni, projekti artistik, logo, simboli.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore
Nxënësi/ja:
- zbulon detyrat e dizajnit grafik në projektimin e logove dhe simboleve;
- përdor mjetet dhe materialet e duhura në realizimin e logos apo të simbolit për një qëllim të caktuar;
- organizon informacionin, përcakton fazat dhe kohën që i duhet për të realizuar një logo apo një simbol;
- shpreh idetë në mënyrë origjinale nëpërmjet përdorimit me kompetencë të teknikave artistike.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Arti figurativ kl. X, Imazhe të simboleve dhe logove të suksesshme; Mjete të tilla si: letër, laps, lapustila, rapidograf etj.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:
Fusha: Shoqëria dhe mjedisi, Gjuha dhe komunikimi, Jeta dhe puna</td></tr>
</table>

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: kujtesa pamore, bashkëbisedim Nxënësit/et diskutojnë mbi detyrat krijuese të një dizajni grafik dhe njohuritë që ata kanë mbi mënyrën sesi zhvillohet një projekt artistik. Nëpërmjet imazheve të logove dhe simboleve ata zbulojnë rëndësinë e ketij profesioni në sigurimin e suksesit të një biznesi. **Ndërtimi i njohurive të reja: Kujtesa pamore, bisedë, hulumtim i orientuar** Mësuesi/ja shpjegon se dizenjues grafike quhen ata profesionistë që realizojnë projekte, të cilat kanë lidhje me forma të ndryshme të komunikimit pamor. Krijimi i simboleve, shenjave, markave dhe logove është një nga detyrat e dizajnit grafik. Simbolet dhe shenjat kanë qenë të përdorura që në antikitet, ndërsa sot shumë veprimtari funksionojnë mjaft mirë falë shenjave e simboleve që kanë një domethënie të saktë e të njohur nga të gjithë. Mësuesi/ja nëpërmjet shembujve të njohur shpjegon se marka është një shenjë ose simbol grafik që ka një funksion të qartë, atë të identifikimit të menjëhershëm të një industrie, të një firme apo të një shoqërie. Nxënësit nxiten të krijojnë një logo duke pasur parasysh elementet që e bëjnë atë të suksesshme. Nxënësit ndjekin hapat në rubrikën e veprimtarisë. **Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: diskutimi** Në fund të orës së mësimit nxënësit diskutojnë për logon apo simbolin grafik që krijuan. Ata shpjegojnë për hapat që ndoqën dhe për çfarë qëllimi është krijuar. Nxënësit e shohin dizajnin grafik si një mundësi karriere.
Vlerësimi i nxënësve
Vlerësimi i nxënësit do të fokusohet: - në diskutimet që ata/ato bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me njësinë e re; - në vlerësimin e punës; - në mënyrën e realizimit të detyrës; - në analizën vlerësuese që nxënësit/et i bëjnë punës së tyre dhe të shokëve/shoqeve.
Detyrat dhe puna e pavarur
Punë individuale (detyrë shtëpie) Nxënësit eksperimentojnë me duke krijuar logo dhe marka për kompani të ndryshme.
Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 8

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Arte	**Lënda:** Arti figurativ	**Shkalla e kurrikulës:** V	**Klasa:** X
Krijimtaria dhe performanca artistike **Tema:** Krijimi i punimeve artistike në teknika dhe mediume të ndryshme artistike		**Rezultati i të nxënit të temës** (nga plani dymujor): Njeh rolin dhe rëndësinë e dizajnit në industri duke krijuar dizajne të produkteve të ndryshme. Analizon dhe vlerëson krijimet artistike vetjake dhe të tjerëve duke analizuar, elementet, parimet dhe teknikat e gjuhës artistike.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.5. Jep dhe merr informacione në mënyrë konstruktive dhe krijuese për të dhënat e mbledhura për një temë të caktuar në formë tekstuale, numerike, verbale, elektronike apo në ndonjë formë tjetër të të shprehurit. II.8. Krijon një vepër artistike me pamje dy dhe tredimensionale me mesazhe nga një fushë mësimore dhe shpjegon para moshatarëve hapat e ndjekur për krijimin e veprës.			

III.3. Parashtron pyetje dhe shfaq mendime të strukturuara për zgjidhjen e një problemi apo detyre të një teme të caktuar, bën përmbledhjen e së paku dy veprimeve të përdorura të cilat përcaktojnë drejtimin e mëtejmë të të nxënit të vet për temën apo problemin e caktuar.
III.6. Shfrytëzon në mënyrë të pavarur dhe efektive teknologjinë informative dhe burime të tjera të informimit për të mbledhur materiale për zgjidhjen e një problemi apo detyre të caktuar, të cilat më pas i analizon, i klasifikon dhe i paraqet para të tjerëve përmes TIK-ut dhe ndonjë forme tjetër të shprehjes.
IV.3. Hulumton dhe shfrytëzon mundësitë relevante në dispozicion për zgjedhje të suksesshme të shkollimit të mëtejshëm apo për përgatitje profesionale dhe për këshillim në karrierë, duke përdorur me sukses njohuritë dhe shkathtësitë që i zotëron.
V.4. Ilustron me shembuj para të tjerëve modelet/praktikat e sjelljeve që reflektojnë mënyrat e mbrojtjes dhe të kultivimit të kulturës së vet, vlerave, besimeve dhe kulturave të të tjerëve në mjedisin ku jeton dhe më gjerë.
VI.6. Demonstron veprime të ndryshme që shprehin tolerancë, respekt dhe qëndrim të hapur ndaj dallimeve në komunitetin ku jeton (në klasë, në shkollë, në lagje dhe me gjerë) dhe i shpjegon ato në një debat me të tjerët.

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):
1.1.Krijon vepra artistike duke përdorur mjete të ndryshme shprehëse për të komunikuar dhe shprehur përjetimet, ndjenjat dhe idetë personale;
1.2.Prezanton aftësitë e tij/saj krijuese dhe interpretuese në klasë dhe para një audience të caktuar me vetëbesim dhe siguri.

Aspektet specifike të planit të orës mësimore

Njësia mësimore: Projektimi i objekteve

Fjalët kyçe: Projektimi i objekteve, dizajni i objekteve, materiale të ricikluesshme.

Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore
Nxënësi/ja:
- **zbulon** karakteristikat e profesionale të dizajnit të objekteve;
- **përdor** mjetet dhe materialet e duhura në realizimin një objekt të thjeshtë në dizajn;
- **organizon** informacionin, përcakton fazat dhe kohën që i duhet për të realizuar një objekt të thjeshtë;
- **shpreh** idetë në mënyrë origjinale nëpërmjet përdorimit me kompetencë të teknikave artistike.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:
Arti figurativ kl. X, Imazhe të ndryshme që ilustrojnë punën e dizajnit të objekteve dhe imazheve të objekteve të realizuara me materiale të ricikluesshme; Mjete të tilla si: materiale të ricikluesshme.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:
Fusha: Shoqëria dhe mjedisi, Gjuha dhe komunikimi, Jeta dhe puna

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: kujtesa pamore, bashkëbisedim
Nxënësit analizojnë imazhet që paraqesin objekte të ndryshme të dizajnit. Ata/ato diskutojnë për funksionin dhe estetikën e tyre. Nxënësit identifikojnë që estetika e një objekti është po aq i rëndësishëm sa funksioni i tij.
Ndërtimi i njohurive të reja: Kujtesa pamore, bisedë, hulumtim i orientuar
Mësuesi/ja shpjegon se produktet e industrisë, të tilla si: mjetet e punës, mobiliet, pajisjet elektroshtëpiake, mjetet e transportit etj., kanë funksione nga më të ndryshmet. T'i prodhosh të gjitha këto do të thotë të mendosh për funksionimin, sigurinë e përdoruesve e shijet e tyre, por gjithashtu do të thotë të studiosh format që nxisin blerjen e produkteve industriale. Gjithashtu, mësuesi/ja shpjegon rolin e dizajnit të objekteve si vendimtar në suksesin e këtyre objekteve. Hap pas hapi shpjegohet puna për realizimin e këtyre objekteve në industri që nga projektimi deri të realizimi i tyre.
Nëpërmjet imazheve që ilustrojnë objekte të dizajnit të realizuara me materiale të ricikluesshme nxënësit nxiten të krijojnë vetë një objekt. Ata/ato ndjekin hapat për realizimin e objektit.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: diskutimi Në fund të orës së mësimit, nxënësit diskutojnë për objektin që realizuan, funksionin dhe mënyrën e realizimit. Nxënësit e shohin projektimin e objekteve si një mundësi karriere.
Vlerësimi i nxënësve
Vlerësimi i nxënësit do të fokusohet - në diskutimet që ata/ato bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me njësinë e re; - në vlerësimin e punës; - në mënyrën e realizimit të detyrës; - në analizën vlerësuese që nxënësit i bëjnë punës së tyre dhe të shokëve/shoqeve.
Detyrat dhe puna e pavarur
Punë individuale (detyrë shtëpie) Nxënësit eksperimentojnë me duke krijuar objekte të thjeshta me materiale të ricikluesshme (ose përfundojnë detyrën e nisur në klasë).
Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 9

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Arte	**Lënda:** Arti figurativ	**Shkalla e kurrikulës:** V	**Klasa:** X
Krijimtaria dhe performanca artistike **Tema:** Krijimi i punimeve artistike në teknika dhe mediume të ndryshme artistike		**Rezultati i të nxënit të temës** (nga plani dymujor): Njeh rëndësinë e formës si elementi bazë për realizimin e skulpturës. Vëren dallimin midis relievit dhe skulpturës tredimensionale. Përdor materiale dhe teknika të ndryshme për të krijuar skulptura të ndryshme.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.5. Jep dhe merr informacione në mënyrë konstruktive dhe krijuese për të dhënat e mbledhura për një temë të caktuar në formë tekstuale, numerike, verbale, elektronike apo në ndonjë formë tjetër të të shprehurit. II.4. Modelon zgjidhjen e një problemi të dhënë (në klasë, apo jashtë saj) për një temë të caktuar nga një fushë mësimore, duke e zbërthyer në hapa të vegjël dhe jep sqarime të nevojshme për hapat e ndjekur në zgjidhjen e problemit, duke përdorur forma të ndryshme të të shprehurit. II.8. Krijon një vepër artistike me pamje dy dhe tredimensionale me mesazhe nga një fushë mësimore dhe shpjegon para moshatarëve hapat e ndjekur për krijimin e veprës. III.3. Parashtron pyetje dhe shfaq mendime të strukturuara për zgjidhjen e një problemi apo detyre të një teme të caktuar, bën përmbledhjen e së paku dy veprimeve të përdorura të cilat përcaktojnë drejtimin e mëtejmë të të nxënit të vet për temën apo problemin e caktuar. IV.3. Hulumton dhe shfrytëzon mundësitë relevante në dispozicion për zgjedhje të suksesshme të shkollimit të mëtejshëm apo për përgatitje profesionale dhe për këshillim në karrierë, duke përdorur me sukses njohuritë dhe shkathtësitë që i zotëron. V.4. Ilustron me shembuj para të tjerëve modelet/praktikat e sjelljeve që reflektojnë mënyrat e mbrojtjes dhe të kultivimit të kulturës së vet, vlerave, besimeve dhe kulturave të të tjerëve në mjedisin ku jeton dhe më gjerë.			

VI.6. Demonstron veprime të ndryshme që shprehin tolerancë, respekt dhe qëndrim të hapur ndaj dallimeve në komunitetin ku jeton (në klasë, në shkollë, në lagje dhe me gjerë) dhe i shpjegon ato në një debat me të tjerët.
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.1. Krijon vepra artistike duke përdorur mjete të ndryshme shprehëse për të komunikuar dhe shprehur përjetimet, ndjenjat dhe idetë personale; 1.2. Prezanton aftësitë e tij/saj krijuese dhe interpretuese në klasë dhe para një audience të caktuar me vetëbesim dhe siguri.
Aspektet specifike të planit të orës mësimore
Njësia mësimore: Modelimi dhe derdhja
Fjalët kyçe: Modelimi, derdhja, baltë, plastelinë, derdhja në bronz
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore: **- zbulon** karakteristikat e procesit të modelimit dhe të derdhjes; **- përdor** mjetet dhe materialet e duhura në realizimin e modelimit; **- organizon** informacionin, përcakton fazat dhe kohën që i duhet për të realizuar modelimin; **- shpreh** idetë në mënyrë origjinale nëpërmjet përdorimit me kompetencë të teknikës së modelimit.
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Arti figurativ kl. X, Imazhe të ndryshme që ilustrojnë procesin e modelimit dhe të derdhjes; Mjete të tilla si: letër, laps, baltë ose plastelinë, allçi etj.
Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Fusha: Shoqëria dhe mjedisi, Gjuha dhe komunikimi, Jeta dhe puna
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: kujtesa pamore, bashkëbisedim Nxënësit diskutojnë mbi eksperiencat e tyre në modelimin e baltës dhe mënyrën e realizimit. Nëpërmjet imazhit të bizonëve të realizuara në periudhën e prehistorisë, ata identifikojnë modelimin si një teknikë shumë të vjetër. **Ndërtimi i njohurive të reja: Kujtesa pamore, bisedë, punë në grup** Mësuesi/ja shpjegon procesin e modelimit, karakteristikat dhe materialet që përdoren. Modelimi është një teknikë e vjetër e skulpturës nëpërmjet të cilës i jepet formë tredimensionale baltës argjilore. Mësuesi/ja shpjegon hapat e derdhjes së bronzit duke theksuar që edhe ajo është një teknikë e përdorur që në kohërat antike. Ata/ato diskutojnë mbi teknikën e derdhjes si një mundësi e riprodhimit të skulpturës duke ndjekur imazhet dhe shpjegimin që tregojnë këtë proces. Mësuesi shpjegon që teknika e derdhjes përdoret sot gjerësisht në industri në riprodhimin e objekteve të ndryshme të dizajnit. Nxënësit nxiten të realizojnë modele të gurëve nëpërmjet modelimit të plastelinës. Shembujt në libër orientojnë për një trajtim të formës së tyre tradicionale ose për një variant modern të tyre. Çdo anëtar i grupit caktohet të realizojë një ose disa gurë shahu (në varësi të pjesëtareve të grupit). (kjo detyrë mund të realizohet si një punë në grup). **Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: diskutimi** Në fund të orës së mësimit nxënësit diskutojnë për gurët e shahut që realizuan dhe për formën që zgjodhën të modelojnë. Ata diskutojnë edhe për karakteristikat e derdhjes dhe për mundësitë që ofron ajo për të riprodhuar një objekt.
Vlerësimi i nxënësve
Vlerësimi i nxënësit do të fokusohet: - në diskutimet që ata/ato bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me njësinë e re; - në vlerësimin e punës; - në mënyrën e realizimit të detyrës; - në analizën vlerësuese që nxënësit/et i bëjnë punës së tyre dhe të shokëve/shoqeve.

Detyrat dhe puna e pavarur
Punë individuale (detyrë shtëpie) Mësuesi/ja i orienton të ndjekin hapat në libër për të eksperimentuar me procesin e derdhjes si detyrë shtëpie.
Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 10

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Arte	**Lënda:** Arti figurativ	**Shkalla e kurrikulës:** V	**Klasa:** X
Krijimtaria dhe performanca artistike **Tema:** Krijimi i punimeve artistike në teknika dhe mediume të ndryshme artistike		**Rezultati i të nxënit të temës** (nga plani dymujor): Dallojnë karakteristikat e veçanta të pikturës aplikative (muraleve dhe grafiteve). Realizon punime në teknikën e grafitit përmes të cilave prezanton pikëpamjet e tij. Analizon dhe vlerëson krijimet artistike vetjake dhe të tjerëve duke analizuar, elementet, parimet dhe teknikat e gjuhës artistike.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.5. Jep dhe merr informacione në mënyrë konstruktive dhe krijuese për të dhënat e mbledhura për një temë të caktuar në formë tekstuale, numerike, verbale, elektronike apo në ndonjë formë tjetër të të shprehurit. II.4. Modelon zgjidhjen e një problemi të dhënë (në klasë, apo jashtë saj) për një temë të caktuar nga një fushë mësimore, duke e zbërthyer në hapa të vegjël dhe jep sqarime të nevojshme për hapat e ndjekur në zgjidhjen e problemit, duke përdorur forma të ndryshme të të shprehurit. II.8. Krijon një vepër artistike me pamje dy dhe tredimensionale me mesazhe nga një fushë mësimore dhe shpjegon para moshatarëve hapat e ndjekur për krijimin e veprës. III.3. Parashtron pyetje dhe shfaq mendime të strukturuara për zgjidhjen e një problemi apo detyre të një teme të caktuar, bën përmbledhjen e së paku dy veprimeve të përdorura të cilat përcaktojnë drejtimin e mëtejmë të të nxënit të vet për temën apo problemin e caktuar. IV.3. Hulumton dhe shfrytëzon mundësitë relevante në dispozicion për zgjedhje të suksesshme të shkollimit të mëtejshëm apo për përgatitje profesionale dhe për këshillim në karrierë, duke përdorur me sukses njohuritë dhe shkathtësitë që i zotëron. V.4. Ilustron me shembuj para të tjerëve modelet/praktikat e sjelljeve që reflektojnë mënyrat e mbrojtjes dhe të kultivimit të kulturës së vet, vlerave, besimeve dhe kulturave të të tjerëve në mjedisin ku jeton dhe më gjerë. VI.6. Demonstron veprime të ndryshme që shprehin tolerancë, respekt dhe qëndrim të hapur ndaj dallimeve në komunitetin ku jeton (në klasë, në shkollë, në lagje dhe me gjerë) dhe i shpjegon ato në një debat me të tjerët.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.1. Krijon vepra artistike duke përdorur mjete të ndryshme shprehëse për të komunikuar dhe shprehur përjetimet, ndjenjat dhe idetë personale. 1.2. Prezanton aftësitë e tij/saj krijuese dhe interpretuese në klasë dhe para një audience të caktuar me vetëbesim dhe siguri.			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore: Arti publik: Muralet dhe grafiti urban			

Fjalët kyçe: Murale, grafiti urban, (stensil, bombola spraji, penela).

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore

Nxënësi/ja:

- **zbulon** karakteristikat dhe mundësitë shprehëse **të** teknikës **së** grafitit urban;
- **përdor** mjetet dhe materialet e duhura në realizimin e një grafiti në letër;
- **organizon** informacionin, përcakton fazat dhe kohën që i duhet për të realizuar grafitin;
- **shpreh** idetë në mënyrë origjinale nëpërmjet përdorimit me kompetencë të mjeteve të duhura.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Arti figurativ kl. X, Imazhe të ndryshme që ilustrojnë muralet dhe grafitin urban; Mjete të tilla si: letër, laps, penela, sprajin apo teknikën e shtypit me letër.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi, Gjuha dhe komunikimi, Jeta dhe puna

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: kujtesa pamore, bashkëbisedim

Mësuesi/ja i fton nxënësit të vëzhgojnë imazhe të ndryshme të grafitit urban dhe i pyet nëse ata kanë parë të tilla në vendin ku ata jetojnë.

Ndërtimi i njohurive të reja: Kujtesa pamore, bisedë, punë në grup

Nëpërmjet imazheve të murales moderne meksikane, mësuesi/ja shpjegon këtë formë të veçantë të shprehjes artistike. Mësuesi/ja shpjegon arsyet e lindjes së kësaj forme artistike dhe përfaqësuesit e saj.

Ndërsa grafiti bashkëkohor është një shprehje bashkëkohore e murales.

Pasi diskutojnë për përfaqësuesit dhe teknikat e realizimit të tyre, mësuesja/si i udhëzon ata të realizojnë një të tillë në tabakë të mëdha letre, duke u ndarë në grupe.

Mësuesi/ja orienton nxënësit të vëzhgojnë disa nga grafitet e artistit bashkëkohor, të vetëquajtur Banksi (Banksy). Në imazhet e tij ai përdor shpesh ironinë dhe humorin.

Mësuesi/ja i orienton të përzgjedhin materialet sipas dëshirës dhe të japin një mesazh të caktuar Në këtë rast, bashkëpunimi mes tyre është i nevojshëm dhe pjesë e punës në grup.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: diskutimi

Në fund të orës, nxënësit shohin rezultatin dhe diskutojnë mbi mënyrën e realizimit të saj dhe mesazhin që që kanë dashur japin. Ata/ato kuptojnë mundësitë e shumta shprehëse në realizimin e muraleve me letër.

Vlerësimi i nxënësve

Vlerësimi i nxënësit do të fokusohet:

- në diskutimet që ata/ato bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me njësinë e re;
- në vlerësimin e punës së secilit/ës nxënës/e (brenda grupit);
- në mënyrën e realizimit të detyrës;
- në analizën vlerësuese që nxënësit i bëjnë punës së tyre dhe të shokëve/shoqeve.

Detyrat dhe puna e pavarur

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 11

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Arte	**Lënda:** Arti figurativ	**Shkalla e kurrikulës:** V	**Klasa:** X
Krijimtaria dhe performanca artistike **Tema:** Krijimi i punimeve artistike në teknika dhe mediume të ndryshme artistike		**Rezultati i të nxënit të temës** (nga plani dymujor): Dallon elementet dhe funksionin bazë të arkitekturës për shoqërinë. Analizon dhe vlerëson krijimet artistike vetjake dhe të tjerëve duke analizuar, elementet, parimet dhe teknikat e gjuhës artistike.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.3. Diskuton në mënyrë konstruktive (në gjuhë amtare dhe/ose në një gjuhë të huaj) me moshatarët dhe të rriturit për tema me interes mësimor, shoqëror ose nga jeta e përditshme, duke bërë pyetje, përgjigje dhe duke veçuar informacionin kryesor. II.1. Prezanton mënyrën e grumbullimit, të zgjedhjes dhe të klasifikimit të informatave për fusha të ndryshme mësimore apo për një temë të caktuar, ofron argumente për zhvillimet aktuale lidhur me temën përkatëse (p.sh., temë nga shkenca, kultura, arti, sporti, shëndetësia, shoqëria, mjedisi etj.). III.4. Zgjidh një problem të caktuar mësimor ose një situatë nga jeta e përditshme në bazë të një planifikimi të dhënë dhe në bazë të rezultatit të ftuar vërteton saktësinë e planifikimit dhe tregon me shembuj se si do të zbatojë strategjinë e ndjekur edhe në situata dhe kontekste të tjera gjatë të nxënit. IV.8. Analizon gjendjen e mjedisit (në klasë, në shkollë, në komunitet apo më gjerë), pasojat e ndotjes, propozon alternativa për mbikëqyrje dhe menaxhim të drejtë të gjendjes së vlerësuar më të ndjeshme dhe inicion zgjidhje konkrete. V.2. Merr pjesë aktivisht në lojëra, në gara sportive apo në aktivitete të tjera kulturore dhe në mënyrë konstruktive menaxhon emocionet e veta. VI.7. Diskuton me të tjerët apo në një formë tjetër të të shprehurit paraqet interesin personal për çështje publike, shoqërore, historike, natyrore etj., dhe jep propozime për zgjidhjen e ndonjë problemi në komunitet e më gjerë në një fushë të caktuar.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.1. Krijon vepra artistike duke përdorur mjete të ndryshme shprehëse për të komunikuar dhe shprehur përjetimet, ndjenjat dhe idetë personale; 1.2. Prezanton aftësitë e tij/saj krijuese dhe interpretuese në klasë dhe para një audience të caktuar me vetëbesim dhe siguri.			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore: Arkitektura: urbanistika			
Fjalët kyçe: Urbanistika, planimetria, elementet e qytetit dhe funksioni shprehës			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore **Nxënësi/ja:** - **zbulon** që planimetria është mjeti thelbësor për studimin e urbanistikës; - **vëzhgon dhe analizon** elementet e qytetit dhe funksionet e tyre; - **krahason** planimetrinë e qyteteve në periudha të ndryshme të historisë.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Arti figurativ kl. X, Imazhe të ndryshme që ilustrojnë planimetrinë dhe urbanistikën.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Fusha: Shoqëria dhe mjedisi, Gjuha dhe komunikim, Jeta dhe puna			
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore			

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: kujtesa pamore, bashkëbisedim Nëpërmjet imazhit të një plani urban nxënësit/et diskutojnë mbi legjendën dhe rëndësinë e planifikimit. Ata/ato zbulojnë elementet e qytetit, funksionet e tyre dhe mënyrën sesi shfaqen në planin urban. **Ndërtimi i njohurive të reja: Kujtesa pamore, bisedë, punë në grup** Mësuesi/ja shpjegon se Urbanistika studion lindjen e qytetit dhe zhvillimin e tij. Ajo analizon faktorët historikë, ekonomikë dhe kulturorë që përbëjnë bazën mbi të cilën është ndërtuar qyteti dhe identifikon kriteret për të projektuar në të ardhmen. Nxënësit identifikojnë pjesët e ndryshme përbërëse të mjedisit urban nëpërmjet leximit të planimetrisë. Mësuesi/ja shpjegon se si Gjeografia dhe Historia na ndihmojnë të kuptojmë pse qytetet janë ndërtuar në nj vend të caktuar dhe pse pati një zhvillim të tillë gjatë historisë. Nxënësit diskutojnë sesi ka ndryshuar qyteti gjatë kohërave si rrjedhojë e mënyrës së jetesës. Elementet e qytetit dhe funksionet e tyre janë shumë të rëndësishëm për hartimin e planit urban të një qyteti. Nëpërmjet shembujve të ndryshëm të urbanistikës nxënësit zbulojnë zhvillimin e qyteteve dhe karakteristikat e tij në kohë të ndryshme. Nxënësit ndahen në dy grupe dhe përzgjedhin hapësirën për të cilën do të realizojnë planin urban. Ata ndajnë detyrat për çdo anëtar të grupit **Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: diskutimi** Në fund të orës, nxënësit e çdo grupi shpjegojnë hapësirën që kanë zgjedhur për ndërhyrje urbanistike dhe argumentojnë nevojat e ndërhyrjeve në urbanistikën e këtyre zonave. Ata gjithashtu krahasojnë planimetrinë e qyteteve në periudha të ndryshme.
Vlerësimi i nxënësve
Vlerësimi i nxënësit do të fokusohet: - në diskutimet që ata/ato bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me njësinë e re; - në analizën e elementeve të qytetit dhe funksionet e tyre; - në krahasimin e planimetrisë së qyteteve në periudha të ndryshme të historisë.
Detyrat dhe puna e pavarur
.**Punë kërkimore** (detyrë shtëpie) **Çdo nxënës kërkon dhe mbledh të dhëna të cilat i janë ngarkuar nga grupi si detyrë.**
Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 12

Projekt artistik

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Arte	**Lënda:** Arti figurativ	**Shkalla e kurrikulës:** V	**Klasa:** X
Relacioni art-shoqëri **Tema:** Ekspozita dhe aktivitete kulturore		**Rezultati i të nxënit të temës** (nga plani dymujor): Dallon elementet dhe funksionin bazë të arkitekturës për shoqërinë. Përzgjedh dhe përdor materiale të ndryshme për të krijuar konstruksione të ndryshme arkitektonike në miniaturë. Merr pjesë në ekspozita e projekte artistike në klasë, shkollë e komunitet.	

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.3. Diskuton në mënyrë konstruktive (në gjuhë amtare dhe/ose në një gjuhë të huaj) me moshatarët dhe të rriturit për tema me interes mësimor, shoqëror ose nga jeta e përditshme, duke bërë pyetje, përgjigje dhe duke veçuar informacionin kryesor. I.8. Prezanton një projekt artistik, humanitar, eksperimentues etj.) nga fusha të ndryshme mësimore, të hartuar individualisht dhe në grup për një temë të caktuar, duke përdorur në mënyrë efektive teknologjinë informative dhe teknologji të tjera. II.1. Prezanton mënyrën e grumbullimit, të zgjedhjes dhe të klasifikimit të informatave për fusha të ndryshme mësimore apo për një temë të caktuar, ofron argumente për zhvillimet aktuale lidhur me temën përkatëse (p.sh., temë nga shkenca, kultura, arti, sporti, shëndetësia, shoqëria, mjedisi etj.). II.10. Simulon një situatë për marrjen e një vendimi për jetën e vet ose zgjidhjen e një problemi me interes shoqëror, lidh vendimin me pasojat në mënyrë të përgjegjshme, e prezanton gjatë një debati me moshatarë në një kohëzgjatje të caktuar, duke u bazuar në këtë përvojë merr vendime dhe iniciativa të dobishme për vete, për shkollën dhe më gjerë. III.4. Zgjidh një problem të caktuar mësimor ose një situatë nga jeta e përditshme. Në bazë të një planifikimi të dhënë dhe në bazë të rezultatit të ftuar vërteton saktësinë e planifikimit dhe tregon me shembuj se si do të zbatojë strategjinë e ndjekur edhe në situata dhe kontekste të tjera gjatë të nxënit; IV.6. Harton një projekt (individualisht ose në grup) për organizimin e një aktiviteti me karakter edukativ brenda ose jashtë shkollës, në të cilin identifikon dhe vlerëson resurset e nevojshme njerëzore dhe materiale që mundësojnë arritjen e objektivave të caktuara. IV.8. Analizon gjendjen e mjedisit (në klasë, në shkollë, në komunitet apo më gjerë), pasojat e ndotjes, propozon alternativa për mbikëqyrje dhe menaxhim të drejtë të gjendjes së vlerësuar më të ndjeshme dhe inicion zgjidhje konkrete. V.2. Merr pjesë aktivisht në lojëra, në gara sportive apo në aktivitete të tjera kulturore dhe në mënyrë konstruktive menaxhon emocionet e veta. VI.7. Diskuton me të tjerët apo në një formë tjetër të të shprehurit paraqet interesin personal për çështje publike, shoqërore, historike, natyrore etj., dhe jep propozime për zgjidhjen e ndonjë problemi në komunitet e më gjerë në një fushë të caktuar.
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 3.4. Njohin dhe krahasojnë tradita të ndryshme artistike në periudha të ndryshme historike. 1.1. Krijon vepra artistike duke përdorur mjete të ndryshme shprehëse për të komunikuar dhe shprehur përjetimet, ndjenjat dhe idetë personale. 1.2.Prezanton aftësitë e tij/saj krijuese dhe interpretuese në klasë dhe para një audience të caktuar me vetëbesim dhe siguri.
Aspektet specifike të planit të orës mësimore
Njësia mësimore: Projekt artistik (punë në grup)
Fjalët kyçe: Urbanistika, planimetria, elementet e qytetit dhe funksioni shprehës
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore **Nxënësi/ja:** - **zbulon** karakteristikat e planit dhe projektit urban; - **përdor** mjetet dhe materialet e duhura në realizimin e moketit të planit urban; - **organizon** informacionin, përcakton fazat dhe kohën që i duhet për të realizuar idenë dhe moketin e planit urban; - **shpreh** idetë në mënyrë origjinale nëpërmjet përdorimit me kompetencë të teknikave të duhura artistike.
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Arti figurativ kl. X, Imazhe të ndryshme që ilustrojnë planimetrinë dhe urbanistikën. Mjetet e punës planifikohen nga grupi

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:
Fusha: Shoqëria dhe mjedisi, Gjuha dhe komunikimi, Jeta dhe puna

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: kujtesa pamore, bashkëbisedim
Në fillim të mësimit, anëtarët e çdo grupi nxjerrin **të dhënat që kanë mbledhur për hapësirën urbane si fotografi, shënime të ndryshme, apo historinë e zonës. Ata diskutojnë mbi nevojat e zonës dhe mundësitë e përshtatjes të ideve të** reja.
Ndërtimi i njohurive të reja: Kujtesa pamore, bisedë, punë në grup
Mbas mbledhjes së të dhënave, nxënësit/et bëjnë skicën e planimetrisë duke vendosur në të ndërtesat, rrugët dhe hapësirat e gjelbra (nëse ka). Ata/ato vëzhgojnë dhe analizojnë nëse në planimetrinë ekzistuese hapësirat janë të organizuara mirë në lidhje me nevojat që kanë banorët e saj: funksionin estetik të paraqitjes së ndërtesave, rrugëve, hapësirave të gjelbra etj.;
funksionin teknik që ka të bëjë me raportin që krijojnë ndërtesat me njëra tjetrën dhe me ruajtjen e distancave të duhura mes tyre;
funksionin ekonomik siç janë veprimtaritë tregtare dhe shërbimet e ndryshme të nevojshme për komunitetin.
Mbas kësaj analize, nxënësit bëjnë ndryshimet e mundshme në planimetri në shërbim të përmirësimit të jetës së komunitetit (shërbimet dhe veprimtaritë tregtare që janë të nevojshme, zgjerimin e hapësirave të gjelbra, hapësirat dhe raportet midis ndërtesave etj.).
Grupet realizojnë modelin tredimensional të planimetrisë. Ky model duhet të jetë i kuptueshëm dhe i qartë edhe për ata që nuk janë ekspertë. Për të ndërtuar modelin tredimensional mund të përdoren materiale të tilla si: letra e kartonë, kuti të gatshme, copa druri, plastelinë, sfungjer, bukë peshku, lojëra lego, plastikë, allçi etj. Nxënësit/et zgjedhin materialet sipas idesë që do të realizojnë.
Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: diskutimi
Në fund të orës, nxënësit e çdo grupi shpjegojnë planimetrinë e zonës me ndërhyrjet që kanë bërë. Ata gjithashtu argumentojnë këto ndërhyrje duke u mbështetur në anën funksionale por edhe estetike të tyre në shërbim të komunitetit.

Vlerësimi i nxënësve

Vlerësimi i nxënësit do të fokusohet:
- në diskutimet që ata/ato bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me njësinë e re;
- në analizën e elementeve të qytetit dhe funksionet e tyre;
- në krahasimin e planimetrisë së qyteteve në periudha të ndryshme të historisë.

Detyrat dhe puna e pavarur

Punë kërkimore (detyrë shtëpie)
Nxënësit mund **të bëjnë** plotësimet e nevojshme **në** projektin e tyre.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 1

<table>
<tr><th colspan="4">Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore</th></tr>
<tr><td>Fusha kurrikulare: Arte</td><td>Lënda: Arti figurativ</td><td>Shkalla e kurrikulës: V</td><td>Klasa: X</td></tr>
<tr><td colspan="2">Relacioni art-shoqëri
Tema: Histori arti</td><td colspan="2">Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor):
Njeh zhvillimet historike të artit dhe dallon periudha të ndryshme të artit.
Përshkruan dhe dallon karakteristikat kryesore të periudhave historike të artit.
Identifikon karakteristikat dalluese të veprave të njohura të artit në periudha të ndryshme historike.
Debaton rreth periudhave të artit dhe veprave artistike duke përdorur një fjalor të pasur artistik.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):
I.1. Shpreh mendimin e vet me gojë ose me shkrim, apo në ndonjë formë tjetër të të shprehurit (simbole, kode, shenja dhe shprehje të tjera artistike), për një temë të caktuar që reflekton aspekte të përgatitjes akademike në arsimin e mesëm të lartë.
II.2. Krahason të paktën tri burime të ndryshme të informimit për trajtimin e temës së njëjtë, argumenton saktësinë, rrethanat, gjen ngjashmëritë dhe dallimet, duke u bazuar në kriteret e përcaktuara më parë, i prezanton gjetjet kryesore para të tjerëve në forma të ndryshme shprehëse, duke përdorur teknologjinë informative.
III.6. Shfrytëzon në mënyrë të pavarur dhe efektive teknologjinë informative dhe burime të tjera të informimit për të mbledhur materiale për zgjidhjen e një problemi apo detyre të caktuar, të cilat më pas i analizon, i klasifikon dhe i paraqet para të tjerëve përmes TIK-ut dhe ndonjë forme tjetër të shprehjes.
IV.3. Hulumton dhe shfrytëzon mundësitë relevante në dispozicion për zgjedhje të suksesshme të shkollimit të mëtejshëm apo për përgatitje profesionale dhe për këshillim në karrierë, duke përdorur me sukses njohuritë dhe shkathtësitë që i zotëron.
V.4. Ilustron me shembuj para të tjerëve modelet/praktikat e sjelljeve që reflektojnë mënyrat e mbrojtjes dhe të kultivimit të kulturës së vet, vlerave, besimeve dhe kulturave të të tjerëve në mjedisin ku jeton dhe më gjerë.
VI.7. Diskuton me të tjerët apo në një formë tjetër të të shprehurit paraqet interesin personal për çështje publike, shoqërore, historike, natyrore etj., dhe jep propozime për zgjidhjen e ndonjë problemi në komunitet e më gjerë në një fushë të caktuar.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):
3.1. Identifikon dhe elaboron me shkrim, me gojë ose me forma të tjera të prezantimit, rolin e artit dhe të zhvillimeve artistike në kontekstin kulturor dhe atë historik në periudhat e ndryshme të zhvillimit shoqëror.
3.3 Përshkruan dhe kategorizon vepra të ndryshme të artit dhe objekte të trashëgimisë kulturore sipas periudhës historike, kulturës, stilit dhe artistit.
3.4 Njeh dhe krahason tradita të ndryshme artistike në periudha të ndryshme historike.</td></tr>
<tr><th colspan="4">Aspektet specifike të planit të orës mësimore</th></tr>
<tr><td colspan="4">Njësia mësimore: Arti në prehistori</td></tr>
<tr><td colspan="4">Fjalët kyçe: Arti prehistorik, paleoliti, mezoliti, neoliti, artefakte, megalitet, pikturat e shpellave, palafite.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore
Nxënësi/ja:
- vëzhgon artefakte nga periudha prehistorike;
- përshkruan, analizon, interpreton dhe vlerëson artefakte dhe gjetje arkeologjike të periudhave të prehistorisë lidhur ngushtë me karakteristikat e zhvillimit të tyre historik;
- argumenton dhe komunikon mendimin e tij mbi veprën;
- analizon dhe paraqet informacionin e mbledhur në mënyrë individuale rreth shenjave në prehistori.</td></tr>
</table>

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Arti figurativ kl. X, ilustrime të artefakteve nga prehistoria.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:
Fusha: Shoqëria dhe mjedisi, Shkencat e natyrës, Gjuha dhe komunikimi, Jeta dhe puna

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: kujtesa pamore, bashkëbisedim
Nëpërmjet vëzhgimit të imazheve, nxënësit diskutojnë mbi periudhën e prehistorisë duke u bazuar në njohuritë e tyre në lëndën e historisë. Ata diskutojnë edhe për artin prehistorik si artefakte të rëndësishme që hedhin dritë mbi këtë periudhë.

Ndërtimi i njohurive të reja: Kujtesa pamore, bisedë, hapat e kritikës së artit
Mësuesi/ja shpjegon se periudhat kryesore të prehistorisë janë: Paleoliti (Epoka e Gurit të Lartë), Mezoliti (Epoka e Gurit të Mesëm), dhe Neoliti (Epoka e Gurit të Vonë). Në fillim mësimi fokusohet te periudha e paleolitit, shtrirjen e saj kohore, artefaktet e kësaj periudhe me karakteristikat e tyre, banesat e para primitive. Më pas mësuesi/ja shpjegon se epoka e neolitit shënon kalimin nga gjuetia tek agrikultura. Karakteristikat e kësaj periudhe janë të lidhura ngushtë me zhvillimet që pati shoqëria primitive në këtë periudhë. Kjo gjë pasqyrohet edhe në mënyrën e jetesës, ndërtimin e banesave e gjithashtu pasqyrohet në format artistike të përmirësuara.
Nëpërmjet imazheve nxënësit njihen me format e arkitekturës monumentale megalitet, karakteristikat e tyre të ndërtimit dhe përdorimin e tyre.
Mësuesi/ja shpjegon që në territoret e banuara sot nga shqiptarët, arti prehistorik identifikohet në periudhën e neolitit (7 deri në 4 mijë vjet p.e.r.). mësuesi/ja informon për vendbanimet dhe objektet e gjetura aty. Hyjnesha n fron është një nga artefaktet më interesante të gjetura në Kosovë në këtë periudhë.
Në rubrikën Lexim vepre: Pikturat e shpellave prehistorike (Altamira, Lesku), nxënësit bëhen pjesë aktive e mësimit duke argumentuar dhe komunikuar mendimin e tyre mbi të. Gjithashtu, piktura shkëmbore e Vlashnjës bëhet pjesë e kësaj rubrike.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: diskutimi
Në fund të orës, nxënësit diskutojnë mbi argumentet e trajtuara gjatë mësimit. Për karakteristikat e artit të kësaj periudhe duke e parë edhe periudhën e neolitit në trojet shqiptare si pjesë të rëndësishme të kësaj kulture botërore.

Vlerësimi i nxënësve

Vlerësimi i nxënësit do të fokusohet:
- në diskutimet që ata/ato bëjnë duke lidhur njohuritë me njësinë e re;
- në pjesëmarrjen e tyre aktive gjatë procesit mësimor;
- në **paraqitjen e** informacionit të mbledhur në mënyrë individuale.

Detyrat dhe puna e pavarur

Kërkim informacioni në mënyrë individuale (detyrë shtëpie)
"Shenjat në prehistori" ose "Krahaso figurën femërore të "Mbretëreshës në fron" me figura **të tjera të periudhës së neolitit"**.
Nxënësit orientohen **të bëjnë kërkime** individuale sipas kërkesave të kësaj rubrike në libër dhe i sjellin në klasë. Ata mund **të** zgjedhin një**rën** nga temat e dhë**na**.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 2

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Arte	**Lënda:** Arti figurativ	**Shkalla e kurrikulës:** V	**Klasa:** X
Relacioni art-shoqëri **Tema:** Histori arti		**Rezultati i të nxënit të temës** (nga plani dymujor): Njeh zhvillimet historike të artit dhe dallon periudha të ndryshme të artit. Përshkruan dhe dallon karakteristikat kryesore të periudhave historike të artit. Identifikon karakteristikat dalluese të veprave të njohura të artit në periudha të ndryshme historike. Debaton rreth periudhave të artit dhe veprave artistike duke përdorur një fjalor të pasur artistik. Analizon veprat e artit në kontekstin e tyre historik, duke i lidhur me ngjarjet e rëndësishme shoqërore e sociale. Identifikon zhvillimet e ndryshme shkencore, teknologjike, sociale, që ndikuan në zhvillimin e art.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.1. Shpreh mendimin e vet me gojë ose me shkrim, apo në ndonjë formë tjetër të të shprehurit (simbole, kode, shenja dhe shprehje të tjera artistike), për një temë të caktuar që reflekton aspekte të përgatitjes akademike në arsimin e mesëm të lartë. II.2. Krahason të paktën tri burime të ndryshme të informimit për trajtimin e temës së njëjtë, argumenton saktësinë, rrethanat, gjen ngjashmëritë dhe dallimet, duke u bazuar në kriteret e përcaktuara më parë, i prezanton gjetjet kryesore para të tjerëve në forma të ndryshme shprehëse, duke përdorur teknologjinë informative. III.6. Shfrytëzon në mënyrë të pavarur dhe efektive teknologjinë informative dhe burime të tjera të informimit për të mbledhur materiale për zgjidhjen e një problemi apo detyre të caktuar, të cilat më pas i analizon, i klasifikon dhe i paraqet para të tjerëve përmes TIK-ut dhe ndonjë forme tjetër të shprehjes. IV.3. Hulumton dhe shfrytëzon mundësitë relevante në dispozicion për zgjedhje të suksesshme të shkollimit të mëtejshëm apo për përgatitje profesionale dhe për këshillim në karrierë, duke përdorur me sukses njohuritë dhe shkathtësitë që i zotëron. V.4. Ilustron me shembuj para të tjerëve modelet/praktikat e sjelljeve që reflektojnë mënyrat e mbrojtjes dhe të kultivimit të kulturës së vet, vlerave, besimeve dhe kulturave të të tjerëve në mjedisin ku jeton dhe më gjerë. VI.7. Diskuton me të tjerët apo në një formë tjetër të të shprehurit paraqet interesin personal për çështje publike, shoqërore, historike, natyrore etj., dhe jep propozime për zgjidhjen e ndonjë problemi në komunitet e më gjerë në një fushë të caktuar.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 3.1. Identifkon dhe elaboron me shkrim, me gojë ose me forma të tjera të prezantimit, rolin e artit dhe të zhvillimeve artistike në kontekstin kulturor dhe atë historik në periudhat e ndryshme të zhvillimit shoqëror; 3.3 Përshkruan dhe kategorizon vepra të ndryshme të artit dhe objekte të trashëgimisë kulturore sipas periudhës historike, kulturës, stilit dhe artistit. 3.4 Njeh dhe krahason tradita të ndryshme artistike në periudha të ndryshme historike.			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore: Arti në Mesopotami			
Fjalët kyçe: zigurati, arkitektura, argjila, skulptura, relievi, arti sumer, arti persian, shkrimi kuneiform			

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore
Nxënësi/ja:
- **vëzhgon** artefakte nga periudha artit **në** Mesopotami;
- **përshkruan, analizon, interpreton** dhe **vlerëson** artefakte dhe gjetje arkeologjike të periudhave të të artit mesopotam lidhur ngushtë me karakteristikat e zhvillimit të tyre historik;
- **argumenton** dhe **komunikon** mendimin e tij mbi veprën;
- **analizon** dhe **paraqet** informacionin e mbledhur në mënyrë individuale rreth zhvillimit të shkrimit kuneiform.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Arti figurativ kl. X, ilustrime të artefakteve nga Mesopotamia.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:
Fusha: Shoqëria dhe mjedisi, Shkencat e natyrës, Gjuha dhe komunikimi, Jeta dhe puna, Njohja e kulturave

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: kujtesa pamore, bashkëbisedim
Nëpërmjet vëzhgimit të imazheve, nxënësit diskutojnë mbi periudhën e artit në Mesopotami duke u bazuar në njohuritë e tyre në lëndën e historisë. Ata shprehen se artefaktet e gjetura këtu janë shumë të rëndësishme për të kuptuar këtë periudhë.
Ndërtimi i njohurive të reja: Kujtesa pamore, bisedë, hapat e kritikës së artit
Mësuesi/ja shpjegon lindjen e qyteteve në Mesopotami dhe kushtet klimaterike dhe gjeografike që mundësuan lindjen e tyre. Nxënësit kuptojnë mënyrën e organizimit urbanistik të qyteteve lidhur edhe me pushtetin fetar dhe ekonomik. Mësuesi/ja shpjegon rolin dhe rëndësinë e ziguratit si një qendër jo vetëm fetare, por edhe si një qendër ekonomike shumë e rëndësishme në lindjen e qyteteve të Mesopotamisë. Shpjegohet hap pas hapi rritja dhe zhvillimi i këtyre qendrave në qytete të mirëfillta për sa i përket funksionit të tyre urbanistik. Karakteristikat e artit në Mesopotami janë pjesë e rëndësishme e njohurive në këtë mësim.
Arti sumer fokusohet në lindjen e shkrimit kuneiform dhe përdorimin e materialeve të çmuara. Arti persian fokusohet në ndërtimet e arkitekturës madhështore.
Në rubrikën Lexim vepre: Statuja e Gudes**ë ë**shtë marr**ë** si nj**ë** shembull tipik i skulptur**ë**s n**ë** Mesopotami.
Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: diskutimi
Në fund të orës, nxënësit diskutojnë mbi argumentet e trajtuara gjatë mësimit: Për lindjen e qyteteve në Mesopotami, për karakteristikat e artit të këtij qytetërimi, për arkitekturën madhështore të pallateve dhe për përdorimin e materialeve.

Vlerësimi i nxënësve

Vlerësimi i nxënësit do të fokusohet:
- në diskutimet që ata/ato bëjnë duke lidhur njohuritë me njësinë e re;
- në pjesëmarrjen e tyre aktive gjatë procesit mësimor;
- në **paraqitjen e** informacionit të mbledhur në mënyrë individuale.

Detyrat dhe puna e pavarur

Kërkim informacioni në mënyrë individuale (detyrë shtëpie)
"Zhvillimi i shkrimit kuneiform"
N**ë** lib**ë**r paraqitet nj**ë** skem**ë** e zhvillimit t**ë** shkrimit kuneiform p**ë**rgjat**ë** koh**ë**rave.
Nxënësit orientohen t**ë** b**ë**jn**ë** k**ë**rkime individuale sipas kërkesave të kësaj rubrike në libër dhe i sjellin në klasë.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 3

<table>
<tr><th colspan="4">Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore</th></tr>
<tr><td>Fusha kurrikulare: Arte</td><td>Lënda: Arti figurativ</td><td>Shkalla e kurrikulës: V</td><td>Klasa: X</td></tr>
<tr><td colspan="2">Relacioni art-shoqëri
Tema: Histori arti</td><td colspan="2">Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor):
Njeh zhvillimet historike të artit dhe dallon periudha të ndryshme të artit.
Përshkruan dhe dallon karakteristikat kryesore të periudhave historike të artit.
Identifikon karakteristikat dalluese të veprave të njohura të artit në periudha të ndryshme historike.
Debaton rreth periudhave të artit dhe veprave artistike duke përdorur një fjalor të pasur artistik.
Analizon veprat e artit në kontekstin e tyre historik, duke i lidhur me ngjarjet e rëndësishme shoqërore e sociale.
Identifikon zhvillimet e ndryshme shkencore, teknologjike, sociale, që ndikuan në zhvillimin e art.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):
I.1. Shpreh mendimin e vet me gojë ose me shkrim, apo në ndonjë formë tjetër të të shprehurit (simbole, kode, shenja dhe shprehje të tjera artistike), për një temë të caktuar që reflekton aspekte të përgatitjes akademike në arsimin e mesëm të lartë.
II.2. Krahason të paktën tri burime të ndryshme të informimit për trajtimin e temës së njëjtë, argumenton saktësinë, rrethanat, gjen ngjashmëritë dhe dallimet, duke u bazuar në kriteret e përcaktuara më parë, i prezanton gjetjet kryesore para të tjerëve në forma të ndryshme shprehëse, duke përdorur teknologjinë informative.
III.6. Shfrytëzon në mënyrë të pavarur dhe efektive teknologjinë informative dhe burime të tjera të informimit për të mbledhur materiale për zgjidhjen e një problemi apo detyre të caktuar, të cilat më pas i analizon, i klasifikon dhe i paraqet para të tjerëve përmes TIK-ut dhe ndonjë forme tjetër të shprehjes.
IV.3. Hulumton dhe shfrytëzon mundësitë relevante në dispozicion për zgjedhje të suksesshme të shkollimit të mëtejshëm apo për përgatitje profesionale dhe për këshillim në karrierë, duke përdorur me sukses njohuritë dhe shkathtësitë që i zotëron.
V.4. Ilustron me shembuj para të tjerëve modelet/praktikat e sjelljeve që reflektojnë mënyrat e mbrojtjes dhe të kultivimit të kulturës së vet, vlerave, besimeve dhe kulturave të të tjerëve në mjedisin ku jeton dhe me gjerë.
VI.7. Diskuton me të tjerët apo në një formë tjetër të të shprehurit paraqet interesin personal për çështje publike, shoqërore, historike, natyrore etj., dhe jep propozime për zgjidhjen e ndonjë problemi në komunitet e më gjerë në një fushë të caktuar.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):
3.1. Identifkon dhe elaboron me shkrim, me gojë ose me forma të tjera të prezantimit, rolin e artit dhe të zhvillimeve artistike në kontekstin kulturor dhe atë historik në periudhat e ndryshme të zhvillimit shoqëror.
3.3 Përshkruan dhe kategorizon vepra të ndryshme të artit dhe objekte të trashëgimisë kulturore sipas periudhës historike, kulturës, stilit dhe artistit.
3.4 Njeh dhe krahason tradita të ndryshme artistike në periudha të ndryshme historike.</td></tr>
<tr><th colspan="4">Aspektet specifike të planit të orës mësimore</th></tr>
<tr><td colspan="4">Njësia mësimore: Arti egjiptian</td></tr>
<tr><td colspan="4">Fjalët kyçe: Arti egjiptian, kanuni në artin egjiptian, piramida, varre monumentale, tempuj, piktura, skulptura egjiptiane.</td></tr>
</table>

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore
Nxënësi/ja:
- **vëzhgon** vepra arti nga periudha e artit egjiptian;
- **përshkruan, analizon, interpreton** dhe **vlerëson** vepra të artit egjiptian lidhur ngushtë me karakteristikat e zhvillimit të tyre historik;
- **argumenton** dhe **komunikon** mendimin e tij mbi veprën;
- **analizon** dhe **paraqet** informacionin e mbledhur në mënyrë individuale rreth veprimtarive artizanale në qytetërimin egjiptian.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:
Arti figurativ kl. X, ilustrime të artefakteve nga qytetërimi egjiptian.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:
Fusha: Shoqëria dhe mjedisi, Shkencat e natyrës, Gjuha dhe komunikimi, Jeta dhe puna, Njohja e kulturave

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: kujtesa pamore, bashkëbisedim
Nëpërmjet imazheve të ndryshme mësuesi/ja i inkurajon nxënësit të diskutojnë për qytetërimin egjiptian duke u mbështetur në njohuritë e historisë. Ata/ato diskutojnë se ky qytetërim është konsideruar për shumë kohë si një nga shoqëritë më konservatore që kanë ekzistuar dhe se lumi Nil ishte elementi kryesor në organizimin e shoqërisë, në favorizimin e tregtisë, në prodhimin dhe bashkimin e së njëjtës kulturë.
Ndërtimi i njohurive të reja: Kujtesa pamore, bisedë, hapat e kritikës së artit
Mësuesi/ja shpjegon traditat dhe fillesat e artit egjiptian duke theksuar edhe tre periudhat e këtij qytetërimi, që në art shfaqen me karakteristikat e tyre të zhvillimit.
Paraqitja e figurës së njeriut në artin egjiptian është një argument i rëndësishëm për të kuptuar më thellë dhe më mirë artin egjiptian.
Nëpërmjet imazheve, nxënësit identifikojnë format arkitektonike monumentale siç janë piramidat dhe tempujt. Ata diskutojnë suke u mbështetur në njohuritë e mëparshme. Mësuesi/ja thekson lidhjen e ngushtë të skulpturës dhe arkitekturës në artin egjiptian duke identifikuar karakteristikat e tyre.
Në rubrikën Lexim vepre: "Piktura egjiptiane" nxënësit bëhen pjesë aktive e mësimit duke argumentuar dhe komunikuar mendimin e tyre mbi karakteristikat e sidomos atë të paraqitjes së figurës së njeriut. Ngjyrat, mënyra kompozicionale, tematika dhe destinacioni janë pjesë e këtij argumenti (duke u mbështetur në imazhet ilustruese).
Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: diskutimi
Në fund të orës, nxënësit diskutojnë mbi argumentet e trajtuara gjatë mësimit: Për qytetërimin egjiptian dhe për organizimin e shoqërisë, për karakteristikat e arkitekturës dhe skulpturës, lidhjen e ngushtë mes tyre. Për pikturën egjiptiane dhe për kanunin e proporcioneve (me të cilin janë njohur te mësimi "Trupi i njeriut dhe proporcionet").

Vlerësimi i nxënësve
Vlerësimi i nxënësit do të fokusohet:
- në diskutimet që ata/ato bëjnë duke lidhur njohuritë me njësinë e re;
- në pjesëmarrjen e tyre aktive gjatë procesit mësimor;
- në **paraqitjen e** informacionit të mbledhur në mënyrë individuale.

Detyrat dhe puna e pavarur
Kërkim informacioni në mënyrë individuale (detyrë shtëpie)
"Qytetet dhe aktivitetet artizanale"
Nxënësit orientohen **të bëjnë kërkime** individuale sipas kërkesave të kësaj rubrike në libër dhe i sjellin në klasë.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 4

<table>
<tr><th colspan="4">Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore</th></tr>
<tr><td>Fusha kurrikulare: Arte</td><td>Lënda: Arti figurativ</td><td>Shkalla e kurrikulës: V</td><td>Klasa: X</td></tr>
<tr><td colspan="2">Relacioni art-shoqëri
Tema: Histori arti</td><td colspan="2">Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor):
Njeh zhvillimet historike të artit dhe dallon periudha të ndryshme të artit.
Përshkruan dhe dallon karakteristikat kryesore të periudhave historike të artit.
Identifikon karakteristikat dalluese të veprave të njohura të artit në periudha të ndryshme historike.
Debaton rreth periudhave të artit dhe veprave artistike duke përdorur një fjalor të pasur artistik.
Përshkruan dhe vlerëson vepra arti dhe objekte të trashëgimisë kulturore të trojeve shqiptare.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):
I.1. Shpreh mendimin e vet me gojë ose me shkrim, apo në ndonjë formë tjetër të të shprehurit (simbole, kode, shenja dhe shprehje të tjera artistike), për një temë të caktuar që reflekton aspekte të përgatitjes akademike në arsimin e mesëm të lartë.
II. 2. Krahason të paktën tri burime të ndryshme të informimit për trajtimin e temës së njëjtë, argumenton saktësinë, rrethanat, gjen ngjashmëritë dhe dallimet, duke u bazuar në kriteret e përcaktuara më parë, i prezanton gjetjet kryesore para të tjerëve në forma të ndryshme shprehëse, duke përdorur teknologjinë informative.
III.6. Shfrytëzon në mënyrë të pavarur dhe efektive teknologjinë informative dhe burime të tjera të informimit për të mbledhur materiale për zgjidhjen e një problemi apo detyre të caktuar, të cilat më pas i analizon, i klasifikon dhe i paraqet para të tjerëve përmes TIK-ut dhe ndonjë forme tjetër të shprehjes.
IV.3. Hulumton dhe shfrytëzon mundësitë relevante në dispozicion për zgjedhje të suksesshme të shkollimit të mëtejshëm apo për përgatitje profesionale dhe për këshillim në karrierë, duke përdorur me sukses njohuritë dhe shkathtësitë që zotëron.
V.4. Ilustron me shembuj para të tjerëve modelet/praktikat e sjelljeve që reflektojnë mënyrat e mbrojtjes dhe të kultivimit të kulturës së vet, vlerave, besimeve dhe kulturave të të tjerëve në mjedisin ku jeton dhe më gjerë.
VI.7. Diskuton me të tjerët apo në një formë tjetër të të shprehurit paraqet interesin personal për çështje publike, shoqërore, historike, natyrore etj., dhe jep propozime për zgjidhjen e ndonjë problemi në komunitet e më gjerë në një fushë të caktuar.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):
3.1. Identifikon dhe elaboron me shkrim, me gojë ose me forma të tjera të prezantimit, rolin e artit dhe të zhvillimeve artistike në kontekstin kulturor dhe atë historik në periudhat e ndryshme të zhvillimit shoqëror.
3.3. Përshkruan dhe kategorizon vepra të ndryshme të artit dhe objekte të trashëgimisë kulturore sipas periudhës historike, kulturës, stilit dhe artistit.
3.4. Njeh dhe krahason tradita të ndryshme artistike në periudha të ndryshme historike.</td></tr>
<tr><th colspan="4">Aspektet specifike të planit të orës mësimore</th></tr>
<tr><td colspan="4">Njësia mësimore: Arti ilir në periudhën e hekurit</td></tr>
<tr><td colspan="4">Fjalët kyçe: Arti në territoret ilire, arkitektura ilire, qeramika, skulptura, stolitë.</td></tr>
</table>

Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore:
Nxënësi/ja:
- **vëzhgon** vepra të ndryshme nga arti ilir;
- **përshkruan, analizon, interpreton** dhe **vlerëson** veprat e artit ilir me karakteristikat e zhvillimit të tij historik;
- **argumenton** dhe **komunikon** mendimin e tij mbi veprat e artit;
- **analizon** dhe **paraqet** informacionin e mbledhur në mënyrë individuale rreth simboleve ilire.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:
Arti figurativ kl. X, ilustrime të artefakteve ilire

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:
Fusha: Shoqëria dhe mjedisi, Shkencat e natyrës, Gjuha dhe komunikimi, Jeta dhe puna, Njohja e kulturave

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: kujtesa pamore, bashkëbisedim
Nxënësit/et diskutojnë mbi qytetërimin ilir dhe shtrirjen e tij duke u mbështetur në njohuritë e marra në lëndën e historisë. Ata/ato diskutojnë për zbulimet arkeologjike të njohura të kësaj periudhe, mbi mënyrën e jetesës dhe karakteristikat e fiseve ilire.

Ndërtimi i njohurive të reja: Kujtesa pamore, bisedë, hapat e kritikës së artit
Mësuesi/ja shpjegon se fiset ilire, trungu i të cilave kish nisur të formohej që në periudhën e bronzit, populluan gjerësisht Ballkanin Perëndimor, përgjatë gjithë periudhës së hekurit (periudhë e cila fillon rreth fundshekullit të XII p.e.r.). Shpërndarja e fiseve ilire përqendrohet kryesisht në perëndim të gadishullit të Ballkanit, ndërkohë që kolonitë helene zhvilloheshin në brigjet perëndimore të këtij gadishulli.
Mësuesi/ja shpjegon karakteristikat e arkitekturës së fiseve ilire, lidhjen e tyre me mjedisin dhe periudhën kur datojnë. Karakteristikat, teknologjia e punimit dhe format e larmishme të qeramikës trajtohen në këtë temë. Imazhet e skulpturës ilire ndihmojnë për të konkretizuar karakteristikat dhe ndikimet e saj.
Stolitë ilire tregojnë për mjeshtërinë e këtyre fiseve në punimin e metaleve. Vendbanimet ilire janë pjesë e shpjegimit për të kuptuar edhe prejardhjen e këtyre artefakteve.
Në rubrikën Lexim vepre: "Varr monumental në Selcën e Poshtme, shek IV- III p.e.r." nxënësit zbulojnë karakteristikat e varreve monumentale të gjetura aty dhe teknikën e realizimit nëpërmjet gdhendjes në shkëmb.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: diskutimi
Në fund të orës, nxënësit diskutojnë mbi argumentet e trajtuara gjatë mësimit: Për shpërndarjen e kulturës ilire, për karakteristikat vendbanimeve, të skulpturës dhe vendbanimet e gjetura në territorin e Kosovës.

Vlerësimi i nxënësve

Vlerësimi i nxënësit do të fokusohet:
- në diskutimet që ata/ato bëjnë duke lidhur njohuritë me njësinë e re;
- në pjesëmarrjen e tyre aktive gjatë procesit mësimor;
- në **paraqitjen e** informacionit të mbledhur në mënyrë individuale.

Detyrat dhe puna e pavarur

Kërkim informacioni në mënyrë individuale (detyrë shtëpie)
"Simbolet ilire"
Nxënësit orientohen **të bëjnë kërkime** individuale sipas kërkesave të kësaj rubrike në libër dhe i sjellin në klasë.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 5

<table>
<tr><th colspan="4">Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore</th></tr>
<tr><td>Fusha kurrikulare: Arte</td><td>Lënda: Arti figurativ</td><td>Shkalla e kurrikulës: V</td><td>Klasa: X</td></tr>
<tr><td colspan="2">Relacioni art-shoqëri
Tema: Histori arti</td><td colspan="2">Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor):
Njeh zhvillimet historike të artit dhe dallon periudha të ndryshme të artit.
Përshkruan dhe dallon karakteristikat kryesore të periudhave historike të artit.
Identifikon karakteristikat dalluese të veprave të njohura të artit në periudha të ndryshme historike.
Debaton rreth periudhave të artit dhe veprave artistike duke përdorur një fjalor të pasur artistik.
Analizon veprat e artit në kontekstin e tyre historik, duke i lidhur me ngjarjet e rëndësishme shoqërore e sociale.
Identifikon zhvillimet e ndryshme shkencore, teknologjike, sociale, që ndikuan në zhvillimin e art.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):
I.1. Shpreh mendimin e vet me gojë ose me shkrim, apo në ndonjë formë tjetër të të shprehurit (simbole, kode, shenja dhe shprehje të tjera artistike), për një temë të caktuar që reflekton aspekte të përgatitjes akademike në arsimin e mesëm të lartë.
II.2. Krahason të paktën tri burime të ndryshme të informimit për trajtimin e temës së njëjtë, argumenton saktësinë, rrethanat, gjen ngjashmëritë dhe dallimet, duke u bazuar në kriteret e përcaktuara më parë, i prezanton gjetjet kryesore para të tjerëve në forma të ndryshme shprehëse, duke përdorur teknologjinë informative.
III.6. Shfrytëzon në mënyrë të pavarur dhe efektive teknologjinë informative dhe burime të tjera të informimit për të mbledhur materiale për zgjidhjen e një problemi apo detyre të caktuar, të cilat më pas i analizon, i klasifikon dhe i paraqet para të tjerëve përmes TIK-ut dhe ndonjë forme tjetër të shprehjes.
IV.3. Hulumton dhe shfrytëzon mundësitë relevante në dispozicion për zgjedhje të suksesshme të shkollimit të mëtejshëm apo për përgatitje profesionale dhe për këshillim në karrierë, duke përdorur me sukses njohuritë dhe shkathtësitë që i zotëron.
V.4. Ilustron me shembuj para të tjerëve modelet/praktikat e sjelljeve që reflektojnë mënyrat e mbrojtjes dhe të kultivimit të kulturës së vet, vlerave, besimeve dhe kulturave të të tjerëve në mjedisin ku jeton dhe me gjerë.
VI.7. Diskuton me të tjerët apo në një formë tjetër të të shprehurit paraqet interesin personal për çështje publike, shoqërore, historike, natyrore etj., dhe jep propozime për zgjidhjen e ndonjë problemi në komunitet e më gjerë në një fushë të caktuar.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):
3.1. Identifikon dhe elaboron me shkrim, me gojë ose me forma të tjera të prezantimit, rolin e artit dhe të zhvillimeve artistike në kontekstin kulturor dhe atë historik në periudhat e ndryshme të zhvillimit shoqëror.
3.2. Përcakton ndikimin e kontributit të individëve të shquar në artet e ndryshme të kulturave të ndryshme përgjatë historisë.
3.3. Përshkruan dhe kategorizon vepra të ndryshme të artit dhe objekte të trashëgimisë kulturore sipas periudhës historike, kulturës, stilit dhe artistit.
3.4. Njeh dhe krahason tradita të ndryshme artistike në periudha të ndryshme historike.</td></tr>
<tr><th colspan="4">Aspektet specifike të planit të orës mësimore</th></tr>
<tr><td colspan="4">Njësia mësimore: Arti grek</td></tr>
<tr><td colspan="4">Fjalët kyçe: Arti grek, stili gjeometrik, periudha arkaike, periudha klasike, periudha helene, arkitektura e tempullit, stilet arkitektonike, skulptura, teatri grek.</td></tr>
</table>

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore
Nxënësi/ja:
- **vëzhgon** vepra arti nga qytetërimi grek;
- **përshkruan, analizon, interpreton** dhe **vlerëson** vepra të artit grek me karakteristikat e zhvillimit të tij historik;
- **argumenton** dhe **komunikon** mendimin e tij mbi veprat e artit;
- **analizon** dhe **paraqet** informacionin e mbledhur në mënyrë individuale rreth miteve greke.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:
Arti figurativ kl. X, ilustrime me vepra arti dhe arkitekture nga qytetërimi grek

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:
Fusha: Shoqëria dhe mjedisi, Shkencat e natyrës, Gjuha dhe komunikimi, Jeta dhe puna, Njohja e kulturave

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: kujtesa pamore, bashkëbisedim
Nxënësit inkurajohen të diskutojnë mbi artin grek dhe shtrirjen e tij. Ata/ato diskutojnë mbi periudhat e e artit grek dhe mbi njohuritë që ata kanë marrë mbi këtë qytetërim antik në histori. Gjithashtu, ata diskutojnë për filozofë të shquar të kësaj periudhe dhe për vepra të njohura të letërsisë greke.
Ndërtimi i njohurive të reja: Kujtesa pamore, bisedë, hapat e kritikës (historisë) së artit
Mësuesi/ja shpjegon që trashëgimia e kulturës antike greke sot është pjesë domethënëse e gjithë qytetërimit perëndimor. Ajo shihet në parqe, ndërtesa e tempuj. Kjo trashëgimi vlerësohet nga rrënojat e mbetura, nga kopjet romake dhe nga burimet e shkruara të kohës, të cilat na japin edhe sot informacion mbi artistët dhe veprat e vlerësuara të asaj kohe.
Mësuesi/ja shpjegon periudhat e zhvillimit të artit dhe qytetërimit grek dhe karakteristikat e veçanta të çdo periudhe. Arkitektura është një nga çështjet që trajtohet në këtë temë mësimore. Mësuesi/ja shpjegon stilet arkitektonike dhe si u pasqyruan ato në arkitekturën e tempujve. Teatrot greke janë një pjesë e rëndësishme e arkitekturës së antikitetit dhe shfaqen me karakteristika specifike.
Nëpërmjet imazheve të skulpturës greke nxënësit/et identifikojnë edhe karakteristikat e paraqitjes së saj në periudhat e zhvillimit të artit grek. Ata/ato vlerësojnë skulpturën si një ndër shprehjet artistike më të arrira të artit antik grek.
Në rubrikën Lexim vepre: "Dorifori i Polikletit" nxënësit zbulojnë karakteristikat e përmasave ideale të bukurisë të trupit të njeriut. Ata/ato bëhen pjesë aktive e mësimit duke diskutuar dhe kujtuar njohuritë e marra mbi proporcionet e trupit të njeriut në temën mësimore "Trupi i njeriut" te tematika e parë. Gjithashtu krahasojnë kanunin grek me atë egjiptian.
Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: diskutimi
Në fund të orës nxënësit diskutojnë mbi argumentet e trajtuara gjatë mësimit: Për qytetërimin grek si një pjesë mjaft e rëndësishme e trashëgimisë kulturore botërore, për karakteristikat e arkitekturës dhe skulpturës, lidhjen e ngushtë mes tyre. Për pikturën e vazove, për kanunin e proporcioneve.

Vlerësimi i nxënësve

Vlerësimi i nxënësit do të fokusohet:
- në diskutimet që ata/ato bëjnë duke lidhur njohuritë me njësinë e re;
- në pjesëmarrjen e tyre aktive gjatë procesit mësimor;
- në **paraqitjen e** informacionit të mbledhur në mënyrë individuale.

Detyrat dhe puna e pavarur

Kërkim informacioni në mënyrë individuale (detyrë shtëpie)
"Mitet greke"
Nxënësit orientohen t**ë** b**ë**jn**ë** k**ë**rkime individuale sipas kërkesave të kësaj rubrike në libër dhe i sjellin në klasë.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 6

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Arte	**Lënda:** Arti figurativ	**Shkalla e kurrikulës:** V	**Klasa:** X
Relacioni art-shoqëri **Tema:** Histori arti		**Rezultati i të nxënit të temës** (nga plani dymujor): Njeh zhvillimet historike të artit dhe dallon periudha të ndryshme të artit. Përshkruan dhe dallon karakteristikat kryesore të periudhave historike të artit. Identifikon karakteristikat dalluese të veprave të njohura të artit në periudha të ndryshme historike. Debaton rreth periudhave të artit dhe veprave artistike duke përdorur një fjalor të pasur artistik. Analizon veprat e artit në kontekstin e tyre historik, duke i lidhur me ngjarjet e rëndësishme shoqërore e sociale. Identifikon zhvillimet e ndryshme shkencore, teknologjike, sociale, që ndikuan në zhvillimin e art.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.1. Shpreh mendimin e vet me gojë ose me shkrim, apo në ndonjë formë tjetër të të shprehurit (simbole, kode, shenja dhe shprehje të tjera artistike), për një temë të caktuar që reflekton aspekte të përgatitjes akademike në arsimin e mesëm të lartë. II.2. Krahason të paktën tri burime të ndryshme të informimit për trajtimin e temës së njëjtë, argumenton saktësinë, rrethanat, gjen ngjashmëritë dhe dallimet, duke u bazuar në kriteret e përcaktuara më parë, i prezanton gjetjet kryesore para të tjerëve në forma të ndryshme shprehëse, duke përdorur teknologjinë informative. III.6. Shfrytëzon në mënyrë të pavarur dhe efektive teknologjinë informative dhe burime të tjera të informimit për të mbledhur materiale për zgjidhjen e një problemi apo detyre të caktuar, të cilat më pas i analizon, i klasifikon dhe i paraqet para të tjerëve përmes TIK-ut dhe ndonjë forme tjetër të shprehjes. IV.3. Hulumton dhe shfrytëzon mundësitë relevante në dispozicion për zgjedhje të suksesshme të shkollimit të mëtejshëm apo për përgatitje profesionale dhe për këshillim në karrierë, duke përdorur me sukses njohuritë dhe shkathtësitë që i zotëron. V.4. Ilustron me shembuj para të tjerëve modelet/praktikat e sjelljeve që reflektojnë mënyrat e mbrojtjes dhe të kultivimit të kulturës së vet, vlerave, besimeve dhe kulturave të të tjerëve në mjedisin ku jeton dhe më gjerë. VI.7. Diskuton me të tjerët apo në një formë tjetër të të shprehurit paraqet interesin personal për çështje publike, shoqërore, historike, natyrore etj., dhe jep propozime për zgjidhjen e ndonjë problemi në komunitet e më gjerë në një fushë të caktuar.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 3.1. Identifikon dhe elaboron me shkrim, me gojë ose me forma të tjera të prezantimit, rolin e artit dhe të zhvillimeve artistike në kontekstin kulturor dhe atë historik në periudhat e ndryshme të zhvillimit shoqëror. 3.2. Përcakton ndikimin e kontributit të individëve të shquar në artet e ndryshme të kulturave të ndryshme përgjatë historisë. 3.3. Përshkruan dhe kategorizon vepra të ndryshme të artit dhe objekte të trashëgimisë kulturore sipas periudhës historike, kulturës, stilit dhe artistit. 3.4. Njeh dhe krahason tradita të ndryshme artistike në periudha të ndryshme historike.			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore: Arti romak			
Fjalët kyçe: Arti romak, arkitektura romake, piktura dhe skulptura romake, mozaiku, afresku, eunkasto.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: - **vëzhgon** vepra të ndryshme nga arti romak; - **përshkruan, analizon, interpreton** dhe **vlerëson** veprat e artit romak me karakteristikat e zhvillimit të tij historik;			

- **argumenton** dhe **komunikon** mendimin e tij mbi veprat e artit;
- **analizon** dhe **paraqet** informacionin e mbledhur në mënyrë individuale rreth mozaikut romak.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:
Arti figurativ kl. X, ilustrime me vepra arti dhe arkitekture nga qytetërimi romak

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:
Fusha: Shoqëria dhe mjedisi, Shkencat e natyrës, Gjuha dhe komunikimi, Jeta dhe puna, Njohja e kulturave

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Kujtesa pamore, bashkëbisedim
Nxënësit/et inkurajohen të diskutojnë mbi qytetërimin romak dhe shtrirjen e tij. Ata/ato diskutojnë mbi karakteristikat e qytetërimit romak dhe mbi njohuritë që ata kanë marrë mbi këtë qytetërim antik në histori. Nëpërmjet imazheve të ndryshme të arkitekturës romake ata/diskutojnë për rëndësinë e madhe që pati ky qytetërim në historinë e njerëzimit.

Ndërtimi i njohurive të reja: Kujtesa pamore, bisedë, hapat e kritikës (historisë)së artit
Mësuesi/ja shpjegon se shprehja artistike e Romës antike është e lidhur ngushtë me mjedisin politik, social dhe fetar të qytetit, që nga periudha e rreptë republikane (nga viti 510 p.e.r. deri në vitin 30 p.e.r.) e deri te ajo perandorake në të cilin pushtimet romake kishin kaluar çdo kufi (nga viti 30 p.e.r. deri në vitin 476 e.r.).
Mësuesi/ja shpjegon se pavarësisht dy ndikimeve kryesore që pati arti romak atë etrus dhe atë grek, ai u zhvillua me karakteristikat e tij të veçanta.
Arkitektura romake është një nga çështjet që trajtohet në këtë temë mësimore. Mësuesi/ja shpjegon se si u pasqyruan këto ndikime në arkitekturën romake dhe elementet e reja të arkitekturës romake. Imazhet e Koloseut dhe panteonit tregojnë për përdorimin e këtyre elementeve të rinj. Shembuj të skulpturës karakteristike romake janë harqet e triumfit dhe kolonat.
Skulptura romake u shqua edhe për trajtimin realist të portretit, të cilën e shohim qartë në shembujt e shumtë. Kjo traditë realiste shoqëroi edhe portretin në pikturë. Shembuj të pikturës romake dhe teknikave të saj piktorike janë pikturat e gjetura kryesisht në vilat e Pompeit.
Në rubrikën Lexim vepre: "Portretet e mumieve në Fajum", nxënësit zbulojnë karakteristikat realiste të portretit të njeriut. Ata/ato bëhen pjesë aktive e mësimit duke diskutuar dhe kujtuar njohuritë e marra mbi historikun e portretit në temën mësimore "portreti" te tematika e parë. Gjithashtu krahasojnë portretin romak me atë grek dhe me atë egjiptian.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: diskutimi
Në fund të orës, nxënësit diskutojnë mbi argumentet e trajtuara gjatë mësimit: Për shtrirjen që pati qytetërimi romak si pjesë mjaft e rëndësishme e trashëgimisë kulturore botërore, për karakteristikat e arkitekturës dhe skulpturës, për pikturën dhe mozaikun romak.

Vlerësimi i nxënësve

Vlerësimi i nxënësit do të fokusohet:
- në diskutimet që ata/ato bëjnë duke lidhur njohuritë me njësinë e re;
- në pjesëmarrjen e tyre aktive gjatë procesit mësimor;
- në **paraqitjen e** informacionit të mbledhur në mënyrë individuale.

Detyrat dhe puna e pavarur

Kërkim informacioni në mënyrë individuale (detyrë shtëpie)
"Mozaiku"
Nxënësit orientohen **të bëjnë kërkime** individuale sipas kërkesave të kësaj rubrike në libër dhe i sjellin në klasë.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 7

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Arte	**Lënda:** Arti figurativ	**Shkalla e kurrikulës:** V	**Klasa:** X
Relacioni art-shoqëri **Tema:** Histori arti		**Rezultati i të nxënit të temës** (nga plani dymujor): Njeh zhvillimet historike të artit dhe dallon periudha të ndryshme të artit. Përshkruan dhe dallon karakteristikat kryesore të periudhave historike të artit. Identifikon karakteristikat dalluese të veprave të njohura të artit në periudha të ndryshme historike. Debaton rreth periudhave të artit dhe veprave artistike duke përdorur një fjalor të pasur artistik. Përshkruan dhe vlerëson vepra arti dhe objekte të trashëgimisë kulturore të trojeve shqiptare.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.1. Shpreh mendimin e vet me gojë ose me shkrim, apo në ndonjë formë tjetër të të shprehurit (simbole, kode, shenja dhe shprehje të tjera artistike), për një temë të caktuar që reflekton aspekte të përgatitjes akademike në arsimin e mesëm të lartë. II.2. Krahason të paktën tri burime të ndryshme të informimit për trajtimin e temës së njëjtë, argumenton saktësinë, rrethanat, gjen ngjashmëritë dhe dallimet, duke u bazuar në kriteret e përcaktuara më parë, i prezanton gjetjet kryesore para të tjerëve në forma të ndryshme shprehëse, duke përdorur teknologjinë informative. III.6. Shfrytëzon në mënyrë të pavarur dhe efektive teknologjinë informative dhe burime të tjera të informimit për të mbledhur materiale për zgjidhjen e një problemi apo detyre të caktuar, të cilat më pas i analizon, i klasifikon dhe i paraqet para të tjerëve përmes TIK-ut dhe ndonjë forme tjetër të shprehjes. IV.3. Hulumton dhe shfrytëzon mundësitë relevante në dispozicion për zgjedhje të suksesshme të shkollimit të mëtejshëm apo për përgatitje profesionale dhe për këshillim në karrierë, duke përdorur me sukses njohuritë dhe shkathtësitë që i zotëron. V.4. Ilustron me shembuj para të tjerëve modelet/praktikat e sjelljeve që reflektojnë mënyrat e mbrojtjes dhe të kultivimit të kulturës së vet, vlerave, besimeve dhe kulturave të të tjerëve në mjedisin ku jeton dhe më gjerë. VI.7. Diskuton me të tjerët apo në një formë tjetër të të shprehurit paraqet interesin personal për çështje publike, shoqërore, historike, natyrore etj., dhe jep propozime për zgjidhjen e ndonjë problemi në komunitet e më gjerë në një fushë të caktuar.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 3.1. Identifikon dhe elaboron me shkrim, me gojë ose me forma të tjera të prezantimit, rolin e artit dhe të zhvillimeve artistike në kontekstin kulturor dhe atë historik në periudhat e ndryshme të zhvillimit shoqëror. 3.3. Përshkruan dhe kategorizon vepra të ndryshme të artit dhe objekte të trashëgimisë kulturore sipas periudhës historike, kulturës, stilit dhe artistit. 3.4. Njeh dhe krahason tradita të ndryshme artistike në periudha të ndryshme historike.			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore: Dardania në periudhën romake			
Fjalët kyçe: Municipium d.d, Municipium Ulpiana, arkitektura, skulptura, mozaiku			

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore
Nxënësi/ja:

- **vëzhgon** imazhe të ndryshme nga vendbanimet e periudhës romake **në** Dardani;
- **përshkruan, analizon, interpreton** dhe **vlerëson** veprat e artit të zbuluara në Dardani në periudhën romake;
- **argumenton** dhe **komunikon** mendimin e tij mbi veprat e artit;
- **analizon** dhe **paraqet** informacionin e mbledhur në mënyrë individuale rreth parqeve arkeologjike më të rëndësishme në trojet shqiptare.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:
Arti figurativ kl. X, ilustrime të vendbanimeve dhe të veprave artistikë të periudhës romake në Dardani

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:
Fusha: Shoqëria dhe mjedisi, Shkencat e natyrës, Gjuha dhe komunikimi, Jeta dhe puna, Njohja e kulturave

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: kujtesa pamore, bashkëbisedim
Në mësimin e historisë, nxënësit janë njohur me shtrirjen e qytetërimit romak në pjesën perëndimore të gadishullit Ballkanik ku jetonin fiset ilire. Romakët shtrinë sistemin e tyre administrativ edhe në Dardani. Mësuesi/ja shfaq imazhe dhe pyet nxënësit: Cilat janë qendrat urbane që lulëzuan në periudhën romake në Kosovë? Çfarë dini ju për to? A keni vizituar ndonjërën prej tyre?
Ndërtimi i njohurive të reja: Kujtesa pamore, bisedë, hapat e kritikës (historisë) së artit
Mësuesi/ja shpjegon se Provinca e e Dardanisë në periudhën romake njihte qendra urbane si Scupi, Ulpiana, Naissusi, Municipium Dardanorum, organizuar në "Castella" (kështjella) dhe "Opida" (qyteza). Karakteristikë e këtyre vendbanimeve të periudhës romake është se ato i kanë rrënjët që në prehistori. Mësuesi/shpjegon edhe zbulimet që janë bërë aty si: forumi, horea, termat dhe bazilika urbana.
Njëra nga qendrat më interesante arkeologjike në Kosovë dhe rajonin e gjerë të Gadishullit Ilirik, mbetet lokaliteti antik romak dhe bizantin i Ulpianës (themeluar në vitin 169 e. s.).
Gjetjet në skulpturë dhe mozaik janë pjesë e këtyre njohurive.
Në rubrikën Lexim vepre: "Menada e Prizrenit", nxënësit zbulojnë figurën e një atleteje në vrapim. Ky objekt gjendet e ekspozuar në Muzeun Britanik të Londrës që nga viti 1876 dhe mendohet të jetë artefakt i importuar nga qytetërimi grek.
Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: diskutimi
Në fund të orës, nxënësit diskutojnë mbi argumentet e trajtuara gjatë mësimit: Për vendbanimet e periudhës romake të gjetura në Kosovë, për karakteristikat e tyre, të skulpturës dhe mozaikut.

Vlerësimi i nxënësve

Vlerësimi i nxënësit do të fokusohet

- në diskutimet që ata/ato bëjnë duke lidhur njohuritë me njësinë e re;
- në pjesëmarrjen e tyre aktive gjatë procesit mësimor;
- në **paraqitjen e** informacionit të mbledhur në mënyrë individuale.

Detyrat dhe puna e pavarur

Kërkim informacioni në mënyrë individuale (detyrë shtëpie)
Nxënësit orientohen **të bëjnë kërkime** individuale sipas kërkesave të kësaj rubrike në libër mbi parqet arkeologjike dhe i sjellin **për** t'i prezantuar në klasë.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 8

<table>
<tr><th colspan="4">Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore</th></tr>
<tr><td>Fusha kurrikulare: Arte</td><td>Lënda: Arti figurativ</td><td>Shkalla e kurrikulës: V</td><td>Klasa: X</td></tr>
<tr><td colspan="2">Relacioni art-shoqëri
Tema: Histori arti</td><td colspan="2">Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor):
Njeh zhvillimet historike të artit dhe dallon periudha të ndryshme të artit.
Përshkruan dhe dallon karakteristikat kryesore të periudhave historike të artit.
Identifikon karakteristikat dalluese të veprave të njohura të artit në periudha të ndryshme historike.
Debaton rreth periudhave të artit dhe veprave artistike duke përdorur një fjalor të pasur artistik.
Analizon veprat e artit në kontekstin e tyre historik, duke i lidhur me ngjarjet e rëndësishme shoqërore e sociale.
Identifikon zhvillimet e ndryshme shkencore, teknologjike, sociale, që ndikuan në zhvillimin e art.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):
I.1.Shpreh mendimin e vet me gojë ose me shkrim, apo në ndonjë formë tjetër të të shprehurit (simbole, kode, shenja dhe shprehje të tjera artistike), për një temë të caktuar që reflekton aspekte të përgatitjes akademike në arsimin e mesëm të lartë.
II.2.Krahason të paktën tri burime të ndryshme të informimit për trajtimin e temës së njëjtë, argumenton saktësinë, rrethanat, gjen ngjashmëritë dhe dallimet, duke u bazuar në kriteret e përcaktuara më parë, i prezanton gjetjet kryesore para të tjerëve në forma të ndryshme shprehëse, duke përdorur teknologjinë informative.
III.6.Shfrytëzon në mënyrë të pavarur dhe efektive teknologjinë informative dhe burime të tjera të informimit për të mbledhur materiale për zgjidhjen e një problemi apo detyre të caktuar, të cilat më pas i analizon, i klasifikon dhe i paraqet para të tjerëve përmes TIK-ut dhe ndonjë forme tjetër të shprehjes.
IV.3. Hulumton dhe shfrytëzon mundësitë relevante në dispozicion për zgjedhje të suksesshme të shkollimit të mëtejshëm apo për përgatitje profesionale dhe për këshillim në karrierë, duke përdorur me sukses njohuritë dhe shkathtësitë që i zotëron.
V.4. Ilustron me shembuj para të tjerëve modelet/praktikat e sjelljeve që reflektojnë mënyrat e mbrojtjes dhe të kultivimit të kulturës së vet, vlerave, besimeve dhe kulturave të të tjerëve në mjedisin ku jeton dhe më gjerë.
VI.7. Diskuton me të tjerët apo në një formë tjetër të të shprehurit paraqet interesin personal për çështje publike, shoqërore, historike, natyrore etj., dhe jep propozime për zgjidhjen e ndonjë problemi në komunitet e më gjerë në një fushë të caktuar.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):
3.1. Identifikon dhe elaboron me shkrim, me gojë ose me forma të tjera të prezantimit, rolin e artit dhe të zhvillimeve artistike në kontekstin kulturor dhe atë historik në periudhat e ndryshme të zhvillimit shoqëror;
3.3. Përshkruan dhe kategorizon vepra të ndryshme të artit dhe objekte të trashëgimisë kulturore sipas periudhës historike, kulturës, stilit dhe artistit.
3.4. Njeh dhe krahason tradita të ndryshme artistike në periudha të ndryshme historike.</td></tr>
<tr><th colspan="4">Aspektet specifike të planit të orës mësimore</th></tr>
<tr><td colspan="4">Njësia mësimore: Arti islam</td></tr>
<tr><td colspan="4">Fjalët kyçe: arti islam, arkitektura, arabeska, kaligrafi, dekoracion</td></tr>
</table>

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore
Nxënësi/ja:
- **vëzhgon** vepra të ndryshme nga arti islam;
- **përshkruan, analizon, interpreton** dhe **vlerëson** veprat e artit islam me karakteristikat e zhvillimit të tij historik;
- **argumenton** dhe **komunikon** mendimin e tij mbi veprat e artit;
- **analizon** dhe **paraqet** informacionin e mbledhur në mënyrë individuale rreth dekoracionit gjeometrik islam.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Arti figurativ kl. X, ilustrime me vepra arti dhe arkitekture nga arti islam.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:
Fusha: Shoqëria dhe mjedisi, Shkencat e natyrës, Gjuha dhe komunikimi, Jeta dhe puna, Njohja e kulturave

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: kujtesa pamore, bashkëbisedim
Mësuesi/ja orienton nxënësit të vëzhgojnë imazhe të arkitekturës islame (xhami me vlera estetike) dhe dekoracioneve rreth artit islam dhe i diskutojnë. Nxënësit japin shembuj që njohin rreth kësaj arkitekture dhe arti dekorativ dhe identifikojnë arkitekturën e xhamive pranë vendeve të tyre të banimit.
Ndërtimi i njohurive të reja: Kujtesa pamore, bisedë, hapat e kritikës (historisë) së artit
Mësuesi/ja shpjegon ku lindi, kur dhe si u përhap arti islam. Mësuesi/ja shpjegon karakteristikat e arkitekturës dhe të qytetit islam dhe rëndësinë e xhamisë në këtë qytet. Po ashtu, edhe për ndarjen e pushteteve dhe shtresat shoqërore.
Mësuesi/ja shpjegon që arti islam ka një gjuhë dekorative dhe abstrakte, gjë që lidhet me mendimin islam. Sipas këtij mendimi, arti nuk duhet të imitojë natyrën, pasi do të ndryshonte veprën e krijuar nga Zot. Në këtë mënyrë filloi të mbizotërojë prirja për të paraqitur imazhe të stilizuara dhe abstrakte. Imazhet shoqërojnë shpjegimin e këtyre njohurive. Nëpërmjet shembujve të ndryshëm nxënësit njihen kryesisht me arkitekturën e xhamive që përbëjnë edhe vlera të trashëgimisë kulturore dhe karakteristikat e tyre.
Nxënësit ftohen të vëzhgojnë disa shembuj të kaligrafisë si një shembull shumë interesant të artit islam, përdorimet e saj edhe në dekorimin e arkitekturës. Shembujt e arkitekturës islame tregojnë edhe për përhapjen e artit islam në vende të tjera.
Në rubrikën Lexim vepre: "Taxh Mahal" një nga mrekullitë e botës në arkitekturë, nxënësit zbulojnë dhe analizojnë karakteristikat më të spikatura të arkitekturës islame.
Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: diskutimi
Në fund të orës, nxënësit diskutojnë mbi argumentet e trajtuara gjatë mësimit: Për karakteristikat e artit islam, për marrëdhënien që krijon me natyrën dhe me figurën e njeriut, për arkitekturën, dekorimet, kaligrafinë.

Vlerësimi i nxënësve

Vlerësimi i nxënësit do të fokusohet
- në diskutimet që ata/ato bëjnë duke lidhur njohuritë me njësinë e re;
- në pjesëmarrjen e tyre aktive gjatë procesit mësimor;
- në **paraqitjen e** informacionit të mbledhur në mënyrë individuale.

Detyrat dhe puna e pavarur

Kërkim informacioni në mënyrë individuale (detyrë shtëpie)
"Dekoracioni gjeometrik islam"
Nxënësit orientohen të bëjnë kërkime individuale mbi dekorimet me forma të pastra gjeometrike të artit islam sipas kërkesave të kësaj rubrike në libër dhe i sjellin në klasë për t'i prezantuar.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 9

<table>
<tr><th colspan="4">Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore</th></tr>
<tr><td>Fusha kurrikulare: Arte</td><td>Lënda: Arti figurativ</td><td>Shkalla e kurrikulës: V</td><td>Klasa: X</td></tr>
<tr><td colspan="2">Relacioni art-shoqëri
Tema: Histori arti</td><td colspan="2">Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor):
Njeh zhvillimet historike të artit dhe dallon periudha të ndryshme të artit.
Përshkruan dhe dallon karakteristikat kryesore të periudhave historike të artit.
Identifikon karakteristikat dalluese të veprave të njohura të artit në periudha të ndryshme historike.
Debaton rreth periudhave të artit dhe veprave artistike duke përdorur një fjalor të pasur artistik.
Analizon veprat e artit në kontekstin e tyre historik, duke i lidhur me ngjarjet e rëndësishme shoqërore e sociale.
Identifikon zhvillimet e ndryshme shkencore, teknologjike, sociale, që ndikuan në zhvillimin e art.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):
I.1. Shpreh mendimin e vet me gojë ose me shkrim, apo në ndonjë formë tjetër të të shprehurit (simbole, kode, shenja dhe shprehje të tjera artistike), për një temë të caktuar që reflekton aspekte të përgatitjes akademike në arsimin e mesëm të lartë.
II.2. Krahason të paktën tri burime të ndryshme të informimit për trajtimin e temës së njëjtë, argumenton saktësinë, rrethanat, gjen ngjashmëritë dhe dallimet, duke u bazuar në kriteret e përcaktuara më parë, i prezanton gjetjet kryesore para të tjerëve në forma të ndryshme shprehëse, duke përdorur teknologjinë informative.
III.6. Shfrytëzon në mënyrë të pavarur dhe efektive teknologjinë informative dhe burime të tjera të informimit për të mbledhur materiale për zgjidhjen e një problemi apo detyre të caktuar, të cilat më pas i analizon, i klasifikon dhe i paraqet para të tjerëve përmes TIK-ut dhe ndonjë forme tjetër të shprehjes.
IV.3. Hulumton dhe shfrytëzon mundësitë relevante në dispozicion për zgjedhje të suksesshme të shkollimit të mëtejshëm apo për përgatitje profesionale dhe për këshillim në karrierë, duke përdorur me sukses njohuritë dhe shkathtësitë që i zotëron.
V.4. Ilustron me shembuj para të tjerëve modelet/praktikat e sjelljeve që reflektojnë mënyrat e mbrojtjes dhe të kultivimit të kulturës së vet, vlerave, besimeve dhe kulturave të të tjerëve në mjedisin ku jeton dhe më gjerë.
VI.7. Diskuton me të tjerët apo në një formë tjetër të të shprehurit paraqet interesin personal për çështje publike, shoqërore, historike, natyrore etj., dhe jep propozime për zgjidhjen e ndonjë problemi në komunitet e më gjerë në një fushë të caktuar.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):
3.1. Identifkon dhe elaboron me shkrim, me gojë ose me forma të tjera të prezantimit, rolin e artit dhe të zhvillimeve artistike në kontekstin kulturor dhe atë historik në periudhat e ndryshme të zhvillimit shoqëror.
3.2. Përcakton ndikimin e kontributit të individëve të shquar në artet e ndryshme të kulturave të ndryshme përgjatë historisë.
3.3. Përshkruajnë dhe kategorizojnë vepra të ndryshme të artit dhe objekte të trashëgimisë kulturore sipas periudhës historike, kulturës, stilit dhe artistit.
3.4. Njeh dhe krahason tradita të ndryshme artistike në periudha të ndryshme historike.</td></tr>
<tr><th colspan="4">Aspektet specifike të planit të orës mësimore</th></tr>
<tr><td colspan="4">Njësia mësimore: Arti gotik</td></tr>
<tr><td colspan="4">Fjalët kyçe: Arti gotik, arkitektura gotike, katedralet, skulptura, piktura</td></tr>
</table>

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore
Nxënësi/ja:
- **vëzhgon** vepra të ndryshme nga arti gotik;
- **përshkruan, analizon, interpreton** dhe **vlerëson** veprat e artit gotik me karakteristikat e zhvillimit të tij historik;
- **argumenton** dhe **komunikon** mendimin e tij mbi veprat e artit;
- **analizon** dhe **paraqet** informacionin e mbledhur në mënyrë individuale rreth rozetave gotike.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Arti figurativ kl. X, ilustrime me vepra nga arti gotik.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:
Fusha: Shoqëria dhe mjedisi, Shkencat e natyrës, Gjuha dhe komunikimi, Jeta dhe puna, Njohja e kulturave

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: kujtesa pamore, bashkëbisedim
Njohuritë mbi mesjetën nga lënda e historisë, shërbejnë për të nxitur bisedën me nxënësit këtë temë mësimore. Nxënësit/et diskutojnë për karakteristikat historike të kësaj periudhe në Evropë.
Ndërtimi i njohurive të reja: Kujtesa pamore, bisedë, hapat e kritikës (historisë) së artit
Mësuesi/ja shpjegon se stili gotik do të shtrihej në pjesën më të madhe të Evropës perëndimore në mesin e shekullit XVI. Termi "gotik" gjeti qartësi më të madhe stilistike në gjininë e arkitekturës edhe pse deri në vitet 1450 periudha stilistike e të gjithë zhanreve, në historinë e artit, njihet nën emrin e artit gotik.
Nëpërmjet imazheve të Katedrales së shën Denisit dhe Notre Dam, mësuesi/ja shpjegon karakteristikat e arkitekturës gotike.
Mësuesi/ja nëpërmjet shembujve shpjegon se skulptura gotike më shumë mund të shihet si një element dekorativ i pamjeve ballore të katedraleve të shumta që u ndërtuan në ato vite. Në shumicën e rasteve, ato ideoheshin nga vetë arkitektët si pjesë integruese e planit të përgjithshëm arkitektonik.
Ndërsa Piktura gotike gjeti shprehjen e saj më të mirë në realizimet e vetratave shumëngjyrëshe të katedraleve, apo në kodikët e kohës, ndërsa në Itali do të vinte një brez i ri artistësh që do të ndryshonte të gjithë rrugëtimin e artit perëndimor.
Në rubrikën Lexim vepre: "**Xhoto dhe konceptimi i ri i realitetit**", **mësuesi/ja shpjegon karakteristikat e pikturës së** Xhotos **nëpërmjet imazhit të** afreskut të tij në kapelën Skrovenji. Kjo vepër përbën njëkohësisht testamentin piktorik të artistit si dhe fillimin e rrugës së re të artit perëndimor.
Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: diskutimi
Në fund të orës nxënësit diskutojnë mbi argumentet e trajtuara gjatë mësimit: Për shtrirjen që pati arti gotik, karakteristikat e arkitekturës dhe të skulpturës, marrëdhënien që krijonin të dyja; pikturën gotike dhe karakteristikat e pikturës së Xhotos.

Vlerësimi i nxënësve

Vlerësimi i nxënësit do të fokusohet:
- në diskutimet që ata/ato bëjnë duke lidhur njohuritë me njësinë e re;
- në pjesëmarrjen e tyre aktive gjatë procesit mësimor;
- në **paraqitjen e** informacionit të mbledhur në mënyrë individuale.

Detyrat dhe puna e pavarur

Kërkim informacioni në mënyrë individuale (detyrë shtëpie)
"Rozetat"
Nxënësit orientohen **të bëjnë kërkime** individuale sipas kërkesave të kësaj rubrike në libër dhe i sjellin në klasë.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 10

<table>
<tr><th colspan="4">Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore</th></tr>
<tr><td>Fusha kurrikulare: Arte</td><td>Lënda: Arti figurativ</td><td>Shkalla e kurrikulës: V</td><td>Klasa: X</td></tr>
<tr><td colspan="2">Relacioni art-shoqëri
Tema: Vizita dhe ngjarje artistike</td><td colspan="2">Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor):
Viziton atelie dhe studio të artistëve, dhe ndanë eksperiencat me artistët profesionistë.
Viziton institucione të ndryshme të artit si muze, galeri, qendra kulturore, vizita virtuale në internet në faqe të ndryshme etj.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):
I.1. Shpreh mendimin e vet me gojë ose me shkrim, apo në ndonjë formë tjetër të të shprehurit (simbole, kode, shenja dhe shprehje të tjera artistike), për një temë të caktuar që reflekton aspekte të përgatitjes akademike në arsimin e mesëm të lartë.
II.1. Prezanton mënyrën e grumbullimit, të zgjedhjes dhe të klasifikimit të informatave për fusha të ndryshme mësimore apo për një temë të caktuar, ofron argumente për zhvillimet aktuale lidhur me temën përkatëse (p.sh., temë nga shkenca, kultura, arti, sporti, shëndetësia, shoqëria, mjedisi etj.).
III.3. Parashtron pyetje dhe shfaq mendime të strukturuara për zgjidhjen e një problemi apo detyre të një teme të caktuar, bën përmbledhjen e së paku dy veprimeve të përdorura të cilat përcaktojnë drejtimin e mëtejmë të të nxënit të vet për temën apo problemin e caktuar.
IV.3. Hulumton dhe shfrytëzon mundësitë relevante në dispozicion për zgjedhje të suksesshme të shkollimit të mëtejshëm apo për përgatitje profesionale dhe për këshillim në karrierë, duke përdorur me sukses njohuritë dhe shkathtësitë që i zotëron.
V.4. Ilustron me shembuj para të tjerëve modelet/praktikat e sjelljeve që reflektojnë mënyrat e mbrojtjes dhe të kultivimit të kulturës së vet, vlerave, besimeve dhe kulturave të të tjerëve në mjedisin ku jeton dhe me gjerë.
VI.7. Diskuton me të tjerët apo në një formë tjetër të të shprehurit paraqet interesin personal për çështje publike, shoqërore, historike, natyrore etj., dhe jep propozime për zgjidhjen e ndonjë problemi në komunitet e më gjerë në një fushë të caktuar.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):
3.1. Identifikon dhe elaboron me shkrim, me gojë ose me forma të tjera të prezantimit, rolin e artit dhe të zhvillimeve artistike në kontekstin kulturor dhe atë historik në periudhat e ndryshme të zhvillimit shoqëror.
3.2. Përcakton ndikimin e kontributit të individëve të shquar në artet e ndryshme të kulturave të ndryshme përgjatë historisë.
3.3. Përshkruan dhe kategorizon vepra të ndryshme të artit dhe objekte të trashëgimisë kulturore sipas periudhës historike, kulturës, stilit dhe artistit
3.4. Njeh dhe krahason tradita të ndryshme artistike në periudha të ndryshme historike.</td></tr>
<tr><th colspan="4">Aspektet specifike të planit të orës mësimore</th></tr>
<tr><td colspan="4">Njësia mësimore: Muzetë dhe galeritë e artit (Ose vizita në muze)</td></tr>
<tr><td colspan="4">Fjalët kyçe: Muze, galeri arti, konservimi dhe restaurimi, kuratori.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore
Nxënësi/ja:
- vëzhgon imazhe nga muze dhe galeri të ndryshme arti;
- përshkruan, analizon qëllimin dhe kategoritë e muzeut;
- argumenton dhe komunikon mendimin e tij rëndësinë e muzeut në edukimin artistik;
- analizon dhe paraqet informacionin e mbledhur në mënyrë individuale rreth restaurimit dhe konservimit të veprave të artit.</td></tr>
</table>

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Arti figurativ kl. X, ilustrime me vepra nga arti gotik.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:
Fusha: Shoqëria dhe mjedisi, Shkencat e natyrës, Gjuha dhe komunikimi, Jeta dhe puna, Njohja e kulturave

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Kujtesa pamore, bashkëbisedim
Nëpërmjet imazheve të hapësirave të brendshme të ekspozimit në muze dhe galeri arti, mësuesi/ja i nxit nxënësit të diskutojnë mbi njohuritë që ata kanë. Çfarë është muzeu i artit? Përse shërben muzeu? Cili është qëllimi i muzeut? Cilat janë llojet e muzeumeve? Këto janë disa nga çështjet për të cilat nxënësit diskutojnë.

Ndërtimi i njohurive të reja: Kujtesa pamore, harta e të **pyeturit, bised**ë
Mbas bisedës me nxënësit mbi çështjet e ngritura, mësuesi/ja i rimer për t'iu dhënë përkufizimin e saktë. Mësuesi/ja thekson se çdo muze ka një fond të veçantë ku i ruan objektet dhe një pjesë të tyre e ekspozon për publikun, ndërsa galeritë janë hapësira më specifike ku ekspozohet kryesisht produkti artistik. Ekspozimi mund të bëhet në ambiente të brendshme ashtu edhe të jashtme.
Muzetë dhe galeritë e artit mund të ekspozojnë vepra të periudhave të ndryshme historike, por edhe ato të një autori të vetëm.
Në çështjen e parë trajtohet "**Çfarë ekspozohet në to?". Mësuesi/ja shpjegon se m**uzetë e artit, ashtu si dhe galeritë përqendrohen kryesisht në ekspozimin e objekteve artistike.
Në çështjen e dytë trajtohet qëllimi i muzeve dhe galerive të artit që është të promovojë kulturën dhe artin nëpërmjet ekspozimit për publikun, por edhe të nxjerrë fitim prej tij. Pjesë e diskutimit janë edhe kategoritë e muzeve dhe galerive dhe bazat mbi të cilat bëhet ky kategorizim.
Në çështjen e tretë trajtohen "Pjesët përbërëse të një galerie apo muzeu". Mësuesi/ja shpjegon se ato ndryshojnë në varësi të specifikës së vetë institucionit dhe përmend pjesët përbërëse duke shpjeguar edhe rolin e tyre.
Në çështjen e katërt, "Muzetë dhe galeritë më të mëdha më të vizituara sot në botë", nxënësit zbulojnë muzetë më të frekuentuar në botë dhe më të famshmit prej tyre.
Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Diskutimi
Në fund të orës, nxënësit diskutojnë mbi rolin edukues të muzeut, detyrat e tyre në realizimin e rolit edukues të muzeut.

Vlerësimi i nxënësve

Vlerësimi i nxënësit do të fokusohet:
- në diskutimet që ata/ato bëjnë duke lidhur njohuritë me temën e re;
- në pjesëmarrjen e tyre aktive gjatë procesit mësimor;
- në **paraqitjen e** informacionit të mbledhur në mënyrë individuale.

Detyrat dhe puna e pavarur

Kërkim informacioni në mënyrë individuale (detyrë shtëpie)
"Restaurimi i veprave te artit"
Nxënësit orientohen t**ë bëjnë kë**rkime individuale sipas kërkesave të kësaj rubrike në libër dhe i sjellin në klasë.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 11

<table>
<tr><th colspan="4">Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore</th></tr>
<tr><td>Fusha kurrikulare: Arte</td><td>Lënda: Arti figurativ</td><td>Shkalla e kurrikulës: V</td><td>Klasa: X</td></tr>
<tr><td colspan="2">Relacioni art-shoqëri
Tema: Ekspozita dhe aktivitete kulturore</td><td colspan="2">Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor):
Merr pjesë në ekspozita e projekte artistike në klasë, shkollë e komunitet.
Merr pjesë në ligjërata dhe takime me artistë, kuratorë, estetë, filozofë të artit, seminare dhe ngjarje tjera të artit.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):
I.3. Diskuton në mënyrë konstruktive (në gjuhë amtare dhe/ose në një gjuhë të huaj) me moshatarët dhe të rriturit për tema me interes mësimor, shoqëror ose nga jeta e përditshme, duke bërë pyetje, përgjigje dhe duke veçuar informacionin kryesor.
II.7. Prezanton me sukses rezultatet e punës së një detyre eksperimentale për një temë të caktuar nga ndonjë fushë mësimore (p.sh., nga shkencat, teknologjia etj.) të realizuar në laborator ose në punëtori të shkollës apo diku tjetër, përmes përdorimit të teknologjisë informative, jep argumente që lidhin rezultatet e punës eksperimentale me udhëzimet teorike.
III.1. Demonstron shkathtësi funksionale në lexim-shkrim, në matematikë, në jetën e përditshme, në përmbushjen e kërkesave të ndryshme për kryerjen e një detyre apo aktiviteti dhe gjatë të nxënit të dijeve të reja në ndonjë fushë të caktuar mësimore.
IV.4. Demonstron shkathtësi organizative për punë ekipore në situata ku kërkohet të kontribuojnë si ekip në realizimin e detyrave të veçanta mësimore, apo në kryerjen e ndonjë hulumtimi që kontribuon për jetë, për punë dhe për mjedis (p.sh., organizimin e punës ekipore për hulumtimin e shkaktarëve që e dëmtojnë biodiversitetin e bimëve dhe të shtazëve, për dhënien e propozimeve lidhur me mbrojtjen e tyre dhe prezantimin para të tjerëve etj.).
V.4. Ilustron me shembuj para të tjerëve modelet/praktikat e sjelljeve që reflektojnë mënyrat e mbrojtjes dhe të kultivimit të kulturës së vet, vlerave, besimeve dhe kulturave të të tjerëve në mjedisin ku jeton dhe më gjerë.
VI.1. Përshkruan dhe shpjegon të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e individit në raste të ndryshme, si: në shtëpi, në klasë, në shkollë, në shoqëri, dallon rastet kur hyjnë në konflikt me njëri-tjetrin dhe paraqet alternativa të zgjidhjes së tyre.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):
3.1. Identifkon dhe elaboron me shkrim, me gojë ose me forma të tjera të prezantimit, rolin e artit dhe të zhvillimeve artistike në kontekstin kulturor dhe atë historik në periudhat e ndryshme të zhvillimit shoqëror.
3.2. Përcakton ndikimin e kontributit të individëve të shquar në artet e ndryshme të kulturave të ndryshme përgjatë historisë.
3.3. Përshkruajnë dhe kategorizojnë vepra të ndryshme të artit dhe objekte të trashëgimisë kulturore sipas periudhës historike, kulturës, stilit dhe artistit.
3.4. Njohin dhe krahasojnë tradita të ndryshme artistike në periudha të ndryshme historike.</td></tr>
<tr><th colspan="4">Aspektet specifike të planit të orës mësimore</th></tr>
<tr><td colspan="4">Njësia mësimore: Ekspozita jonë</td></tr>
<tr><td colspan="4">Fjalët kyçe: përzgjedhja e punimeve; ekspozita; organizimi i ekspozitës.</td></tr>
</table>

Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore
Nxënësi/ja:
- **zhvillon** aftësitë komunikuese dhe ndërvepruese;
- **diskuton** dhe bashkëpunon me të tjerët për ndarjen e punës;
- **përzgjedh** punimet për ekspozim sipas tematikës së dhënë;
- **shpreh** mendimin e tij/saj për realizimin e ekspozitës.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Arti figurativ kl. X, punimet e nxënësve; mjete të nevojshme për realizimin e ekspozitës.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:
Fusha: Shoqëria dhe mjedisi, Shkencat e natyrës, Gjuha dhe komunikimi, Jeta dhe puna, Njohja e kulturave

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Bashkëbisedim
Nxënësit diskutojnë së bashku mbi mënyrën e ekspozimit të punëve të përzgjedhura.
Mësuesi/ja i orienton nxënësit në një situatë pune të përbashkët ku bashkëpunimi është çelësi i organizimit të një ekspozite të mirë.
Ndërtimi i njohurive të reja: Punë në grup
Nxënësit ndahen në skuadra, ku çdo skuadër zgjedh periudhat artistike që do të prezantojë.
Pasi kanë përcaktuar hapësirat për ekspozim dhe kanë përzgjedhur punimet e një periudhe artistike, i vendosin ato në tabakë kartoni.
Në tabakët ku ndodhen punimet e realizuara duke u mbështetur në një periudhë të caktuar, nxënësit vendosin karakteristikat e periudhës dhe autorët kryesorë. Më pas i vendosin në muret e klasës.
Çdo skuadër prezanton punimet e realizuara prej tyre duke u frymëzuar nga periudha përkatëse, karakteristikat dhe përfaqësuesit kryesor.
Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: diskutimi
Nxënësit diskutojnë mbi punimet e tyre dhe mënyrën e realizimit të ekspozitës duke nxjerrë në pah edhe karakteristikat e temës së që ka kjo ekspozitë. Nxënësit nxjerrin përfundimet e punës në grup duke u shprehur nëse bashkëpunimi e arriti rezultatin dhe nëse ekspozita ia arriti qëllimit.

Vlerësimi i nxënësve

Vlerësimi i nxënësit do të fokusohet:
- në diskutimet që ata/ato bëjnë mbi përzgjedhjen e punëve dhe mënyrën e ekspozimit;
- në mënyrën e prezantimit të punimeve;
- në pjesëmarrjen e tyre aktive gjatë diskutimeve.

Detyrat dhe puna e pavarur

Detyrat përcaktohen nga mësuesi/ja në varësi të ecurisë së orës mësimore.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Katalogimi në botim – **(CIP)**
Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani"

37.016:73/76(072)

Nini, Silvana

Libër për mësuesin : art figurativ 10 / Silvana Nini

. - Prishtinë : Botime Pegi, 2019. - 105 f. : me il. ; 20.7 x 28 cm.

ISBN 978-9951-786-02-7

Lejohet për botim me vendimin e Ministrisë
së Arsimit të Shkencës dhe të Teknologjisë,
nr. 318/01-B, të datës 16.07.2019.